



KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

RAPORT

MBI

GJENDJEN E SISTEMIT GJYQËSOR DHE VEPRIMTARINË E KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR PËR VITIN 2022

TABELA E LËNDËS

PËRBËRJA E KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR	4
KËSHILLI NË SHIFRA PËR VITIN 2022	5
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	6
1. VEPRIMTARIA E KËSHILLIT	9
1.1. Mbledhjet plenare.....	9
1.2. Përmbledhje e veprimtarisë së komisioneve të Këshillit	11
1.3. Komisionet e përhershme	11
1.4. Komisionet e përkohshme	17
1.5. Bashkëpunimi i brendshëm	20
1.6. Bashkëpunimi i jashtëm	22
2. MENAXHIMI I BURIMEVE	26
2.1. Burimet njerëzore të Këshillit të Lartë Gjyqësor.....	27
2.2. Burimet njerëzore të Këshillit të Lartë Gjyqësor.....	28
2.3. Zhvillimi i burimeve njerëzore	30
2.4. Veprimtaria financiare.....	32
2.5. Nevojat buxhetore	38
3. ZHVILLIMI I QENDRUESHEM I SISTEMIT GJYQËSOR	39
3.1. Planifikimi strategjik dhe transparencë	39
3.2. Harta e re gjyqësore.....	41
3.3. Infrastruktura e teknologjisë së informacionit	44
3.3.1. Qendra e Teknologjisë së Informacionit	44
3.3.2. Zhvillimet në infrastrukturën ekzistuese të sistemeve teknologjike	45
4. ANALIZA MBI SITUATËN E GJYKATAVE	54
METODOLOGJIA	54
4.1. Gjykata e Lartë	55
Analiza statistikore e Gjykatës së Lartë	55
4.2. Gjykatat e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar	61
4.2.1. Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar	61
4.2.2. Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar	65
4.3. Gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm.....	70
4.4. Gjykata Administrative e Apelit.....	77
4.5. Gjykatat e rretheve gjyqësore të juridiksionit të përgjithshëm	82
4.6. Gjykatat administrative të shkallës së parë.....	91
KONKLUZIONE DHE ANGAZHIME	99

Ky raport u përgatit nga Grupi i Punës i ngritur për këtë qëllim me Urdhrin e Kryetares së KLGJ-së nr. 15, datë 9.02.2023 për "Ngritjen e grupit të punës për hartimin e projektraportit mbi gjendjen e sistemit gjyqësor për vitin 2022", i përbërë nga znj. Helena Papa, znj. Baisa Sefa, z. Kelment Greca, znj. Etrita Petriti, z. Xhevdet Haxhiu, znj. Eneida Ajdari, znj. Vjollca Kola, znj. Aurora Ndreu, znj. Çiljeta Prifti, znj. Valbona Bako dhe znj. Arjona Hysaj.

Raporti u shqyrtua dhe u miratua nga Komisioni i Përhershëm pranë KLGJ-së, për Planifikimin Strategjik, Administrimin dhe Buxhetin, i drejtuar nga Kryetarja e Këshillit znj. Naureda Llagami dhe anëtarët e tij znj. Fatmira Luli dhe znj. Marçela Shehu.

Në përfundim raporti u miratua në mbledhjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor me vendimin nr.196, datë 26.04.2023.

SHKURTIME

RSH	Republika e Shqipërisë
KLJG	Këshilli i Lartë Gjyqësor
ILD	Inspektori i Lartë i Drejtësisë
KLD	Këshilli i Lartë i Drejtësisë
KLP	Këshilli i Lartë i Prokurorisë
MD	Ministria e Drejtësisë
MF	Ministria e Financave
CEPEJ	Komisioni Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë
ÇJE	Këshilli Konsultativ i Gjyqtarëve Evropian
KPK	Komisioni i Pavarur i Kualifikimit
KPA	Kolegji i Posaçëm i Apelit
KPSAB	Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit
KZHK	Komisioni i Zhvillimit të Karrierës
KVEVP	Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale
KD	Komisioni Disiplinor
GJL	Gjykata e Lartë
QTI	Qendra e Teknologjisë së Informacionit
ONM	Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit
SHM	Shkolla e Magjistraturës

PËRBËRJA E KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

Këshilli Lartë Gjyqësor përbëhet nga 11 anëtarë, nga të cilët 6 gjyqtarë dhe 5 jogjyqtarë.

Në kushtet kur në fund të vitit 2021 dhe në mars 2022 u krye ripërtëritja e pjesshme e KLGJ-së¹, duke u larguar prej Këshillit, për shkak të mbarimit të mandatit, anëtarët: znj. Brunilda Kadi, z. Ilir Toska, z. Medi Bici, z. Maksim Qoku dhe z. Erjon Muharremaj, përbërja e re e institucionit është si vijon:

KRYETARJA	
Znj. Naureda Llagami	Juriste e spikatur, përzgjedhur nga radhët e shoqërisë civile Mandat 5-vjeçar (2018-2023)
ZËVENDËSKRYETARI	
Z. Ilir Rusi	Jurist i spikatur, përzgjedhur nga trupa e pedagogëve Mandat 5-vjeçar (2022-2027)
ANETARËT GJYQTARË	
Znj. Brikena Ukperaj	Përfaqësuese e Gjykatave të Apelit Mandat 5-vjeçar (2018-2023)
Z. Dritan Hallunaj	Përfaqësues i Gjykatave të Shkallës së Parë Mandat 5-vjeçar (2018-2023)
Znj. Irena Plaku	Përfaqësuese e Gjykatave të Shkallës së Parë Mandat 5-vjeçar (2021-2026)
Z. Klodian Kurushi	Përfaqësues i Gjykatës së Lartë Mandat 5-vjeçar (2021-2026)
Znj. Marçela Shehu	Përfaqësuese e Gjykatave të Shkallës së Parë Mandat 5-vjeçar (2018-2023)
Z. Ridvan Hado	Përfaqësues i Gjykatave të Apelit Mandat 5-vjeçar (2021-2026)
ANËTARËT JOGJYQTARË	
Z. Alban Toro	Jurist i spikatur, përzgjedhur nga radhët e avokatëve Mandat 5-vjeçar (2018-2023)
Znj. Yllka Rupa	Juriste e spikatur, përzgjedhur nga trupa e pedagogëve Mandat 5-vjeçar (2022-2027)
Z. Fatmira Luli	Juriste e spikatur, përzgjedhur nga radhët e avokatëve Mandat 5-vjeçar (2018-2023)

¹ Vendimi nr.581 datë 13.12.2021 “Për deklarin e mbarimit të mandatit të anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor z. Medi Bici”; Vendimi nr.582 datë 13.12.2021 “Për deklarin e mbarimit të mandatit të anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor z. Ilir Toska”; Vendimi nr.583 datë 13.12.2021 “Për deklarin e mbarimit të mandatit të anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor znj. Brunilda Kadi”; Vendimi nr.77 datë 02.03.2022 “Për deklarin e mbarimit të mandatit dhe përfundimin e qëndrimit në detyrë të anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor z. Maksim Qoku”; Vendimi nr.78 datë 02.03.2022 “Për deklarin e mbarimit të mandatit dhe përfundimin e qëndrimit në detyrë të anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor z. Erjon Muharremaj”.

KËSHILLI NË SHIFRA PËR VITIN 2022

Mbledhje Plenare	Struktura e KLGJ	Prop/Ngritje/Emërimë	Verifikime
114	106 / 128	41 ²	103
Akte të miratuara	11	6³	22+5+3⁴
562⁵	Anëtarët	Gjykata e Lartë	Kandidatë për GJL & Gj.Apelit
377	10+9⁶	12⁷	50⁸
Komisioni i Zhvillimit të Karrierës	Transferime & Delegime	Gj. Posaçme, Gj. Apeli KKO, Adm, & Juridiksioni pgj.	Kandidatë për formim fillestar SHM V'22 -'23
60	15⁹ (2)¹⁰	23¹¹	23¹²
Komisioni i Vlerësimit Etik - Profesional	Komisioni i Disiplinës	Gjykata të shkallës së parë	Kandidatë Magjistratë
100	24	220	55¹³
Komisioni i Planifikimit Strategjik & Buxhetit	Kërkesa për informacion	Gjyqtarë të trajnuar	Kuotat për Magjistratë në SHM V'22 -'23

² Përfshihen Propozimet për emërim në GJL, ngritjet në detyrë në apel dhe në gjykatën e posaçme të shkallës së parë, emërimet në gjykatat e rretheve gjyqësore dhe në gjykatat administrative.

³ Në shkurt të vitit 2022 janë emëruar 2 gjyqtarë, në prill është emëruar 1 gjyqtar nga radhët e juristëve të spikatur, në maj 1 gjyqtar, dhe në qershor 2 tjerë.

⁴ Janë kryer 30 vendimmarrje verifikimesh, nga të cilat 22 për kandidatët nga radhët e gjyqtarëve për Gjykatën e Lartë, 5 kandidatë nga radhët e gjyqtarëve për gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe Gjykatën Administrative të Apelit si dhe 3 vendimmarrje për GJPKKO (shkallë e parë dhe apel).

⁵ Këtu përfshihen dhe aktet e miratuara nga Komisionet e Përkohshme si dhe aktet e miratimit të procesverbaleve të mbledhjes plenare.

⁶ Gjatë vitit 2022 Këshilli ka vendosur, caktimin në skemë delegimi të 6 gjyqtarëve dhe zgjatjen e afatit të caktimit për 4 gjyqtarë të tjerë (10 në total). KLGJ-ja ka vendosur transferimin e përkohshëm të 1 gjyqtari si dhe ka përsëritur transferimin e përkohshëm të 8 (tetë) gjyqtarëve për një periudhë tjetër 1-vjeçare.

⁷ Ngritje në detyrë në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm, 1 në Gjykatën e Apelit Administrativ, 3 në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe 1 në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

⁸ 41 kandidatë të kualifikuar për vitin akademik 2022-2023. 8 kandidatë të kualifikuar për vitin akademik 2021-2022 dhe një kandidat i skualifikuar për këtë periudhë.

⁹ 15 akte të propozuara nga Komisioni Disiplinës dhe miratuara nga KLGJ-ja.

¹⁰ KLGJ-ja ka vendosur 2 masa "Pezullim nga detyra" gjatë vitit 2022.

¹¹ 19 emërimë në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm dhe 4 në gjykatat administrative të shkallës së parë.

¹² Janë kryer verifikimet për 23 kandidatë që mbaruan Shkollën e Magjistraturës në vitin akademik 2021-2022. Ndërsa për një kandidat verifikimi përfundoi në vitin 2023.

¹³ 45 kuota kandidatësh për magjistratë "profili gjyqtar", dhe 10 kuota për kandidatë për ndihmës ligjorë.

Këshilli i Lartë Gjyqësor ka përmbyllur me sukses vitin e tij të katërt të funksionimit si institucioni qeverisës i gjyqësorit. Në vitin raportues, Këshilli ka vijuar punën i drejtuar nga parimet e pavarësisë, profesionalizmit, integritetit, dhe paanshmërisë. Vendimmarrjet e Këshillit si në numër ashtu edhe në cilësi dëshmojnë angazhim për të reaguar në kohën e duhur dhe me mjetet e nevojshme ndaj problematikave të evidentuara në sistemin gjyqësor, kjo dhe në kuadrin e miratimit të hartës së re gjyqësore e cila riorganizon shtrirjen gjeografike të gjykatave në vend.

Viti 2022, mund të përshkruhet si një vit më i mirë se ai i lënë pas, kjo dhe për faktin se ai përkon me zhdukjen graduale të pandemisë globale Covid -19. Megjithatë, sfidat për sistemin gjyqësor nuk kanë përfunduar kur bëhet fjalë për mungesën e burimeve njerëzore nëpër gjykata, veçanërisht më të prekura gjykatat e apelit, për shkak të procesit të rivlerësimit kalimtar.

Vlen të theksohet se, Këshilli ka hyrë tashmë në një fazë konsolidimi ndaj dhe vendimmarrjet e tij janë vazhdimësi e strategjisë, strukturave apo vendimmarrjeve të ndërmarra ndër vite (p.sh. prej vitit 2021). Gjatë këtij viti evidentohen disa zhvillime të rëndësishme pozitive, ku përmendim:

1. Zhvillimin e 114 mbledhjeve plenare nga të cilat 45 mbledhje për caktim gjyqtarësh me qëllim plotësimin e trupës gjyqësore dhe miratimin e 562 vendimeve.
2. Miratimi i Planit të ri Strategjik të Këshillit të Lartë Gjyqësor për sistemin gjyqësor në Shqipëri për vitin 2022 – 2024 si një vazhdimësi e misionit dhe vizonit të tij strategjik për arritjen e ekselencës gjyqësore.
3. Miratimi i Planit të ri të Komunikimit për Gjykatat, i shoqëruar me një sërë aktesh me qëllim rritjen e transparencës dhe një komunikim më të mirë e cilësor me publikun dhe median.
4. Plotësimin e Gjykatës së Lartë me 16 anëtarë¹⁴ dhe hapja e garës për 4 vendet e mbetura vakante, përmes procedurës së ngritjes në detyrë të magjistratëve/gjyqtarëve.
5. Ngritja dhe funksionimi i Grupit Ndërinstitucional të Punës (GNP) për ndjekjen dhe zbatimin e vendimit nr.495, datë 21.07.2022 të Këshillit të Ministrave nr.495, datë 21.07.2022, “Për riorganizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave gjyqësore të gjykatave”.
 - ✚ Hartimi i projekt akteve të nevojshme për fillimin e zbatimit të Hartës së Re Gjyqësore, faza e parë për gjykatat e apelit.
6. Vazhdimi i zbatimit të reformës së administratës civile gjyqësore me qëllim garantimin e profesionalizimit, qëndrueshmërisë dhe integritetit në ushtrimin e funksioneve publike. Në funksion të kësaj reforme, u ndërmorrën një sërë masash duke realizuar:
 - ✚ Shtimin e stafit administrativ dhe mbështetjen teknike në sistemin e menaxhimit të çështjeve në gjykatat e apelit.
 - Shtimi i stafit administrativ me 204 pozicione në total (124 pozicione

¹⁴ Në shkurt të vitit 2022 është emëruar 1 gjyqtar, në prill është emëruar një gjyqtar nga radhët e juristëve të spikatur, në mars 2 gjyqtarë dhe në qershor 2 tjerë.

nëpunës civilë gjyqësorë dhe 80 pozicione punonjës të tjerë gjyqësorë) në gjykatat e të gjitha niveleve.

- Ndërsa në gjykatat e apelit¹⁵ për vitin 2022 shtimi i stafit administrativ rezulton të jetë me 46 pozicione (23 nëpunës civilë gjyqësorë dhe 23 punonjës të tjerë gjyqësorë).

- ✚ Kualifikimin dhe lejimin për të marrë pjesë në provimin e vlerësimit profesional të 2 kancelarëve.
- ✚ Standardizimin dhe përmirësimin e sistemit të llogaridhënies së nëpunësve civilë gjyqësorë, konkretisht kancelarëve, këshilltarëve dhe ndihmësve ligjorë, përmes miratimit të rregullores “Për zhvillimin e procedurave disiplinore për kancelarin, këshilltarin dhe ndihmësin ligjor”.
- ✚ Verifikimin dhe pranimin në shërbim civil gjyqësor të 15 punonjësve nga të cilët 5 këshilltarë ligjorë pranë njësisë ligjore të Gjykatës së Lartë dhe 10 ndihmës ligjorë në gjykatat e apeleve.

7. Përgatitjen dhe rekrutimin e gjyqtarëve të rinj duke:

- ✚ Përcaktuar në 45¹⁶ numrin/kuotat e kandidatëve për magistratë “profili gjyqtar”, dhe 10 numrin e kandidatëve për ndihmës ligjorë, për vitin akademik 2021-2022¹⁷.
- ✚ Kryer verifikimin e kriterëve dhe kushteve formalo-ligjore si dhe pasurisë dhe figurës për 50 kandidatë¹⁸.

8. Vijimin e bashkëpunimit të ngushtë me organet e rivlerësimit në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve duke:

- ✚ Depozituar pranë KPK-së 30 raporte të analizimit të aftësive profesionale të shoqëruara me 150 dosje gjyqësore për 30 subjekte të rivlerësimit kalimtar.
- ✚ Nga fillimi i procesit të rivlerësimit janë dorëzuar pranë KPK-së 379 raporte të analizimit të aftësive profesionale, duke përmbyllur 79% të të gjithë subjekteve që kanë paraqitur formularin e rivlerësimit pranë ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

9. Ushtrimin e kompetencave lidhur me përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve me qëllim vetëpastrimin e sistemit gjyqësor duke:

- ✚ Zhvilluar 5 procedimeve disiplinore, prej të cilave u konkludua në:
 - 2 masa “Pezullimi nga detyra”;
 - 2 procedime disiplinore janë përmbyllur me vendime jopërfundimtare;
 - 1 procedim disiplinor është ende në vijim.

¹⁵ Tek gjykatat e apelit përfshihen gjykatat e apelit me juridiksion të përgjithshëm, Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe Gjykata Administrative e Apelit.

¹⁶Përcaktuar në 45 numri i kandidatëve për magistratë “profili gjyqtar”, dhe në 10 numri i kandidatëve për ndihmës ligjorë për vitin akademik 2022-2023.

¹⁷ Vendimi nr. 41, datë 31.01.2022.

¹⁸ 41 kandidatë të kualifikuar për vitin akademik 2022-2023. 8 kandidatë të kualifikuar për vitin akademik 2021-2022 dhe një kandidat i skualifikuar për këtë periudhë.

10. Me qëllim plotësimin e trupave gjyqësore në gjykata, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka:

- ✚ Trajtuar 566 kërkesa duke caktuar 742 gjyqtarë për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme.
- ✚ Përfshirë në skemë delegimi 10 gjyqtarë dhe ka transferuar me pëlqim 9 gjyqtarë¹⁹.
- ✚ Vazhdimi i vlerësimeve etike-profesionale të gjyqtarëve në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, duke hartuar dhe miratuar 27²⁰ raporte vlerësimi. Në 3 vite veprimtari janë hartuar dhe miratuar 107 raporte vlerësimi për 60 gjyqtarë duke vlerësuar rreth 1/3 e gjyqtarëve që ndodhen efektivisht në detyrë²¹.

11. Rritja e transparencës dhe efijencës për përdoruesit e brendshëm dhe të jashtëm të sistemeve të teknologjisë së informacionit përmes përmirësimeve të sistemeve aktuale gjyqësore: ICMIS dhe ARKIT:

- Mundësimi i zhvillimeve të reja si dhe trajtimi i 686 kërkesave për mbështetje teknike nga të gjithë gjykatat e vendit.
- Përfundimi me sukses i migrimit të gjithë bazës së të dhënave të 5 gjykatave të mëparshme të apelit në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm mundësuar në kuadër të zbatimit të Hartës së Re Gjyqësore.
- Ngritja e infrastrukturës së re fizike (implementimi i serverit dhe “storage”) e cila do të mundësojë administrimin dhe përpunimin e të gjitha çështjeve të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.
- Përcaktimi i rregullave të hollësishme për ndarjen e çështjeve me short, marrja e masave të nevojshme si dhe testimi i këtij mekanizmi për të mundësuar realizimin me sukses në praktikë.

12. Sigurimi i mirëfeksionimit të Qendrës së Teknologjisë së Informacionit dhe miratimi i të gjitha akteve të nevojshme në këtë drejtim, përfshirë miratimin e strukturës dhe organikën e saj.

13. Vijimi i një qasje transparente komunikimi publik në mënyrë sa më profesionale dhe cilësore.

- ✚ KLGJ-ja në zbatim të ligjit për të drejtën e informimit gjatë vitit 2022, ka trajtuar 24 kërkesa për informacion, duke iu përgjigjur, brenda një afati të arsyeshëm, të gjithë kërkuessve për informacion.
- ✚ Popullimi, me informacion dhe në kohë të arsyeshme, i faqes zyrtare të internetit të KLGJ-së, me të gjitha materialet dhe vendimarrjet e Këshillit si dhe komunikimi i tyre në një gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme për publikun përmes

¹⁹ Gjatë vitit 2022 Këshilli ka vendosur ka vendosur zgjatjen e afatit të caktimit të 4 gjyqtarëve të skemës së delegimit, si dhe ricaktimin e tyre në skemën e delegimit, si dhe të përsërisë transferimin e përkohshëm të 8 (tetë) gjyqtarëve për një periudhë tjetër 1-vjeçare.

²⁰ 16 raporte për periudhën e vlerësimit 2013-2016, 5 për periudhën e vlerësimit 2017-2019, 4 për periudhën e vlerësimit viti 2019 dhe 1 për periudhën e vlerësimit viti 2021. Gjithashtu, në vitin 2022 ka përfunduar procedura për njohjen e nivelit të vlerësimit të bërë nga institucioni ku gjyqtari ka qenë i komanduar, për 1 (një) gjyqtar.

²¹ Efektivisht në detyrë ndodhen 228 gjyqtarë.

njoftimeve për shtyp.

14. KLGJ-ja ka vijuar bashkëpunimin e brendshëm dhe të jashtëm duke zhvilluar një sërë aktivitetesh, takimesh, konferencash dhe trajnimesh me institucionet vendase, ndërkombëtare, shoqërinë civile, etj.
15. Me qëllim rritjen profesionale të trupës gjyqësore dhe stafit administrativ, por edhe forcimit e ruajtjes së një mjedisi pune motivues, janë trajnuar 220 gjyqtarë që ushtrojnë efektivisht detyrën, 13 punonjës të KLGJ-së, 103 nëpunës civilë gjyqësorë dhe kjo në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës, ASPA, projektet e asistencës së huaj, etj.

GJENDJA E SISTEMI GJYQËSOR GJATË VITIT 2022

- Gjatë vitit 2022, sistemi gjyqësor është përballur me një ulje minimale të ngarkesës së punës, ku numri total i çështjeve në shqyrtim në vitin 2022 është 0.4% më i vogël se në vitin 2021.
- Qytetarët i janë drejtuar më pak gjykatave duke sjellë një ulje prej 12% të çështjeve të reja të regjistruara gjatë vitit 2022, krahasuar me vitin paraardhës.
- Pjesa më e madhe e gjykatave kanë funksionuar me kapacitet të reduktuar të gjyqtarëve, nën 70% (25 nga 38 gjykata), ndërsa në nivel kombëtar vetëm 56% e organikës së gjyqtarëve kanë qenë efektivisht në detyrë gjatë vitit 2022.
- Ngarkesa e punës në gjykata është përballuar nga vetëm 228 gjyqtarë ose 8.2 gjyqtarë për 100.000 banorë²². Ky raport është më pak se 40% e normës evropiane (22.2 gjyqtar për 100.000 banorë).
- Gjykatat kanë bërë përpjekje për të ruajtur ritmin e zgjidhjes së çështjeve, mesatarja e normës së likuidimit të çështjeve në rang vendi është rritur duke shënuar një normë prej 104% (krahasuar me normën mesatare 68% në 2021) me qëllim mbajtjen nën kontroll të rritjes së stokut, tentativa të cilat nuk kanë sjellë rezultat pasi shënohet një rritje prej 31% të çështjeve në pritje të gjykimit në rang vendi.
- Rendimenti mesatar i punës për gjyqtar në rang vendi, gjatë vitit 2022, ka qenë pothuajse 561 çështje për gjyqtar, që shënon një rritje me 25 çështje (536 në 2021) më tepër krahasuar me një vit më parë.

1. VEPRIMTARIA E KËSHILLIT

1.1. MBLEDHJET PLENARE

²² Popullsia e Republikës së Shqipërisë në datën 1 janar 2022 rezulton 2.793.592 banorë, sipas të dhënave të fundit të INSTAT, <https://www.instat.gov.al/al/temat/treguesit-demografik%C3%AB-dhe-social%C3%AB/popullsia/publikimet/2022/popullsia-e-shqip%C3%ABris%C3%AB-1-janar-2022/>

Në ushtrim të funksioneve të tij kushtetuese dhe ligjore, Këshilli i Lartë Gjyqësor, gjatë vitit 2022, ka realizuar rreth 114 mbledhje plenare (ose 13% më shumë se viti që shkoi) dhe ka marrë 562 vendimmarrje, qëllimi kryesor i të cilave ka qenë garantimi i funksionalitetit të sistemit gjyqësor.

Më konkretisht, vendimmarrjet e Këshillit patën në fokus: (i) hartimin e akteve nënligjore në funksion të përmbushjes së përgjegjësiive ligjore, (ii) realizimin e procedurave të ngritjes në detyrë të gjyqtarëve në Gjykatën e Lartë, në Gjykatat e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, si dhe në gjykatat e apelit, (iii) emërimin dhe caktimin në detyrë të magistratëve që kanë përfunduar programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, (iv) miratimin e raporteve të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve²³, (v) realizimin e procedurave disiplinore ndaj gjyqtarëve, (vi) adoptimin e mekanizmave për miradministrimin e sistemit gjyqësor, si dhe (vii) miratimin e akteteve të nevojshme për fillimin e zbatimit të Hartës së Re Gjyqësore.

Në qendër të veprimtarisë së tij gjatë vitit 2022, Këshilli ka pasur edhe procesin e plotësimit të vendeve vakante në gjykata përmes dy instrumenteve ligjore:

- i. **skemës së delegimit**, në të cilën u përfshinë 6 gjyqtarë rishtazi dhe u vendos zgjatja e afatit dhe ricaktimi në skemën e delegimit të 4 gjyqtarëve,
- ii. si dhe **transferimit të përkohshëm me pëlqim** të një gjyqtari, si dhe përsëritjen e transferimit të përkohshëm të 8 (tetë) gjyqtarëve për një periudhë tjetër 1-vjeçare.

Procedura e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore, të pasurisë dhe të figurës, për kandidatët për formimin fillestar për magistratë, profili gjyqtar, në Shkollën e Magjistraturës, për vitin 2022-2023 është një tjetër kompetencë ligjore që Këshilli i ka kushtuar vëmendje të veçantë gjatë veprimtarisë së tij. Në këtë kuadër, janë verifikuar kushteve dhe kriterëve ligjore, të pasurisë dhe të figurës, për 45 kandidatët për formimin fillestar, në Shkollën e Magjistraturës, për vitin 2022-2023, proces i cili do të shërbejë në të ardhmen për plotësimin e vakancave pranë gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm dhe atij administrativ.

Përkushtim të spikatur Këshilli ka dëshmuar në funksion të zbatimit të reformës së administratës civile gjyqësore, përmes verifikimit të kriterëve dhe kualifikimit për praninë në shërbimin civil gjyqësor të punonjësve në gjykata si dhe verifikimit të kancelarëve në detyrë, përkushtim ky i cili përkthen në terma real qasjen e Këshillit mbi rolin dhe rëndësinë që ka personeli mbështetës, krahas gjyqtarëve, në përshpejtimin e ritmit të evadimit të dosjeve gjyqësore për qytetarët.

Nga 562 vendimmarrje të Këshillit, 552 prej tyre janë propozuar nga komisionet e përhershme dhe 10 nga komisionet e përkohshme. Për sa i përket kategorizimit të këtyre vendimmarrjeve sipas përcaktimit ligjor, rezulton se: 10 janë akte të mirëfillta nënligjore, të cilat u botuan në fletoren zyrtare të Republikës së Shqipërisë, ndërkohë 354 akte individuale, 152 akte kolektive dhe 45 akte rregulla të brendshme dhe 1 udhëzim.

²³ Si parakusht i ekzistencës së dy vlerësimeve të mëparshme etiko-profesionale për gjyqtarët që kandidojnë për ngritje në detyrë sipas ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

1.2. PËRMBLEDHJE E VEPRIMTARISË SË KOMISIONEVE TË KËSHILLIT

Sipas parashikimeve ligjore, Këshilli i Lartë Gjyqësor ushtron veprimtarinë e tij përmes katër (4) Komisioneve të Përhershme:

1. Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit
2. Komisioni Disiplinor
3. Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale
4. Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Gjatë vitit 2022, puna voluminoze e tyre është materializuar në një numër të lartë aktesh nënligjore në kuadër si të rregullimit, mbarëvajtjes dhe miradministrimit të sistemit gjyqësor ashtu dhe të karrierës së gjyqtarëve, e pasqyruar si më poshtë:

Komisionet e Përhershme	Nr. i akteve propozuara
1 Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit	100
2 Komisioni Disiplinor	15
3 Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale	60
4 Komisioni i Zhvillimit të Karrierës	377
5 Akte të Komisioneve të Përhershme	552
6 Akte të miratuara nga KLGJ (2022) ²⁴	562

Duke qenë se, në respektim të detyrimit ligjor²⁵, veprimtaria e komisioneve të përhershme pasqyrohet në raportet e tyre vjetore që janë publike në faqen zyrtare të Këshillit (<http://klgj.al/raporte-te-komisioneve-te-perhereshme/>), në këtë kapitull do të ofrojmë një përmbledhje të gjetjeve kryesore të tyre.

1.3. KOMISIONET E PËRHERSHME

KOMISIONI I PLANIFIKIMIT STRATEGJIK, ADMINISTRIMIT DHE BUXHETIT

KPSAB-ja, si struktura përgjegjëse për hartimin, miratimin dhe monitorimin e zbatimit të Planit Strategjik, politikave administrative, financiare dhe buxhetore në funksionin të menaxhimit të mirë e efikas të sistemit gjyqësor në vend, gjatë vitit 2022 ka realizuar 40 mbledhje, në të cilat janë marrë 100 vendime, 88 prej të cilave në fushat përkatëse të veprimtarisë si më poshtë vijon:

- 22 në fushën e planifikimit strategjik;
- 46 në fushën e administrimit dhe efiçencës;

Përbërja:

Kryetare: Naureda Llagami

Anëtarë: Marçela Shehu,
Fatmira Luli

Anëtare Zëvendësuese:
Brikena Ukperaj, Yllka Rupa

²⁴ Këtu përfshihen dhe aktet e miratuara nga Komisionet e Përkohshme si dhe aktet e miratimit të procesverbaleve të mbledhjes plenare.

²⁵ Pika 16, e nenit 62 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

- 18 në fushën e planifikimit dhe menaxhimit financiar dhe buxhetor;
- 2 akte individuale (konfidenciale).

12 vendimmarrje të Komisionit i referohen miratimit të procesverbaleve të mbledhjeve plenare, në përputhje me detyrimin ligjor që ka Këshilli përkundrejt transparencës në marrëdhëniet me publikun. Përmes faqes së internetit të Këshillit, ky detyrim është përmbushur brenda afateve ligjore të arsyeshme duke kontribuar në përmirësimin e transparencës dhe llogaridhënies së punës së KLGJ-së përkundrejt qytetarëve dhe aktorëve të tjerë të interesuar mbi veprimtarinë e tij.

Në vitin e katërt të funksionimit të tij, Komisioni ka vijuar punën në zbatim të përpiktë të legjislacionit në fuqi. Vendimmarrjet e Komisionit dëshmojnë angazhim për të reaguar në kohë dhe me mjetet e duhura ndaj nevojave të sistemit gjyqësor, kjo dhe në kuadrin e miratimit të hartës së re gjyqësore e cila riorganizon shtrirjen e gjykatave në vend.

Duke qenë se një pjesë e madhe e vendimmarrjeve, janë të rëndësishme në kuadrin e miradministrimit të gjykatave dhe ndërtimit të një administrate gjyqësore profesionale të qëndrueshme, dhe me integritet të lartë, vazhdimi i zbatimit të reformës për nëpunësin civil gjyqësor ka qenë edhe këtë vit një ndër proceset më të rëndësishme që ka shënuar punën e Komisionit. Vëmendje të veçantë në kontekstin e hartës së re gjyqësore, pa diskutim që mori mbështetja e gjykatave të apelit ku për vitin 2022, në të cilat janë emëruar përmes kualifikimit për emërim në shërbimin civil gjyqësor 10 ndihmës ligjorë. Ndërsa 5 këshilltarë të tjerë ligjorë janë emëruar pranë njësisë ligjore të Gjykatës së Lartë, duke e çuar numrin total të rekrutimeve në shërbimin civil gjyqësor në sistemin gjyqësor për vitin raportues në 15 punonjës. Vazhdimi i angazhimit të Komisionit në këtë drejtim reflekton qasjen e Këshillit lidhur me rolin dhe rëndësinë që i kushton personelit mbështetës, krahas gjyqtarëve, në ritmet e evadimit të dosjeve dhe për pasojë edhe në reduktimin e vonesave në shqyrtimin e çështjeve gjyqësore për qytetarët.

Rritja e transparencës dhe efijencës për përdoruesit e brendshëm dhe të jashtëm të sistemeve të teknologjisë së informacionit përmes përmirësimeve të sistemeve aktuale gjyqësore: ICMIS dhe ARKIT është një dimension i rëndësishëm i veprimtarisë së Komisionit. Për këtë qëllim, gjatë vitit 2022 janë mundësuar zhvillime të reja si dhe janë trajtuar 686 kërkesave për mbështetje teknike, ka përfunduar me sukses migrimi i gjithë bazës së të dhënave të 5 gjykatave të mëparshme të apelit në Gjykatën e Apelit të Juridiksionin të Përgjithshëm mundësuar në kuadër të zbatimit të Hartës së Re Gjyqësore, si dhe janë përcaktuar rregulla të hollësishme për ndarjen e çështjeve me short.

Sa i përket çështjeve të trajtuara lidhur me administrimin dhe menaxhimin e fondeve buxhetore, vlen të theksohet se reagimi i Komisionit ka passjellë efijencë dhe efektivitet. Kjo tregohet edhe nga realizimi i buxhetit për sistemin gjyqësor, në masën 93%, duke reaguar në mënyrë të shpejtë dhe të drejtë ndaj nevojave të sistemit gjyqësor, në funksion të menaxhimit të fondeve buxhetore me efijencë dhe efektivitet.

Komisioni gjatë ushtrimit të funksioneve të tij është përqendruar edhe në vazhdimin e mbështetjes së dhënë në kuadër të sigurimit të mirëfunksionimit të Qendrës së Teknologjisë së

Informacionit dhe miratimit të të gjitha akteve të nevojshme në këtë drejtim, përfshirë miratimin e strukturës dhe organikën e saj.

KOMISIONI I ZHVILLIMIT TË KARRIERËS

Përbërja

Kryetar: Klodian Kurushi

Anëtarë: Dritan Hallunaj,
Alban Toro

Anëtarë Zëvendësues:
Marçela Shehu, Ilir Rusi

Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, në ushtrim të rolit dhe kompetencave të tij ligjore, gjatë vitit raportues, është fokusuar në zbatimin e të gjithë mekanizmave ligjorë me qëllim zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve si dhe garantimin e një sistemi gjyqësor të pavarur, të paanshëm dhe me integritet të lartë. Vendimmarrjet e hartuara kanë qenë kryesisht të lidhura me proceset e përzgjedhjes/emërimit, promovimit, transferimit apo mbarimit të statusit të gjyqtarëve, duke zbatuar në mënyrë rigoroz kriteret ligjore e objektive të vendosura, e duke garantuar të drejtat vetjake të gjyqtarëve në proces.

Gjatë vitit 2022, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i ka propozuar Këshillit të Lartë Gjyqësor gjithsej 377 projektvendime, nga të cilat:

- 3 akte në kuadër të procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për anëtarët e ardhur nga radhët e juristëve të spikatur;
- 97 akte në kuadër të procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, në gjykatat e posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar, në Gjykatën e Juridiksionit të Përgjithshëm dhe në Gjykatën Administrative të Apelit²⁶
- 1 akt në kuadër të procedurës së përcaktimit të numrit të kandidatëve për gjyqtarë, dhe ndihmës ligjorë që do të pranohen në programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2022-2023;
- 11 akte në kuadër të procedurave të mbarimit të statusit të magjistratit;
- 12 akte në kuadër të procedurave të komandimit të gjyqtarëve;
- 26 akte në kuadër të procedurave të skemës së delegimit të ngritur pranë Këshillit sipas nenit 45 të Ligjit për Statusin;
- 19 akte në kuadër të procedurave të transferimit të përkohshëm të gjyqtarëve (19 vendimet janë sipas nenit 46 të Ligjit për Statusin);
- 2 akte në kuadër të procedurave të caktimit në pozicion të gjyqtarëve, vendim për caktimin në pozicion në mënyrë të përhershme të gjyqtarëve të gjykatave të posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar,
- 73 akte në kuadër të procedurave të emërimit të magjistratëve;
- 52 akte në kuadër të procedurave të verifikimit të kushteve dhe kriterëve të kandidimit për në formimin fillestar, profili gjyqtar, për në Shkollën e Magjistraturës, në lidhje me kandidatët e shpallur fitues për vitin akademik 2021-2022, dhe në lidhje me kandidatët e shpallur fitues për vitin akademik 2022-2023;

²⁶ 40 vendimmarrje në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, 19 vendimmarrje në procedurat e ngritjes në detyrë në gjykatat e posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar dhe 38 vendimmarrje në procedurat e ngritjes në detyrë në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe Gjykatën Administrative të Apelit;

- 74 akte në kuadër të procedurave të caktimit të gjyqtarëve në çështje gjyqësore të veçanta, në gjykata të tjera të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme²⁷
- 7 akte në kuadër të procedurave të tjera të lidhura me statusin dhe karrierën gjyqësore.

Komisioni i Zhvillimit të Karrierës përgjatë vitit 2022 ka përbushur një sërë detyrash të rëndësishme që i përkasin fushës së veprimtarisë së tij, por edhe një sërë detyrash që lidhen me prioritetet e veprimtarisë së Këshillit të Lartë Gjyqësor. Kështu, KZHK-ja ka pasur në fokus ndjekjen e procesit të plotësimit të vendeve vakante në gjykata përmes skemës së delegimit, transferimit përkohësisht të gjyqtarëve, ngritjes në detyrë si dhe ka shqyrtuar kërkesat e paraqitura nga drejtuesit e gjykatave në lidhje me caktimin e gjyqtarëve të ndryshëm për shqyrtimin e çështjeve të veçanta. Komisioni ka përbushur detyrimet ligjore në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës për caktimin e numrit të magjistratëve të rinj.

Një tjetër çështje me rëndësi madhore për të cilën Komisioni është investuar fuqimisht është edhe plotësimi i pozicioneve të lira pranë gjykatave të posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar, si dhe gjykatave të apelit me juridiksion të përgjithshëm. Prioritet ky i cili u përbush me sukses gjatë vitit 2022, sidomos për gjykatat e posaçme të cilat tashmë kanë një organikë të plotësuar me numrin e nevojshëm të gjyqtarëve.

KOMISIONI DISIPLINOR

Gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, Komisioni Disiplinor si dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor kanë treguar përgjegjshmëri dhe kujdes në zbatueshmërinë në praktikë, të gjithë kuadrit normues për procedurat disiplinore, duke përfunduar brenda afateve ligjore dhe të arsyeshme të gjitha procedurat disiplinore të paraqitura për shqyrtim.

Përbërja:

Kryetar: Marçela Shehu

Anëtarë: Ridvan Hado, Ilir Rusi

Anëtarë Zëvendësues:
Dritan Hallunaj, Alban Toro

Komisioni Disiplinor gjatë vitit 2022, ka kaluar për shqyrtim në mbledhje plenare 4 (katër) procedura disiplinore dhe 1 procedurë e cila ishte e mbartur nga viti i mëparshëm. Në vijim të këtyre procedurave, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka konkluduar me vendim përfundimtar për 3 (tre) procedura disiplinore²⁸, nga të cilat:

- **për 1 (një) procedurë disiplinore** është vendosur miratimi i marrëveshjes së përbashkët të pranimit, e dakordësuar midis Inspektorit të Lartë të Drejtësisë (ILD) dhe magjistratit²⁹

²⁷Nga të cilat 67 vendime nëpërmjet të cilave janë trajtuar kërkesa për caktim gjyqtari dhe në përgjigje të tyre janë caktuar 742 gjyqtarë për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të ndryshme, nga ajo ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme, si dhe 7 vendime për çështje të tjera në kuadër të caktimit të gjyqtarëve në çështje të veçanta.

²⁸ Procedimi disiplinor ndaj magjistratit E.K, është filluar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë në vitin 2021. Me vendimin nr. 240, datë 07.06.2021, Këshilli i Lartë Gjyqësor krahas pezullimit nga detyra të gjyqtarit E.K deri në përfundimin e procedimit disiplinor, ka disponuar me kërkimin ndaj Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për kryerjen e hetimeve të mëtejshme në drejtim të shkeljes disiplinore.

²⁹ Procedimi disiplinor ndaj magjistratit E.K, është filluar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë në vitin 2021. Me vendimin nr. 240, datë 07.06.2021, Këshilli i Lartë Gjyqësor krahas pezullimit nga detyra të gjyqtarit E.K deri në përfundimin e procedimit disiplinor, ka disponuar me kërkimin ndaj Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për kryerjen e hetimeve të mëtejshme në drejtim të shkeljes disiplinore.

për veprime të kryera jashtë ushtrimit të detyrës, të konsideruara si sjellje që diskreditonin pozitën dhe figurën e magjistratit dhe dëmtonin besimin e publikut në sistemin gjyqësor³⁰. Përkatësisht i referohemi vendimit nr. 6, datë 17.01.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, ku bazuar në marrëveshjen e përbashkët të pranimit të shkeljes disiplinore, Këshilli ka vendosur caktimin e masës disiplinore të “Pezullimit nga detyra me të drejtën për të marrë pagën minimale për një periudhë kohore për 6 muaj”

- **për 2 (dy) procedura** është dhënë masa disiplinore “pezullim nga detyra”, përkatësisht vendimet e mëposhtme:

Me vendimin nr. 267, datë 19.07.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor është vendosur pranimi i kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe vendosja e masës disiplinore të pezullimit nga detyra, me të drejtën për të marrë pagën minimale për një periudhë 3 (tre) mujore, për magjistratin që ka kryer veprime që kanë sjellë përfitim të padrejtë për palën në proces dhe janë kryer në kundërshtim me ligjin.

Me vendimin nr. 346, datë 27.07.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, është vendosur pezullimi nga detyra i magjistratit nën procedim disiplinor. Procedura administrative është iniciuar kryesisht nga Komisioni Disiplinor, bazuar në informacionin e njoftuar nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Në lidhje me 2 (dy) procedimet e tjera disiplinore, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka proceduar me dhënien e një vendimi jopërfundimtar. Më konkretisht, me vendimin nr. 436, datë 25.10.2022 është vendosur pezullimi i procedimit disiplinor të filluar deri në marrjen e formës së prerë të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit me të cilin është disponuar dhënia e masës disiplinore “*Shkarkimin nga detyra*” ndaj magjistratit në fjalë. Ndërkohë, KLGJ-ja ka ende në shqyrtim një procedimin disiplinor të depozituar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë në datë 23.11.2022.

Veprimtaria e Komisionit Disiplinor është e ndërvarur me atë të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, si institucioni përgjegjës për sa i përket verifikimit të ankesave, hetimit me nismë të shkeljeve dhe fillimit të procedimit disiplinor ndaj gjyqtarëve të të gjitha niveleve. Në çdo rast KLGJ-ja ka bashkëpunuar ngushtë me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë duke trajtuar kërkesat e tij me drejtësi, korrektësi dhe brenda afateve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

Bashkëpunimi ndërinstitutional, në aspektin e rritjes së cilësisë së vendimmarrjes dhe performancës së Këshillit të Lartë Gjyqësor në çështjet me natyrë disiplinore ka vijuar të mbetet në vëmendje të veçantë të Komisionit Disiplinor. Në këtë kontekst, kanë shërbyer tryezat e përbashkëta të organizuara nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë apo Inspektori i Lartë i Drejtësisë, të cilat kanë pasur si qëllim diskutimin e rolit të shërbimeve të inspektimit, si garantues për funksionimin e drejtë dhe të pavarur të sistemit të drejtësisë dhe magjistratëve, sipas standardeve evropiane dhe praktikave më të mira ndërkombëtare.

Në plotësim të rekomandimeve të vendosura në Rezolutën e Kuvendit për vitin 2021, Komisioni Disiplinor gjatë vitit raportues ka punuar që, në bashkëpunim të ngushtë me Këshillin e Lartë të

30 Neni 103, shkronja “dh” e Ligjit për Statusin, si dhe nga Seksioni “C”, shkronja “a” dhe “b” dhe Seksioni “Ç”, pika 9, shkronja “c” e Kodit të Etikës

Prokurorisë dhe Komisionin përkatës, të përfundojë hartimin dhe miratimin, brenda vitit të ardhshëm, të rregullave të përbashkëta për bashkimin e procedimeve, për rastet kur një gjyqtar ose një prokuror është përfshirë në të njëjtën shkelje disiplinore.

KOMISIONI I VLERËSIMIT TË ETIKËS DHE VEPRIMTARISË PROFESIONALE

Përbërja:

Kryetare: Brikena Ukperaj

Anëtarë: Irena Plaku, Ylka Rupa

Anëtar Zëvendësues:
Fatmira Luli Ridvan Hado

Komisioni në përputhje me rolin, funksionet dhe kompetencat, gjatë vitit 2022 ka zhvilluar 25 (njëzet e pesë) mbledhje, të cilat janë materializuar në 60 (gjashtëdhjetë) vendimmarrje, në lidhje me:

- Trajtimin e kërkesave të gjyqtarëve drejtuar Këshillit për çështje që janë në fushën e veprimtarisë së Komisionit dhe paraqitjen e tyre pranë Këshillit për vendimmarrje;
- Administrimin e kërkesave të gjyqtarëve për ushtrimin e veprimtarive jashtë funksionit dhe raportimin vjetor lidhur me këto veprimtari;
- Trajtimin e vazhdueshëm të dokumentacionit dhe praktikave të kaluara pranë Komisionit;
- Fillimin dhe zhvillimin e procedurave të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve për periudhat e vlerësimit 2013-2016, 2017-2019, vlerësimin e përshpejtuar të detyruar, në rastet e konkurrimit të gjyqtarëve për ngritje në detyrë, dhe vlerësimin etik dhe profesional për periudhën e vlerësimit 2018-2020, gjatë ushtrimit të detyrës së ndihmës magjistratit në Gjykatën e Lartë.

Nga këto, ndër më të rëndësishmet të materializuara me vendimmarrje nga ana e Këshillit janë:

- (i) akte administrative individuale për trajtimin e kërkesave të gjyqtarëve, ose për veprimtari të tjera;
- (ii) akte administrative në kuadër të bashkëpunimit me Shkollën e Magjistraturës në funksion të realizimit të programit të trajnimit fillestar dhe vazhdues;
- (iii) akte për fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve;
- (iv) akte për miratimin e projektraporteve të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve, nga të cilat 3 akte për përfundimin pa vendim përfundimtar të procedurave të filluara.

Gjatë vitit 2022, KVEVP-ja së bashku me Njësinë e Vlerësimit Etik dhe Profesional është angazhuar maksimalisht në kryerjen e procedurave të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve, duke pasur në fokus procedurat e vlerësimit të kandidatëve të kualifikuar për ngritje në detyrë dhe procedurat e gradimit, për gjyqtarët që kanë përfunduar me sukses me vendim të formës së prerë nga organet përkatëse procesin e rivlerësimit kalimtar.

Si rezultat i këtij angazhimi, gjatë vitit 2022, janë propozuar nga Komisioni 38 projektraporte³¹ për vendimmarrje nga të cilat 27 të miratuara nga KLGJ-ja në mbledhje plenare (16 për periudhën

³¹ 27 janë raporte vlerësimi etik-profesional të miratuara nga Mbledhja Plenare. Projektraporte të propozuara nga KVEVP janë në total 38. (21 për periudhën e vlerësimit 2013-2016, nga të cilat 16 janë miratuar dhe 5 në pritje për tu shqyrtuar nga mbledhja plenare; 7 për periudhën e vlerësimit të përshpejtuar të detyruar për vitin e fundit kalendarik, nga të cilat 6 janë miratuar dhe 1 në pritje për tu shqyrtuar nga mbledhja plenare; 1 për gjyqtarët e komanduar në struktura të tjera, miratuar nga mbledhja plenare; 9 për periudhën 2017-2019, nga të cilat 4 janë miratuar dhe 5 në pritje për tu shqyrtuar nga mbledhja plenare.)

e vlerësimit 2013-2016, 5 për periudhën e vlerësimit të përshpejtuar të detyruar për vitin e fundit kalendarik, 1 për gjyqtarët e komanduar në struktura të tjera dhe 5 për periudhën e vlerësimit 2017 – 2019). Në referim të parashikimeve të nenit 90 dhe 91 të Ligjit për Statusin dhe Programin e Vlerësimit për vitin 2021, KVEVP ka marrë të gjitha masat e nevojshme për përfundimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve të përfshirë në program, duke i dhënë përparësi procesit të gradimit të gjyqtarëve që kanë përfunduar procesin e rivlerësimit kalimtar dhe vlerësimit të kandidatëve të kualifikuar për ngritje në detyrë në Gjykatën e Lartë, gjykatat e posaçme dhe ato të apelit.

Në kuadër të bashkëpunimit me Shkollën e Magjistraturës, gjatë vitit 2022, KVEVP-ja është angazhuar edhe në procesin e miratimit të programit të trajnimit vazhdues, duke propozuar tema konkrete për trajnim, në përputhje me nevojat që kanë rezultuar nga ecuria e vlerësimit etik dhe profesional, referuar nenit 68, shkronja “ç” të Ligjit për Statusin.

1.4. KOMISIONET E PËRKOHSHME

Në vijim të respektimit dhe zbatimit të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, Këshilli i Lartë Gjyqësor, gjatë vitit 2022 ka krijuar ose ka vazhduar funksionimin përmes disa Komisioneve të Përkohshme të krijuara për të adresuar problematika të veçanta të sistemit gjyqësor të cilat nuk mbulohen nga veprimtaria e komisioneve të përhershme, sipas ligjit. Të tilla mund të përmenden:

- (i) Vlerësimi etik dhe profesional në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve;
- (ii) Verifikimi i plotësisë të kriterëve të kandidatëve për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë, që do të pranohen për të ndjekur Programin e Formimit Fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, viti akademik 2021-2022;
- (iii) Shqyrtimi i ankimeve kundër vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankesës ose pushimin e hetimit ndaj një gjyqtari.
- (iv) Komisioni i Përkohshëm për Mbrojtjen e Gjyqtarëve, të Familjes dhe të Pasurisë së tyre

Komisioni i përkohshëm për vlerësimin etik dhe profesional (në kuadër të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve)

Përbërja:

Dritan Hallunaj - Kryetar

Ilir Rusi - Anëtar

Ridvan Hado – Anëtar

Klodian Kurushi - Anëtar

Yllka Rupa – Anëtar

Ky Komision u krijua me vendimin nr. 15, datë 22.01.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, dhe përbëhet nga pesë anëtarë, 3 (tre) nga të cilët janë anëtarë gjyqtarë dhe 2 (dy) janë anëtarë jogjyqtarë. Përbërja e këtij komisioni ndryshoi gjatë vitit 2022, si pasojë e mbarimit të mandatit

të disa anëtarëve të tij, duke u ripërtërirë kështu me 2 (dy) anëtarë të rinj, me anë të vendimit nr. 88, datë 09.03.2022.

Komisioni ka zhvilluar veprimtarinë e tij në referim të nenit 171, pika 2 të ligjit nr. 115/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, sipas të cilit parashikohet detyrimi i Këshillave për të mbështetur organet e rivlerësimit kalimtar në realizimin e vlerësimit të aftësive profesionale, duke ndjekur udhëzimet dhe kërkesat e këtyre organeve dhe duke pasur parasysh faktin se dhënia e ndihmës për këto organe ka përparësi.

Në total gjatë vitit 2022, KPVEP ka kontrolluar dhe miratuar **30 (tridhjetë) raporte** të rivlerësimit dhe **30 (tridhjetë) relacione** për ndërprerjen e procesit të hartimit të raportit të rivlerësimit (si pasojë e ligjit). Gjithashtu në këto mbledhje është organizuar puna për zhvillimin e **15 (pesëmbëdhjetë) shorteve** për përzgjedhjen e 5 dosjeve/relacioneve për 15 subjekte të rivlerësimit, në funksionin e tyre si ndihmës ligjorë, pranë gjykatave përkatëse.

Deri tani, nën udhëzimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, janë zhvilluar edhe **14 (katërmëdhjetë)** shorte të tjera për përzgjedhjen e **70 relacioneve**, sipas një sistemi objektiv e rastësor, për 14 subjekte të tjera të rivlerësimit pranë Gjykatës Kushtetuese, Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës. Sa më sipër, mbeten për t’u zhvilluar vetëm 2 (dy) shorte për t’u quajtur i përfunduar i gjithë procesi i shortimit të të gjithë subjekteve të rivlerësimit, që kanë paraqitur formularin e vetëvlerësimit.

Në vijim të punës së tij, KPVEP ka proceduar me depozitimin e raporteve dhe të dosjeve gjyqësore pranë KPK-së grupuar sipas institucioneve. Bazuar në këtë qasje janë depozituar pranë KPK-së gjatë vitit 2022 gjithsej **30 raporte**³² të hollësishme dhe të arsyetuara, të shoqëruara me **150 dosje** gjyqësore për 30 subjekte të rivlerësimit kalimtar.

Komisioni i Përkohshëm për verifikimin e plotësimit të kritereve ligjore të pranimit në provimin e pranimit në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2022-2023, të kandidatëve për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë.

Përbërja:

Ilir Rusi - Kryetar

Ridvan Hado - Anëtar

Irena Plaku – Anëtare

Në janar të vitit 2022³³, Këshilli i Lartë Gjyqësor në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës, vendosi caktimin dhe publikimin e numrit maksimal të kandidatëve magjistratë, profili gjyqtar dhe ndihmës ligjorë³⁴ që do të pranohen në programin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2022-2023. Në funksion të këtij vendimi u ngrit edhe Komisioni i Përkohshëm për Verifikimin e Plotësimit të Kritereve të Kandidatëve për Këshilltarë dhe Ndhmës Ligjorë.

³² Dorëzimi i fundit u krye më datë 05.12.2022

³³ Me vendimin nr.41, datë 31.01.2022.

³⁴ Ndërsa, për vitin 2022-2023 nuk janë përcaktuar kuota për këshilltarë ligjor.

Konkretisht Komisioni i Përkohshëm ka verifikuar **gjithsej 82 kandidatë për ndihmës ligjorë**. Në përfundim të procesit të verifikimit, Komisioni përfundoi në përcaktimin e:

- listës emërore me 76 kandidatë për ndihmës ligjorë, që plotësojnë kriteret dhe 6 kandidatë që nuk i plotësojnë kriteret.

Nga ana tjetër, ky Komision bazuar në nenin 30, pika 4 e Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ka bërë komente dhe sugjerimeve në lidhje me rezultatet e vlerësimit paraprak nga Shkolla e Magjistraturës për aplikantët që kanë kandiduar për magjistrat, profili gjyqtar, me qëllim që ato të vlerësohen nga Shkolla e Magjistraturës, në kuadër të miratimit të raportit të vlerësimit përfundimtar. Konkretisht, Komisioni pas verifikimit të **357 dosjeve të aplikantëve për magjistrat, profili gjyqtar ka dhënë sugjerimet dhe kundërshtime për 3 (tre) kandidatë**.

Në janar të vitit 2022, Këshilli i Lartë Gjyqësor në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës, vendosi caktimin dhe publikimin e numrit maksimal të kandidatëve magjistratë, profili gjyqtar dhe ndihmës ligjorë.

Komisioni i Përkohshëm për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankesës ose pushimin e hetimit ndaj një gjyqtari

Përbërja:

Fatmira Luli - Kryetare

Dritan Hallunaj - Anëtar

Alban Toro - Anëtar

Anëtarë zëvendësues: Klodian Kurushi, Ilir Rusi

Ngritja e këtij komisioni vjen si detyrim i përcaktuar në nenin 62, të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”. Në funksion të organizimit të punës Komisioni ka hartuar dhe propozuar në Këshill rregulloren për organizimin dhe funksionimin e vetë komisionit.

Përgjatë vitit 2022, në Këshill janë grumbulluar gjithsej 147 ankime kundër vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankimit, 22 të mbartura gjatë vitit 2021 dhe 125 të regjistruara gjatë vitit raportues. Komisioni ka zhvilluar 14 mbledhje duke trajtuar dhe vendosur për 136 ankime si vijon:

- për 125 ankesa refuzimin si të pabazuara me vendim komisioni;
- për 6 ankesa mospranim ankimi me vendim relatori;
- për 5 ankesa, janë trajtuar në rrugë administrative me shkresa kthim përgjigje ose dërguar për kompetencë organit kompetent

Ndërkohë 11 ankesa i janë mbartur Komisionit të ri. Vlen të evidentohet fakti se, gjatë vitit 2022 nuk ka pasur asnjë vendimmarrje nga ana e Komisionit për shfuqizimin e vendimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Gjithashtu ka pasur vetëm një ankim të regjistruar në Këshill kundër vendimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për pushimin e hetimit ndaj një gjyqtari.

Komisioni i Përkohshëm për Mbrojtjen e Gjyqtarëve, të Familjes dhe të Pasurisë së tyre

Në zbatim të Vendimit Nr. 564, datë 31.09.2019 "Për kriteret dhe procedurat për mbrojtjen e veçantë të magjistratit gjatë ushtrimit të funksionit ose për shkak të tij", të Këshillit të Ministrave u krijua Komisioni për Mbrojtjen e gjyqtarëve, i cili ka në përbërjen e tij përfaqësues nga institucione të ndryshme shtetërore. Gjatë vitit 2022, Komisioni është mbledhur një herë duke vendosur marrjen e masës së mbrojtjes për një gjyqtar.

1.5. BASHKËPUNIMI I BRENDSHËM

Me qëllim forcimin e integritetit të gjyqësorit në vend si dhe përmbushjes së misionit të tij për qeverisjen e një sistemi gjyqësor me performancë të lartë dhe që meriton besimin e publikut, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka përmbyllur një vit të suksesshëm bashkëpunimi si me institucionet shtetërore dhe gjykatat ashtu dhe me grupet e interesit, partnerët ndërkombëtarë, përfaqësuesit e mediave dhe qytetarët.

Falë këtyre bashkëpunimeve, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka arritur të shënojë momente të rëndësishme dhe frytdhënëse të zbatimit të reformës në drejtësi, në përmbushje të detyrimeve kushtetuese dhe ligjore si dhe në përgjigje të vështirësive të krijuara në sistemin gjyqësor kryesisht nga mungesa e burimeve njerëzore.

Institucionet shtetërore:

Përgjatë vitit 2022, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vijuar bashkëpunimin e ngushtë me institucionet kryesore shtetërore në vend, ndër të cilat përmendim:

- Bashkëpunimin me **Kuvendin e Republikës së Shqipërisë** në kuadër të miratimit të buxhetit vjetor të institucionit si dhe propozimeve për ndryshime në paketën ligjore të sistemit të drejtësisë në tetor të vitit 2022 dhe raportimit mbi Gjendjen e Sistemit Gjyqësor dhe veprimtarinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Këshilli i Lartë Gjyqësor, në funksion të përmbushjes së kompetencave kushtetuese, ligjore dhe strategjike, si dhe për të garantuar funksionalitetin e gjykatave në funksion të ofrimit të shërbimeve gjyqësore për publikun, depozitoi raportin vjetor institucional si dhe informoi Kuvendin e Shqipërisë mbi panoramën gjithëpërfshirëse të gjendjes së gjyqësorit për vitin 2021 si dhe sfidat e së ardhmes për mirë-administrimin e tij.
- **Bashkëpunimin me Ministrinë e Drejtësisë** në kuadër të realizimit të projektit të përbashkët "Për riorganizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave të gjykatave". Më 11 mars 2022, Këshilli i Lartë Gjyqësor, së bashku me Ministrinë e Drejtësisë dhe institucionet e tjera të sistemit të drejtësisë, mbylli me sukses ciklin e konsultimeve publike mbi propozimin për "Hartën e Re Gjyqësore". Më datë 21 korrik 2022, Këshilli i Ministrave kurorëzoi punën 3-vjeçare të Grupit Ndërinstitucional të Punës, duke miratuar propozimin për "Hartën e Re Gjyqësore". Ndërkohë që po vijon puna për zbatimin e kësaj hartë në 3 faza të ndryshme.
- Në kuadër të zbatimit të hartës së re gjyqësore, si dhe për respektimin e standardeve të transparencës, aksesit në informacion apo trajtimit me dinjitet të qytetarëve, Kryetarja e

Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. Naureda Llagami, ka zhvilluar takime pune si me **Kryetarin e KLP-së, z. Alfred Balla më 30 mars 2022**, dhe me **Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale z. Besnik Dervishi**, dhe atë për **Mbrojtjen nga Diskriminimi z. Albert Gajda më 17maj 2022**.

- Në kuadër të zbatimit të reformës në drejtësi si dhe në përmbushje të detyrimit ligjor të plotësimit të vakancave të krijuara në sistemin gjyqësor në Shqipëri, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vijuar bashkëpunimin e ngushtë me **Shkollën e Magjistraturës**. Më datë 25 korrik 2022, në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, u zhvillua ceremonia e betimit për 23 magjistratë të profilit “gjyqtar” të cilët përfunduan Shkollën e Magjistraturës në vitin akademik 2021-2022.

Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe **Komisioni i Prokurimit Publik** nënshkruan më 6 tetor marrëveshjen e bashkëpunimit midis dy institucioneve. Kjo marrëveshje synon thellimin e bashkëpunimit institucional përmes realizimit të seminareve, konferencave, trajnimeve të përbashkëta, analizave dhe studimeve periodike, si dhe veprimtari të tjera në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Në kuadër të kësaj marrëveshje më datë 16 nëntor 2022 u zhvillua dhe workshop-i “Risqet e integritetit në prokurimet publike” me pjesëmarrjen e Kryetares së KLGJ-së.

Grupet e Interesit

Përfshirja e grupeve të interesit gjatë procesit të konsultimeve publike dhe jetësimit të projekteve apo masave konkrete të ndërmarra nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, ka qenë prioritet i punës së Këshillit. Në kuadër të përmirësimit të performancës së sistemit gjyqësor në vend dhe komunikimit të tij me publikun dhe median, Kryetarja dhe anëtarë të tjerë të Këshillit, kanë zhvilluar dhe kanë marrë pjesë në shumë aktivitete apo takime të rëndësishme, ndër të cilat do të veçonim:

- Në datën 29 Prill, Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. Naureda Llagami, mori pjesë në **konferencën shkencore ndërkombëtare me fokus “Sfidat aktuale të pushtetit gjyqësor në Shqipëri dhe proceset demokratizuese”**. Ky takim u organizua nga Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë, në bashkëpunim me Universitetin e Ekonomisë Botërore dhe Kombëtare të Sofies, Universitetin e Viterbos, Universitetin Aldo Moro të Barit, Universitetin Aleksandër Moisiu të Durrësit, Universitetin Kombëtar të Aviacionit të Ukrainës dhe Universitetin Alcide De Gasperi të Polonisë.
- Aktivitete janë zhvilluar edhe në kuadër të përmirësimit të komunikimit të KLGJ-së dhe gjykatave me publikun dhe mediat si dhe për shkëmbimin e përvojave midis gjyqtarëve të huaj dhe atyre shqiptar në këtë drejtim. Të tilla mund të përmenden: aktiviteti i zhvilluar nga **KLGGJ në bashkëpunim me Qendrën për Çështje të Informimit Publik, (INFOÇIP)**, në të cilën morën pjesë anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor për marrëdhëniet me publikun, znj. Marçela Shehu, 8 gjyqtarët për mediat, si dhe nëpunës civil gjyqësorë për marrëdhëniet me publikun. Shkëmbimi eksperiencave dhe sfidat e komunikimit me publikun ishin çështjet me të nxehta të diskutimit mes gjyqtarëve holandezë, përfaqësuesve të departamentit të komunikimit në Gjykatën e East Brabant, dhe përfaqësuesve të Shkollës së Magjistraturës së Holandës.
- Në këtë linjë kanë qenë edhe takimet e zhvilluara në **bashkëpunimin me Qendrën ALTRI**, me pjesëmarrje të gjyqtarëve dhe nëpunësve civilë të marrëdhënieve me median dhe publikun, përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile, partnerëve ndërkombëtarë,

si dhe përfaqësues të medias. Gjithashtu janë organizuar aktivitetet me tema “**Zhvillimi i komunikimeve me publikun dhe rritja e vizibilitetit të sistemit gjyqësor**”, tryeza e diskutimit “**Prezantimi i Projekt – Planit të Komunikimit për Sistemin Gjyqësor dhe mbështetja e Këshillit të Lartë Gjyqësor në zbatimin e tij**” konferenca “**Liria e shprehjes së gazetarëve nën këndvështrimin e çështjeve gjyqësore penale dhe civile me palë gazetarë për garantimin e një politike të tolerancës zero ndaj frikësimit dhe sulmeve kundër gazetarëve**” etj.

- Në kuadër të “**Ditës Kombëtare të Drejtësisë**”, më datë 10 maj, Këshilli i Lartë Gjyqësor, organizoi aktivitetin: “**Dita e dyerve të hapura**”, me qëllim për t’u dhënë mundësi studentëve të Fakulteteve të Drejtësisë, të njihen nga afër me punën dhe veprimtarinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor.
- Këshilli i Lartë Gjyqësor, me mbështetjen e programit të përbashkët i BE-së dhe KE-së për “**Forcimin e cilësisë dhe efikasitetit të drejtësisë në Shqipëri**” (SEJIII) prezantoi më datë 7 tetor 2022 “**Platformën e komunikimit elektronik midis gjykatës së rrethit gjyqësor Tiranë dhe avokatëve**”. Në kuadër të këtij bashkëpunimi, Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor Znj. Naureda Llagami, firmosi me datë 17 qershor 2022 **marrëveshjen e mirëkuptimit mbi zbatimin e projektit pilot “Përdorimi i postës elektronike për dërgimin e fletëthirrjeve nga Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë tek avokatët**” me Dhomën Kombëtare të Avokatisë, të përfaqësuar nga Kryetari i saj, z. Maksim Haxhia. (për më shumë lexoni Kapitullin mbi Teknologjinë e informacionit)
- Aktiviteti për prezantimin e **projektit të sistemit elektronik për matjen dhe vlerësimin e cilësisë së shërbimeve gjyqësore, përmes anketave të kënaqësisë së përdoruesve u zhvillua më datë 22 prill 2022**. Ky sistem inovativ, një iniciativë e Këshillit të Lartë Gjyqësor e mbështetur nga projekti i BE/KIE për “**Forcimin e Efikasitetit dhe Cilësisë të Drejtësisë në Shqipëri**”, iu prezantua përfaqësuesve të sistemit të drejtësisë, partnerëve ndërkombëtarë, shoqërisë civile dhe mediave, në një aktivitet publik të organizuar nga Këshilli i Lartë i Gjyqësor dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë. (për më shumë lexoni Kapitullin mbi Teknologjinë e informacionit)
- **Bashkëpunimi me gjykatat** dhe përfshirja e tyre në diskutimet e vazhdueshme mbi problematikat që has sistemi gjyqësor në vend si dhe adresimi i zgjidhjes së tyre ka qenë në fokus të punës së KLGJ edhe përgjatë këtij viti. Krahas këtyre takimeve periodike, vëmendje të veçantë në këtë kuadër marrin sidomos ceremonitë publike të betimit të gjyqtarëve në Gjykatën e Lartë, të dekretuar me dekret nga Presidenti i Republikës.

1.6. BASHKËPUNIMI I JASHTËM

Gjatë vitit 2022, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vijuar bashkëpunimin e ngushtë me partnerët ndërkombëtarë duke bërë të mundur realizimin e një sërë projektesh të rëndësishme për reformën në drejtësi në vend. Mbështetja teknike e financiare si dhe ekspertiza e vazhdueshme e tyre ka dhënë një kontribut të qenësishëm jo vetëm në shkëmbimin e eksperiencave dhe reflektimin mbi sfidat e përbashkëta të sistemeve të drejtësisë, por dhe në realizimin e projekteve të tjera në kuadër të procesit të Integritit Evropian.

Në kuadër të një marrëdhënieje tashmë të konsoliduar bashkëpunimi, Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. Naureda Llagami, ka zhvilluar vizita dhe takime pune me Ambasadorin e

Shteteve të Bashkuara të Amerikës SH.S.ZNJ. Yuri Kim, Ambasadorin e Bashkimit Evropian në Tiranë, SH.S.ZNJ. Christiane Hohmann, Drejtorin e Byrosë për Çështjet Ndërkombëtare të Narkotikëve dhe Ligjzbatimit z. John Kastning, si dhe përfaqësuesin për Shqipërinë të Qendrës për Ndërmjetësim të Integruar në Berlin, z. Simone Ceresa.

Qëllimi i takimeve dhe aktiviteteve të zhvilluara përgjatë këtij viti ka qenë diskutimi mbi rëndësinë dhe ecurinë e reformës në drejtësi si një parakusht për integrimin evropian të vendit, paraqitja e sfidave që has sistemi gjyqësor, si dhe prezantimi i arritjeve dhe rezultateve të Këshillit në vitin e katërt të funksionimit të tij.

TAKIMET NË KUADËR TË SHKËMBIMIT TË EKSPERIENCAVE

Në kuadër të forcimit të bashkëpunimit të ndërsjellë me partnerët ndërkombëtare përmes shkëmbimit të njohurive apo praktikave më të mira dhe zbatimit të nismave të përbashkëta, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka zhvilluar disa takime dhe aktivitete të rëndësishme gjatë vitit, ndër të cilat veçojmë:

- Më 21-22 mars 2022, Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor znj. Naureda Llagami mori pjesë në **tryezën ndërkombëtare të diskutimit me temë “Formësimi i Këshillave Gjyqësorë për të përballuar sfidat bashkëkohore”**, të zhvilluar në Romë, Itali. Aktiviteti i organizuar nga Komisioni i Venecias në bashkëpunim me Universitetin La Sapienza, Romë dhe Universitetin e Barcelonës, u zhvillua në një format hibrid me pjesëmarrjen e anëtarëve nga Komisioni i Venecias, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, Këshilli Konsultativ i Gjyqtarëve Evropian, si dhe anëtarë nga Këshilla të ndryshëm Gjyqësorë të vendeve perëndimore, si Spanja, Danimarka, Gjeorgjia, etj.
- **Vizita tre ditore që Këshilli i Lartë Gjyqësor zhvilloi në institucionin homolog, Këshillin e Lartë Gjyqësor Portugez**, në kuadër të projektit “Forcimi i Efikasitetit dhe Cilësisë së Drejtësisë në Shqipëri” (SEJ III) i bashkëfinancuar nga Bashkimi Evropian dhe Këshilli i Evropës. Qëllimi i kësaj vizite studimore, realizuar në 23 – 25 maj 2022, ishte shkëmbimi i informacionit dhe eksperiencave profesionale me fokus të veçantë në identifikimin e zgjidhjeve të reja teknologjike, bazuar në eksperiencën e sistemit elektronik të menaxhimit të çështjeve të Portugalisë.
- **Konferenca për krijimin e Rrjetit Rajonal të Këshillave Gjyqësorë** e organizuar me iniciativën e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut në të cilën Këshilli i Lartë Gjyqësor u përfaqësua nga Zv.Kryetari, z.Illir Rusi. Kjo konferencë u zhvillua në datat 31 tetor-1 nëntor 2022, në Shkup.
- **Takimi i përbashkët midis Këshillave të Lartë Gjyqësor në Shqipëri dhe Kosovë**, organizuar në kuadër të projektit “Forcimi i Efikasitetit dhe Cilësisë së Drejtësisë në Shqipëri” (SEJ III). Në këtë aktivitet, zhvilluar në 8 dhe 9 nëntor 2022, diskutimet u fokusuan në statistikat gjyqësore për të vlerësuar efikasitetin, cilësinë dhe reformat gjyqësore, vlerësimin e performancës së gjyqtarit, digjitalizimin e drejtësisë, përdorimin e mekanizmave alternative për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, menaxhimin e kohës gjyqësore dhe veprimet për të reduktuar çështjet e prapambetura.
- **Pjesëmarrja në Asamblenë e Përgjithshme të Rrjetit të Këshillave Gjyqësorë Evropian (ENCJ)**, zhvilluar në datat 1-3 qershor 2022, në Athinë, Greqi. Në këtë aktivitet mori pjesë Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. Naureda Llagami,

përfaqësuesit e Këshillave Gjyqësorë të të gjithë vendeve të BE-së, vendeve që gëzojnë statusin e vëzhguesit, si dhe të ftuar të tjerë nga organizatat partnere të rrjetit. Në këtë takim u diskutuan çështjet e pavarësisë dhe cilësisë së sistemeve gjyqësore, drejtësisë digjitale si dhe solidaritetit të nevojshëm për të tejkaluar sfidat në sistemet gjyqësore në kohë krizash.

- Në datë 5 maj 2022 Kryetarja e Këshillit, znj. Naureda Llagami e shoqëruar nga z. Dritan Hallunaj, Kryetar i Komisionit të Përkohshëm për Vlerësimin Etik dhe Profesional, pritën në një **takim pune delegacionin moldav**, në përbërje të të cilit ishin: z. Sergiu Litvinenco, Ministër i Drejtësisë së Moldavisë dhe përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë, Parlamentit, Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës, si dhe përfaqësues të shoqërisë civile. Fokusi i këtij takimi ishte diskutimi për çështje të veçanta me qëllim shkëmbimin e eksperiencave mes dy vendeve.
- Me rastin e “**Ditës Kombëtare të Drejtësisë**”, Këshilli i Lartë Gjyqësor në bashkëpunim me Këshillin e Evropës dhe me mbështetjen e programit të përbashkët të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës “Instrumenti Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë 2019-2022”, organizoi në 9 Maj 2022, konferencën “Drejtësi në kohë sfidash”. Qëllimi i kësaj konference ishte reflektimi mbi sfidat dhe vështirësitë që paraqet sistemi i drejtësisë në ditët e sotme dhe diskutimi mbi mënyrat se si mund të përballohen ato. E pranishme në këtë konferencë ishte edhe Ambasadorja e Shteteve të Bashkuara SH.S.ZNJ. Yuri Kim si dhe përfaqësues të tjerë të lartë nga institucionet e drejtësisë.
- Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. Naureda Llagami, mori pjesë në përmbylljen e projektit “**Monitorimi i SPAK-ut dhe Gjykatës Speciale: Ndërtimi i një rekordi të qëndrueshëm ndjekjesh penale dhe dënimesh**” të zhvilluar më datë 20 korrik 2022, nga Qendra për Studime Ligjore dhe Sociale (LSSC), me mbështetjen e Ambasadës së Mbretërisë së Vendeve të Ulëta. Projekti u fokusua në ndjekjen, monitorimin dhe analizimin e gjurmëve të veprimtarisë institucionale të SPAK dhe GJKKO-së, përgjatë një harku kohor 2-vjeçar.
- Konferenca ndërkombëtare me temë “**Modeli i përzgjedhjes, vlerësimit dhe promovimit të gjyqtarëve. Cilat kompetenca dhe aftësi kanë rëndësi? Praktikrat dhe tendencat më të mira**”, të organizuar në bashkëpunim me Gjykatën e Lartë dhe partnerë të tjerë të shoqërisë civile. Në këtë aktivitet mori pjesë Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor si dhe disa anëtarë të tij. Përfaqësues të institucioneve të drejtësisë dhe botës akademike nga Republika Çeke, Italiane, Polake, Lituanëze, etj., ishin gjithashtu të ftuar dhe folës në këtë konference, me fokus sistemet e ndryshme të karrierës gjyqësore. Çështjet e standardeve dhe procedurave mbi përzgjedhjen, emërimin, vlerësimin dhe ngritjen në detyrë të gjyqtarëve, duke filluar nga modeli shqiptar, sfidat, praktikrat e tij dhe deri te modelet dhe metodat e avancuara ndërkombëtare në këtë drejtim, ishin në qendër të diskutimeve mes pjesëmarrësish.
- KLGJ-ja, në bashkëpunim me Fondacionin Gjerman për bashkëpunim Ligjor Ndërkombëtar (IRZ) më datë 8 prill 2022, organizoi **konferencën virtuale “Forcimi i Efikasitetit të Drejtësisë Administrative në Shqipëri**”. Kjo konferencë kishte si qëllim shkëmbimin e përvojave mes përfaqësuesve të sistemit gjyqësor shqiptar dhe atij gjerman për çështje të përbashkëta me fokus gjykimin dhe procedurat administrative. Në këtë aktivitet ishin të ftuar personalitete të drejtësisë shqiptare dhe asaj gjermane. Në vijim, një tjetër aktivitet u zhvillua në datat 26 – 30 shtator 2022 në **formën e vizitës studimore**

të organizuar në Gjermani, me pjesëmarrjen e Kryetares së Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe një anëtare të tij, si dhe disa gjyqtarëve, përfaqësues nga sistemi gjyqësor. Shkëmbimi i përvojave në lëmin e drejtësisë administrative dhe rritja e efikasitetit në gjykimin administrativ ishin çështjet kryesore që dominuan diskutimet e pjesëmarrësve.

TAKIMET NË PLANIN E PROCESIT TË INTEGRIMIT

Shqipëria ka hyrë tashmë në një fazë të rëndësishme të marrëdhënieve me Bashkimin Evropian. Kjo për faktin se në korrik të vitit 2022, BE vendosi hapjen e negociatave për Shqipërinë duke i hapur rrugë zhvillimit të fazës së parë të procesit të shqyrtimit (scrëning). Në kuadër të këtij procesi, përfaqësuesit e Këshillit të Lartë Gjyqësor ishin pjesë e delegacionit shqiptar, si në takimet shpjeguese zhvilluar në shtator 2022, ashtu edhe takimet bilaterale, të organizuara në Bruksel nga Komisioni Evropian mbi kapitullin 23 “Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore”. Gjatë takimit dypalësh organizuar më 23-24 nëntor 2022, Kryetarja e Këshillit prezantoi para Komisionit Evropian zhvillimet e ndërmarra në kuadër të përafrimit me standardet dhe praktikatat me të mira ndërkombëtare në fushën e gjyqësorit dhe të drejtave të njeriut.

AKTIVITET PËRMBYLLËS

Cikli i aktiviteteve të Këshillit të Lartë Gjyqësor për vitin 2022 u përmbyll me takimin e Nivelit të Lartë me temë “Drejt Ekselencës Gjyqësore” me të pranishëm Ambasadoren e SHBA-së, SH.S.ZNJ. Yuri Kim, Zëvendëspresidentin e Institutit të Menaxhimit Lindje-Perëndim z. Mark Dietrich, Zëvendëskryetarin e Gjykatës së Lartë z. Sokol Sadushi, z. Pim Albers, Ekspert për Administrimin Gjyqësor si dhe përfaqësues të nivelit të lartë nga institucionet e drejtësisë, trupës gjyqësore dhe aktorë të tjerë që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në fushën e drejtësisë. Ky aktivitet, i zhvilluar nga KLGJ-ja më 13 dhjetor 2022, u organizua në bashkëpunim me Projektin “Ulja e numrit të çështjeve të prapambetura dhe përmirësimi i efikasitetit në Gjykatën e Lartë të Shqipërisë”, zbatuar nga Instituti i Menaxhimit Lindje – Perëndim (EWMI), me mbështetjen e Byrosë për Çështjet Ndërkombëtare të Narkotikëve dhe Ligjzbatimit, Departamenti Amerikan i Shtetit (INL). Në këtë aktivitet, që shënoi përmbylljen e vitit të 4-t të funksionimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, u prezantuan arritjet institucionale të këtij katërvjeçar të cilat vendosën standarde të reja në sistemin e drejtësisë shqiptare duke e ndarë njëherë e përgjithmonë këtë të fundit nga drejtësia e vjetër.

Për më shumë informacion lidhur me aktivitetet e vazhdueshme të Këshillit të Lartë Gjyqësor, jeni të lutur të vizitoni rubrikën “Njoftime”, në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, në adresën si vijon: <http://klgj.al/njoftime/>

Të rëndësishme:

Gjatë vitit 2022, KLGJ-ja ka:

- ❖ zhvilluar rreth 114 mbledhje plenare ose 13% më shumë se viti që shkoi
- ❖ marrë 562 vendimmarrje, nga të cilat 552 janë propozuar nga komisionet e përhershme dhe 10 nga komisionet e përkohshme.
- ❖ përfshirë në skemën e delegimit 10 gjyqtarë dhe në mekanizmin e transferimit me pëlqim 9 gjyqtarë për një periudhë tjetër 1-vjeçare.
- ❖ finalizuar procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore, të pasurisë dhe të figurës, për 45 kandidatët për formimin fillestar, për magistratët, profili gjyqtar, në Shkollën e Magistraturës, për vitin 2022-2023.

Veprimtaria e Komisioneve të Përhershme:

- ❖ Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, ka zhvilluar 40 mbledhje dhe propozuar 100 projektvendime.
- ❖ Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka propozuar gjithsej 377 projektvendime.
- ❖ Komisioni Disiplinor ka kaluar për shqyrtim në mbledhje plenare gjithsej 5 procedura disiplinore dhe ka propozuar 15 akte.
- ❖ Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale ka zhvilluar 25 mbledhje dhe propozuar 60 projektvendime.

Veprimtaria e Komisioneve të Përkohshme:

- ❖ Komisioni për vlerësimin etik dhe profesional në kuadër të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve, ka depozituar 30 raporteve pranë KPK/ONM për 30 subjekte të rivlerësimit kalimtar grupuar sipas institucioneve gjatë vitit 2022. Nga fillimi i procesit të rivlerësimit janë dorëzuar pranë KPK/ONM 379 raporte.
- ❖ Komisioni për verifikimin e plotësimin të kriterëve ligjore të pranimit në provimin e pranimit në Shkollën e Magistraturës, për vitin akademik 2022-2023, të kandidatëve për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë.
- ka verifikuar gjithsej 82 kandidatë për ndihmës ligjorë
- pas verifikimit të 357 dosjeve të aplikantëve për magistrat, profili gjyqtar ka dhënë sugjerimet për 3 (tre) kandidatë.
 - ❖ Komisioni për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankesës ose pushimin e hetimit ndaj një gjyqtari
- Ka shqyrtuar 106 ankime duke vendosur refuzimin e tyre si të pabazuar nga 125 të regjistruara në total.
- për 4 ankesa është vendosur me vendim relatori mospranim ankimi;
- për 5 ankesa janë trajtuar në rrugë administrative me shkresa kthim përgjigje ose dërguar për kompetencë organit kompetent,
 - ndërsa 10 ankesa i janë në proces.
- ❖ Mozaik i larmishëm bashkëpunëtorësh dhe partnerësh të brendshëm e të jashtëm që kanë kontribuar jetësimin e misionit të KLGJ-së.

2. MENAXHIMI I BURIMEVE

Si çdo vit, me qëllim mirëfunksionimin e strukturës administrative të KLGJ-së edhe vetë sistemit gjyqësor, menaxhimi dhe optimizimi i burimeve njerëzore dhe financiare mbetet në qendër të veprimtarisë së Këshillit të Lartë Gjyqësor edhe përgjatë vitit 2022.

2.1. BURIMET NJERËZORE TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

Sikurse është bërë e njohur tashmë, struktura organizative e Këshillit përbëhet nga 11 anëtarë dhe 117 nëpunës civilë e punonjës administrativë. Pra në tërësi, Këshilli i Lartë Gjyqësor ushtron funksionin e tij me një strukturë organizative të përbërë nga 128 punonjës. Për vitin kalendarik 2022, organika faktike e KLGJ-së, është e përbërë nga 106 nëpunës/punonjës në total.

Sa i përket raportit gjinor të stafit, rezultojnë 63 punonjës të gjinisë femërore si dhe 43 punonjës të gjinisë mashkullore, e cila e përkthyer në përqindje rezulton 59.4% e stafit janë punonjëse femra përkundrejt 40.6% e totalit, të cilët janë punonjës meshkuj. Nga një analizë krahasuese me vitin paraardhës, rezulton se përqindja e punonjësve të gjinisë femërore është rritur me rreth 4%.

Për nivelin e lartë drejtues aktualisht janë 2 nëpunës në funksion (sekretar i përgjithshëm/drejt departamenti) dhe 14 nëpunës të nivelit të mesëm drejtues (5 drejtorë drejtorie dhe 9 këshilltarë të komisioneve). Raporti gjinor rezulton 12 ose 75% e nëpunësve të nivelit të lartë dhe të mesëm drejtues janë të gjinisë femërore si dhe 4 ose 25% janë meshkuj. Edhe në këtë rast, përqindja e nëpunësve të nivelit të lartë dhe të mesëm drejtues të gjinisë femërore, krahasuar me vitin paraardhës, është rritur me rreth 38%.

Me qëllim mbarëvajtjen e punës, mirëfunksionimin e institucionit, si dhe plotësimin e pozicioneve vakante ekzistuese, gjatë vitit 2022 kanë përfunduar 22 procedura rekrutimi, për 23 pozicione vakante, ndër të cilat 20 prej tyre kanë përfunduar me sukses, më konkretisht:

- 1 pozicion i nivelit të lartë drejtues,
- 4 pozicione të nivelit të mesëm drejtues,
- 5 pozicione të nivelit të ulët drejtues,
- 10 pozicione të nivelit ekzekutiv.

Referuar raportit të monitorimit të ndërmarrë nga Instituti për Studime Politike dhe Ligjore (IPLS) për institucionet e ndryshme të drejtësisë theksohet se, rritja profesionale e stafit të KLGJ-së shërben si premisë për konsolidimin e institucionit, si dhe ushtrimin e detyrave kundrejt gjyqësorit me profesionalizëm, efikasitet dhe në përputhje me standardet e kërkuara. Ky indikator mat numrin e këshilltarëve dhe administratës së KLGJ-së, e cila është trajnuar mbi detyrat funksionale, në raport me numrin e gjithë këshilltarëve dhe administratës së KLGJ-së përgjatë periudhës së monitorimit. Ky indikator ndonëse vlerëson vëmendjen që KLGJ-ja i kushton rritjes profesionale të stafit (në nivel politik dhe administrativ) dhe realizimin faktikisht të një prej detyrave që ka KLGJ-ja në lidhje me trajnimin e vazhdueshëm të burimeve njerëzore sugjeron që të rritet numri i trajnimeve për të gjitha kategoritë e punonjësve në institucion. Indikator shërben si tregues për fuqizimin e Kapaciteteve të Brendshme të KLGJ-së, që përbën gjithashtu dhe një ndër synimet e Planit Strategjik të KLGJ-së për vitet 2022-2024 për të përballuar me sukses sfidat e sistemit gjyqësor.

Vlerësimi i rezultateve në punë në KLGJ

Gjatë vitit 2022, në KLGJ janë kryer të gjitha vlerësimet e rezultateve të punës për stafin administrativ pjesë e shërbimit civil të institucionit. Ky proces është ndërmarrë me qëllim

verifikimin e realizimit të objektivave të përgjithshme të përcaktuara si në nivel institucional ashtu edhe individual, vlerësimit të aftësive apo evidentimit të mangësive në ushtrimin e detyrave funksionale, zhvillimit të aftësive profesionale të punonjësve dhe vlerësimit të nevojave për trajnim. Kjo veprimtari vlerësuese është realizuar në zbatim të VKM-së nr. 109, datë 26.02.2014 “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, i ndryshuar, dhe është një proces i cili realizohet 2 herë në vit.

2.2. BURIMET NJERËZORE TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

Numri i punonjësve, sipas strukturës organizative të gjykatave të të gjitha niveleve për vitin 2022, është 1595 punonjës, nga të cilët 408 gjyqtarë dhe 1187 administratë gjyqësore. Në tabelën në vijim gjendet një informacion i detajuar i shpërndarjes faktike të tyre:

Gjykata	Totali		Gjyqtarë			Administratë		
	Str. organiz	Org. fakt	Dekreti	Org. fakt	Vakanca	Str. organiz	Org. fakt	Vakanca
Gjykata e Lartë	145	117	19	16	3	126	101	25
Gjykatat e Apeleve	386	294	102	64	38	284	230	54
Gjykatat e Shkallës së Parë	922	836	251	206	45	671	630	41
Gjykatat Adm. Shkallës së Parë	142	128	36	32	4	106	96	10
Totali	1595	1375	408	318	90	1187	1057	130

a. Magjistratë

Në dhjetor të vitit 2022, numri total i gjyqtarëve faktik në sistemin gjyqësor ishte 318 gjyqtarë (nga 408 të përcaktuar me dekret). Në tabelën në vijim gjendet një informacion i detajuar i shpërndarjes faktike të gjyqtarëve:

Gjykata	Gjyqtarë në vitin 2022		
	Struktura organizative	Organika në fakt	Efektivisht në detyrë
Gjykata e Lartë	19	16	15
Gjykatat e Apeleve	102	64	46
Gjykatat e Rretheve	251	206	142
Gjykatat Adm. Shkallës së Parë	36	32	25
Totali	408	318	228

Ndërkohë, numri i gjyqtarëve që efektivisht kanë ushtruar funksionin është 228 në të njëjtën periudhë kohore. Kjo nënkupton se sistemi gjyqësor gjatë 2022 ka funksionuar me pothuajse 55.8% të kapacitetit të tij.

Gjatë vitit 2022, janë emëruar 23 magjistratë të cilët kanë përfunduar programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës në vitin akademik 2021-2022.

Vlen për të theksuar se, KLGJ-ja i kushton vëmendjen e nevojshme burimeve njerëzore në sistem si përmes proceseve të emërimeve, promovimeve, transferimeve etj., ashtu dhe për sa i përket

ngritjes së kapaciteteve të tyre. Ky fakt evidentohet dhe në raportin e monitorimit të zhvilluar nga IPLS, në të cilin theksohet se KLGJ-ja zotëron burime (financiare dhe infrastrukturore) të nevojshme për të ushtruar aktivitetin dhe veprimtarinë e saj.

Për sa i përket humbjeve nga sistemi si pasojë e procesit të rivlerësimit kalimtar, vlen të theksohet se që nga fillimi i procesit rezultojnë 65 vendimmarrje të KPA-së, nga të cilat 22 vendimmarrje i përkasin vitit 2022.

Nga fillimi i procesit të rivlerësimit kalimtar, me vendim të KPK-së janë shkarkuar nga detyra në total 126 gjyqtarë (magjistratë), me një efekt financiar 413,432,637 lekë deri në 31 dhjetor 2022. Ndërkohë që aktualisht rezultojnë 65 gjyqtarë³⁵ (magjistratë) të shkarkuar nga detyra, me vendimmarrje KPK-je, të cilët presin zhvillimin e procesit në KPA, duke mbajtur ndërkohë statusin e gjyqtarit për shkak të pezullimit, por duke përfituar njëkohësisht sipas ligjit 75% të pagës. Efekti financiar aktual është prej 184,337,667 lekë.

b. Administrata gjyqësore

Për sa i përket numrit faktik të punonjësve të administratës gjyqësore, për të gjitha gjykatat, në dhjetor të vitit 2022 rezulton të jenë në total 1057 punonjës nga 1187 punonjës sipas strukturës organizative. Referuar ligjit nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, Këshillit të Lartë Gjyqësor, për vitin 2022, iu akorduan 50 punonjës/pozicione shtesë, prej të cilëve 3 punonjës iu akorduan Këshillit të Lartë Gjyqësor (2 nëpunës civilë dhe 1 punonjës administrativ). Për sa i përket 47 punonjësve të tjerë shtesë, 31 prej tyre i përkisnin kategorisë së nëpunësve civilë dhe 16 të tjerë kategorisë së punonjësve administrativë. Kjo shpërndarje e burimeve njerëzore është kryer në 17 gjykata të vendit në përputhje me nevojat dhe kërkesat konkrete të tyre. Ajo u materializua me vendimin nr. 72, datë 23.02.2022 “Për detajimin e numrit të punonjësve për vitin 2022”, përmes të cilit KLGJ-ja ka kryer detajimin e numrit të punonjësve të njësive shpenzuese në varësi të saj, përcaktuar në ligjin vjetor të buxhetit të vitin 2022.

Më konkretisht, me numrin e punonjësve të miratuar për vitin 2021, raporti i gjyqtarëve me stafin administrativ ishte 1:2.8 (pra 1 gjyqtar me 2.8 staf mbështetës³⁶), ndërsa me numrin e miratuar për vitin 2022, raporti u përmirësua në 1 gjyqtar me 3.3 staf mbështetës. Kjo shpërndarje synon përafrimin me standardet e parashikuara nga Ligji 98/2016, të cilat janë në linjë me standardet evropiane mbi numrin e punonjësve jo-gjyqtar që duhet të kenë gjykatat në raport me gjyqtarët. Pavarësisht përpjekjeve maksimale, përsëri ka mungesa të stafit administrativ dhe mbingarkesë pune për disa pozicione. Me qëllim adresimin e këtij problemi KLGJ-ja gjatë vitit 2022 ka nisur zbatimin e hartës së re gjyqësore me qëllim riorganizimin e gjykatave e të gjithë vendit duke i rigrupuar ato dhe ekuilibruar ngarkesën e çështjeve për gjyqtarë. Ndikim të pritshëm, harta e re gjyqësore pritet të japë dhe në ekuilibrimin e raportit të stafit administrativ me numrin e gjyqtarëve.

Analiza e situatës

³⁵ Ndërkohë, gjatë vitit 2022 janë 16 gjyqtarë të shkarkuar nga detyra, me vendimmarrje KPK-je.

³⁶ Raporti është përlogaritur referuar organikës në fakt në gjykatat e të gjitha niveleve, konkretisht 1057 punonjës administrativ/318 gjyqtarë sipas organikes në fakt në datë 31.12.2022.

Pavarësisht rekrutimeve të reja në sistem, burimet njerëzore (përfshirë gjyqtarë dhe administratë gjyqësore në gjykatat e të gjitha niveleve) mbeten akoma në nivele të ulëta krahasuar me standardet e sistemeve gjyqësore evropiane.

Nga të dhënat që disponon Drejtoria e Burimeve Njerëzore rezulton se numri i vakancave në sistem, për magjistratët (gjyqtarë) është 180 vakanca (nga të cilat 90 të përhershme dhe 90 vakanca të përkohshme), ndërsa për administratën gjyqësore rezultojnë 130 vakanca.

Nëse marrim në shqyrtim një ndër treguesit e menaxhimit të burimeve njerëzore që përdoret edhe nga CEPEJ, pra numrin e gjyqtarëve në raport me popullsinë, vihet re, sipas tabelës së mëposhtme, që Shqipëria është ende larg mesatares evropiane.

	Dekreti	Fakti	Efektivisht	Mesatarja Evropiane
Gjyqtarë / 100 mijë banorë	14.60	11.38	8.16	22.2 ³⁷

Numri i stafit jogjyqtar për 100,000 mijë banorë për Shqipërinë për vitin 2022 sipas organikës në fakt është **37.84**, kundrejt mesatares evropiane për vitin 2020 prej **55.5**³⁸. Pra, sërish rezulton se, pavarësisht shtimit të burimeve njerëzore në administratën gjyqësore, kjo administratë gjyqësore, në raport me numrin e popullsisë, vijon të mbetet larg mesatares evropiane.

Të dy këto faktorë, si numri i gjyqtarëve në raport me popullsinë, ashtu edhe numri i stafit të administratës gjyqësore në raport me popullsinë ndikojnë edhe në tregues të tjerë të efijencës së sistemit dhe rrjedhimisht në ofrimin e një drejtësie pa vonesa.

Ndërkaq, raporti midis gjyqtarëve dhe administratës gjyqësore, pra numri mesatar i punonjësve në mbështetje të punës së një gjyqtari, me gjithë përmirësimet e viteve të fundit, sërish mbetet nën mesataren evropiane nëse i referohemi strukturës organizative. Kjo e dhënë rritet artificialisht mbi mesataren evropiane nëse i referohemi të dhënave faktike (që ndikohen ndjeshëm nga numri i ulët i gjyqtarëve në detyrë), sipas tabelës së mëposhtme:

	Dekreti	Fakti	Efektivisht	Mesatarja Evropiane
Gjyqtarë / staf administrativ gjyqësor	2.9	3.3	4.6	3.9 ³⁹

2.3. ZHVILLIMI I BURIMEVE NJERËZORE

Zhvillimi dhe menaxhimi i burimeve njerëzore mbeti dhe gjatë vitit raportues një ndër sfidat kryesore për Këshillin e Lartë Gjyqësor, si në lidhje me mirë - funksionimin e strukturës administrative të KLGJ-së ashtu edhe për sistemin gjyqësor.

³⁷ Mesatarja sipas CEPEJ 2022 me të dhënat e vitit 2020, rezulton 22.2 (fq.48)

³⁸ <https://public.tableau.com/app/profile/cepej/viz/OvervieëEN/Overvieë>

³⁹ Referuar raportit të CEPEJ viti 2022 me të dhënat e vitit 2020 rezultojnë 3.9, (Fq.54)

Për sa i përket menaxhimit dhe zhvillimit të burimeve njerëzore, është e rëndësishme të theksojmë se veprimtaria e Këshillit është fokusuar në dy drejtime kryesore:

1. Së pari në rritjen e kapaciteteve njerëzore në gjykata, përmes rritjes së kuotave për kandidatë magjistratë (në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës) dhe përmirësimin e efikasitetit në menaxhimin e burimeve njerëzore nëpërmjet transferimit, delegimit dhe caktimit të gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve të veçanta. Numri i magjistratëve të emëruar për herë të parë në sistem nga viti 2019 në vitin 2022 është me 71 magjistratë nga të cilët 4 gjyqtarë në Gjykatën e Lartë nga radhët e juristeve të spikatur dhe 67 magjistratë të diplomuar nga Shkolla e Magjistraturës.
2. Së dyti në zbatimin e reformës për nëpunësin civil gjyqësor si një detyrim ligjor me qëllim krijimin e një administrate të qëndrueshme dhe profesioniste. Kjo në funksion të rritjes së efikasitetit, evadimit të stokut të çështjeve gjyqësore, mbështetjes dhe ndihmës ndaj trupës së gjyqtarëve, dhe shërbimit në kohë e me cilësi publikut, në përputhje edhe me objektivat e planit strategjik të Këshillit. Në këtë drejtim vlen të përmendet se numri i nëpunësve civilë gjyqësorë nga viti 2019 deri në fund të vitit 2022 është shtuar me 89 punonjës⁴⁰.

4.3.1. ZHVILLIMI PROFESIONAL I GJYQTARËVE DHE STAFIT ADMINISTRATIV

Gjatë vitit 2022, në funksion të arritjes së objektivave strategjike, Këshilli i Lartë Gjyqësor, i ka kushtuar një hapësirë të veçantë zhvillimit profesional dhe etik të burimeve njerëzore si në KLGJ ashtu edhe në gjykata.

Me qëllim rritjen profesionale të trupës gjyqësore dhe stafit administrativ, por dhe forcimit e ruajtjes së një mjedisi pune motivues, janë zhvilluar trajnime në përputhje edhe me kërkesat e punonjësve. Më konkretisht, gjatë vitit raportues janë trajnuar:

- 220 gjyqtarë ose 96.5 % e gjyqtarëve që ushtrojnë efektivisht detyrën, të cilët kanë marrë pjesë në trajnimet e programit vazhdues të zhvilluara nga Shkolla e Magjistraturës.
- 13 nëpunës ose 12.3 % e stafit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të cilët janë trajnuar nga ASPA në përputhje me nevojat për trajnim.

Ndërsa për nëpunësit civilë gjyqësorë në gjykatat e të gjitha niveleve janë zhvilluar trajnime në lidhje me funksionet dhe detyrat, si më poshtë:

- 51 nëpunës civilë gjyqësorë të trajnuar nga partnerët ndërkombëtarë;
- 18 nëpunës civilë gjyqësorë të trajnuar nga Shkolla e Magjistraturës;
- 34 nëpunës civilë gjyqësorë të trajnuar nga ASPA.

Më poshtë mund të përmenden disa nga temat më të rëndësishme për të cilat janë trajnuar nëpunësit civilë gjyqësorë nëpër gjykata.

- “Mbi përdorimin e Sistemit të Integruar nga administrata gjyqësore”
- “Zhvillimi i komunikimeve me publikun dhe rritja e vizibilitetit të sistemit gjyqësor”,
- “Mbi caktimin e personave të autorizuar për përdorimin e sistemit të integruar të dhënave të drejtësisë penale për të mitur”,
- "Mbi Administrimin gjyqësor të nëpunësve civilë gjyqësorë",
- " Mbi Dixhitalizimin e Arshivës".

“Mbi përgatitjen e projektbuxhetit afatmesëm”

⁴⁰ Numri i nëpunësve civilë gjyqësorë në vitin 2019 rezulton 655 pozicione sipas organikës në fakt dhe në fund të vitit 2022 referuar organikës në fakt ky numër rezulton 744 pozicione.

Të rëndësishme!

- ❖ Organika faktike e KLGJ-së është e përbërë nga 106 nëpunës/punonjës në total nga 128 miratuar me ligj.
- ❖ Trajnuar rreth 12.3% e punonjësve të KLGJ-së dhe rreth 96.5 % e gjyqtarëve që ushtrojnë efektivisht detyrën.
- ❖ Organika faktike e sistemit gjyqësor përbëhet nga 1057 punonjës të administratës gjyqësore nga 1187 sipas strukturës organizative.
- ❖ Administrata gjyqësore u rrit me 50 punonjës/pozicione shtesë, prej të cilëve 3 punonjës iu akorduan Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe 47 gjykatave të vendit.
- ❖ 16 gjyqtarë janë larguar nga sistemi gjatë vitit 2022 si pasojë e shkarkimit me vendim të KPK-së , dhe aktualisht janë 65 gjyqtarë të shkarkuar në total nga ky organ në pritje të zhvillimit të procesit të KPA-së.
- ❖ 228 gjyqtarë, ose më pak se 55,8 % kanë ushtruar efektivisht detyrën referuar numrit prej 408 gjyqtarë të parashikuar në dekretin e Presidentit.
- ❖ Numri prej 8.16 gjyqtarësh efektivisht në detyrë për 100 mijë banorë, ndonëse ka pasur një rritje nga 7.91 krahasuar me një vit më parë, mbetet shumë larg mesatares evropiane prej 22.2 gjyqtarësh për 100 mijë banorë.
- ❖ Numri i stafit jogjyqtar për 100,000 mijë banorë sipas organikës në fakt është 37.84, kundrejt mesatares evropiane për vitin 2020 prej 55.5.

2.4. VEPRIMTARIA FINANCIARE

Për vitin 2022, me ligjin nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, është miratuar buxheti i shtetit për vitin 2022, pjesë e të cilit është edhe buxheti për sistemin gjyqësor (grupi buxhetor Këshilli i Lartë Gjyqësor), i cili është i përbërë nga tre programe buxhetore, si më poshtë;

- Programi buxhetor 01110, “**Planifikim, Menaxhim dhe Administrim**”, ku përfshihen fondet buxhetore, për funksionimin e veprimtarisë së Këshillit të Lartë Gjyqësor.
- Programi buxhetor 01140, “**Mbështetje për Teknologjinë e Sistemit të Drejtësisë**”, ku përfshihen kërkesat buxhetore për funksionimin e Qendrës së Teknologjisë së Informacionit (QTI)
- Programi buxhetor 03310, “**Buxheti Gjyqësor**”, ku përfshihen fondet buxhetore, për funksionimin e veprimtarisë së gjykatave në të tre nivelet.

Fondet buxhetore të sistemit gjyqësor, të rishikuara gjatë viti buxhetor, së bashku me realizimin tyre për periudhën 12-mujore, sipas grup shpenzimeve paraqiten në pasqyrën e mëposhtme:

Pasqyra nr.1,


Buxheti i miratuar, i ndryshuar dhe realizuar për Sistemin Gjyqësor për vitin 2022

000 lekë

Nr	Emërtimi	Buxheti i miratuar për vitin 2022	Ndryshime gjatë vitit 2022	Buxheti i rishikuar për vitin 2022	Realizimi për vitin 2022	Realizimi për vitin 2022
01	Shpenzime paga	2,499,260	-272,441	2,226,819	2,081,805	93%
02	Shpenzime sig. shoq. e shëndetësore	306,000	-42,840	263,160	254,881	97%

03	Shpenzime operative	536,398	38,379	574,777	538,726	94%
04	Shpenzime transfert familjar e individ	6,150	22,820	28,970	24,800	86%
05	Shpenzime kapitale (Investime)	412,000	-27,000	385,000	333,743	87%
	Totali	3,759,808	-281,082	3,478,726	3,233,955	93%

Gjatë vitit buxhetor 2022, buxheti i sistemit gjyqësor është rishikuar disa herë, duke u pakësuar në vlerën totale prej 288,152 mijë lekë, (nga të cilat në shpenzime paga në vlerën 170,481 mijë lekë, shpenzime sigurime shoqërore në vlerën 19,650 mijë lekë, shpenzime operative në vlerën 71,021 mijë lekë dhe shpenzime kapitale në vlerën 27,000 lekë), si më poshtë vijon:



- Pakësimi i buxhetit me Aktin Normativ nr.3, datë 12.03.2022, në vlerën 130,152 mijë lekë (nga të cilat në programin 01110 – “Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi” në vlerën 18,162 mijë lekë, në programin 01140 – “Mbështetje për teknologjinë e sistemit të drejtësisë” në vlerën 396 mijë lekë dhe në programin 03310 - “Buxheti Gjyqësor” në vlerën 111,594 mijë lekë).
- Pakësimi i buxhetit me Aktin Normativ nr.12, datë 29.07.2022, në vlerën 25,000 mijë lekë (nga të cilat në programin 01110 – “Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi” në vlerën 5,000 mijë lekë dhe në programin 03310 - “Buxheti Gjyqësor” në vlerën 20,000 mijë lekë).

Pakësimi i buxhetit me Aktin Normativ nr.17, datë 01.12.2022, në vlerën 133,000 mijë lekë (nga të cilat në programin 01110 – “Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi” në vlerën 2,500 mijë lekë, në programin 01140 – “Mbështetje për teknologjinë e sistemit të drejtësisë” në vlerën 4,000 mijë lekë dhe në programin 03310 - “Buxheti Gjyqësor” në vlerën 126,500 mijë lekë).

Rishpërndarja e fondeve buxhetore me Aktin Normativ nr. 19, datë 29.12.2022 në vlerën 19,250 mijë lekë (nga të cilat pakësimin në shpenzime paga dhe shtimin në shpenzime të tjera korrente, në programin 01110 – “Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi” në vlerën 1,440 mijë lekë, në programin 01140 – “Mbështetje për teknologjinë e sistemit të drejtësisë” në vlerën 10 mijë lekë dhe në programin 03310 - “Buxheti Gjyqësor” në vlerën 17,800 mijë lekë).


Fondet buxhetore të miratuar, për vitin 2022, për sistemin gjyqësor, i ndarë sipas programeve paraqitet sipas pasqyrës së mëposhtme:

Pasqyra nr.2

*Buxheti i miratuar sipas programeve buxhetore, për vitin 2022
000 lekë*


Emërtimi i programit	Shpenzime Paga	Shpenzime Sig. shoqërore	Shpenzime operative	Shpenzime tranf fam	Shpenzime investime	Totali fonde buxhetore
Prog. 01110,	191,000	25,000	63,808	1,400	15,000	296,208

Planifikim, Menaxhim, Administrim						
Prog. 01140, QTI	5,500	1,000	2,340	0	0	8,840
Prog. 03310, Buxheti Gjyqësor	2,302,760	280,000	470,250	4,750	397,000	3,454,760
Këshilli i Lartë Gjyqësor	2,499,260	306,000	536,398	6,150	412,000	3,759,808



Fondet buxhetore të miratuar për sistemin gjyqësor, janë rritur në mënyrë të vazhdueshme nga një vit buxhetor në tjetër, sikurse shihet dhe në grafikun e mëposhtëm.

Por pavarësisht kësaj rritjeje, pesha specifike që zë ky buxhet ndaj buxhetit të shtetit, në përqindje ka ngelur e pandryshuar në masën 0.75%, nga viti 2019 e në vazhdim. Ndërsa pesha specifike që zë ky buxhet ndaj PBB-së ka pasur një tendencë të lehtë në rritje, nëse e krahasojmë vitin 2023 me vitet e mëparshme (0.33% në vitin 2019 dhe



0.35% në vitin 2022). Ndërsa në vlerë absolute buxheti i miratuar për vitin 2022 është afërsisht 11.2 euro/ banor, ndërkohë që mesatarja e vendeve të Evropës është 45.8 euro/ banor⁴¹. Kjo do të thotë se pavarësisht rritjes që ka pasur në buxhetin gjyqësor, jemi ende larg mesatares së fondeve buxhetore të miratuara për sistemin gjyqësorin në vendet evropiane.

Ndërsa në lidhje me strukturën e fondeve buxhetore për sistemin gjyqësor, vërehet se shpenzimet e personelit zenë peshën kryesore të buxhetit të miratuar, rreth 74%, ndërsa shpenzimet kapitale janë ende më të ulëta se nevojat reale që ka sistemi gjyqësor, rreth 11%.

- I.** Programi buxhetor 01110, “**Planifikim, Menaxhim dhe Administrim**”, ku përfshihen fondet buxhetore për funksionimin e veprimtarisë së Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Fondet buxhetore të miratuara për programin “Planifikim, Menaxhimi dhe Administrim”, sipas emërimit të shpenzimeve, paraqiten sipas pasqyrës së mëposhtme:

Pasqyra nr.3

Buxheti i miratuar, i ndryshuar dhe realizuar për programin 01110 për vitin 2022


000 lekë

Emërtimi	Buxheti i miratuar	Ndryshime gjatë vitit 2022	Buxheti i rishikuar	Realizimi për vitin 2022	Realizimi për vitin 2022

⁴¹ CEPEJ 2022 report (2020 data) Tables graphs and analysis (Part 1)

	për vitin 2022		për vitin 2022		
Shpenzime paga	191,000	-16,215	174,785	172,211	99%
Shpenzime sig. shoq. e shëndetësore	25,000	-625	24,375	21,047	86%
Shpenzime operative	63,808	-7,762	56,046	40,450	72%
Shpenzime transfert familjar e individ	1,400	5,210	6,610	4,800	73%
Shpenzime kapitale (Investime)	15,000	-2,500	12,500	10,849	87%
Totali	296,208	-21,892	274,316	249,357	91%

Fondet buxhetore në programin “Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi”, janë realizuar në masën **91%**, ose në vlerë absolute në shumën **249,357 mijë lekë**.



1. Shpenzime personeli

Buxheti i miratuar në shpenzime personeli është **216,000 mijë lekë**, i ndarë përkatësisht **191,000 mijë lekë** në paga dhe 25,000 mijë lekë në sigurime shoqërore. Ky fond është përlloritur dhe miratuar për **128 punonjës**. Realizimi në shpenzime personeli (shpenzime paga dhe sigurime shoqërore) është kryer në masën 97%, për shkak të mosplotësimit 100% të strukturës organizative.

2. Shpenzime operative

Lidhur me shpenzimet operative është miratuar një fond në vlerën 63,808 mijë lekë. Në këtë fond u përfshinë nevojat në shpenzimet operative për aktivitetin e përditshëm të KLGJ-së, referuar kërkesave të përcaktuara në fazat e projektbuxhetit sipas zërave të shpenzimeve si dhe realizimit të vitit 2021.

Realizimi i shpenzimeve operative është në masën 72%. Në këtë zë të shpenzimeve janë realizuar shpenzimet për aktivitetin e përditshëm të institucionit të KLGJ-së.

Realizimi i shpenzimeve korrente tregon për një menaxhim të mirë dhe me efektivitet. KLGJ-ja, krahas administrimit dhe menaxhimit të fondeve të programit të KLGJ-së, ka administruar dhe menaxhuar edhe një pjesë të fondit të programit buxhetor të gjykatave në shpenzime operative, në vlerën prej **193,300 mijë lekë**, e cila është prokuruar dhe realizuar në vlerën 188,800 mijë lekë. Objekti i prokurimit është realizuar 100% sipas zërave dhe fondi është realizuar në masën 98%, për shkak të kursimit të fondeve gjatë procedurave të prokurimit.

3. Shpenzime për transfertat për buxhetet familjare dhe individët

Realizimi i shpenzimeve në këtë artikull është në masën 73%. Fondet në këtë artikull janë përdorur kryesisht për pagesa të shpenzimeve të telefonisë celulare apo për raste të dhënies së ndihmës së menjëhershme për raste fatkeqësie dhe raste të tjera (sëmundje dhe pension pleqërie). Gjithashtu ky fond u përdor për të përballuar efektet që lindën nga zbatimi i VKM nr. 898, datë 29.12.2022 “ Për mbështetje financiare të menjëhershme të punonjësve të njësive

të qeverisjes se përgjithshme dhe institucioneve të arsimit të lartë publik”

4. Shpenzime Kapitale (Investime)

Buxheti i miratuar në shpenzime kapitale (investime) ishte vlerën **15,000 mijë lekë**. Në këtë fond ishin përfshirë kryesisht nevojat për pajisje teknologjike. Realizimi i shpenzimeve kapitale është kryer në **masën 87 %**. Masa e realizimit në terma sasiore apo vlerë absolute të produkteve është e lidhur me kursimin e fondeve gjatë procesit të prokurimeve.

- II.** Programi buxhetor 01140, “**Mbështetje për Teknologjinë e Sistemit të Drejtësisë**”, ku përfshihen fondet buxhetore, për funksionimin e veprimtarisë së Qendrës së Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë.

Fondet buxhetore të miratuara për programin buxhetor 01140 ishin në vlerën **8,840 mijë lekë**. Ky fond për vitin 2022 është realizuar në vlerën 46%, pasi Qendra e TI ka vetëm 1 punonjës, dhe ende nuk e ka të plotësuar strukturën organizative të saj me punonjës të tjerë.

Pasqyra nr.4

Buxheti i miratuar, i ndryshuar dhe realizuar për programin 01140, viti 2022

Nr	Emërtimi	Buxheti i miratuar për vitin 2022	Ndryshime gjatë vitit 2022	Buxheti i rishikuar për vitin 2022	Realizimi për vitin 2022	Realizimi për vitin 2022
01	Shpenzime paga	5,500	-3,147	2,353	1,557	66%
02	Shpenzime sig. shoq. e shëndetësore	1,000	-25	975	257	26%
03	Shpenzime operative	2,340	-1,234	1,106	282	25%
04	Shpenzime transfert familjar e individ	0	110	110	10	9%
05	Shpenzime kapitale (Investime)	0		0	0	
	Totali	8,840	-4,296	4,544	2,106	46%


- III.** Programi buxhetor 03310, “**Buxheti Gjyqësor**”, ku përfshihen fondet buxhetore për funksionimin e veprimtarisë së gjykatave në të gjitha nivelet.

Pasqyra nr.5

Buxheti i miratuar, i ndryshuar dhe realizuar për programin 03310, viti 2022

000 lekë

Nr	Emërtimi	Buxheti i miratuar për vitin 2022	Ndryshime gjatë vitit 2022	Buxheti i rishikuar për vitin 2022	Realizimi për vitin 2022	Realizimi për vitin 2022
01	Shpenzime paga	2,302,760	-253,079	2,049,681	1,908,037	93%
02	Shpenzime sig. shoq. e shëndetësore	280,000	-42,190	237,810	233,577	98%
03	Shpenzime operative	470,250	47,375	517,625	497,994	96%
04	Shpenzime transfert familjar e individ	4,750	17,500	22,250	19,990	90%
05	Shpenzime kapitale (Investime)	397,000	-24,500	372,500	322,894	87%
	Totali	3,454,760	-254,894	3,199,866	2,982,492	93%



Fondet buxhetore në programin “Buxheti Gjyqësor”, janë realizuar në masën **93 %**.

1. Shpenzime personeli

Buxheti i miratuar në këto shpenzime është **2,582,760 mijë lekë**, i ndarë në **2,302,760 mijë lekë** në paga dhe **280,000 mijë lekë** në sigurime shoqërore. Buxheti në shpenzime personeli në këtë program është përlogaritur mbështetur në numrin e plotë të punonjësve sipas strukturave organike për të gjitha gjykatat dhe pagave dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi për magjistratët edhe për administratën gjyqësore. Realizimi në shpenzime personeli është kryer në masën 94 %.

2. Shpenzime operative

Buxheti i miratuar në shpenzime operative për vitin 2022, është **470,250 mijë lekë**. Shpenzimet operative përbëjnë ato shpenzime që kanë të bëjnë me aktivitetin e përditshëm të gjykatave. Këtu përfshihen shpenzimet e kancelarisë, energjisë elektrike, ujit, mirëmbajtjes së godinave, pajisjeve elektronike ashtu edhe shpenzimet postare, për ekspertët, avokatët e caktuar kryesisht, etj. Gjithashtu në këtë kategori llogariten edhe shpenzime të tjera specifike të cilat kryhen nga gjykata jo çdo vit por sipas rrethanave të krijuara. Të tilla mund të përmendim shpenzimet për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, etj.

Realizimi në shpenzime operative është në masën 96%. Ky realizim është një tregues i përdorimit me efektivitet, efikasitet dhe ekonomi i fondeve buxhetore nga gjykatat.

3. Shpenzime për transferta për buxhetet familjare dhe individët

Realizimi i shpenzimeve në këtë artikull është në masën 90 %. Fondet në këtë artikull janë përdorur kryesisht për pagesa të shpenzimeve të telefonisë celulare apo për raste të dhënies së ndihmës së menjëhershme për raste fatkeqësie dhe raste të tjera (sëmundje dhe pension pleqërie). Gjithashtu, sikurse u përmend dhe më sipër ky fond u përdor për të përballuar nevojat që lindën nga zbatimi i VKM nr. 898, datë 29.12.2022 “Për mbështetje financiare të menjëhershme të punonjësve të njësive të qeverisjes së përgjithshme dhe institucioneve të arsimit të lartë publik”.

4. Shpenzime kapitale (Investime)

Fondet buxhetore të miratuara në shpenzime kapitale (investime) për këtë program ishin **397,000 mijë lekë**. Këto fonde janë ndarë sipas projekteve të mëposhtme:


000 lekë

Kodi i projektit	Emërtimi i projektit	Fondet buxhetore 2022	Rishikim Buxheti 2022	Realizimi për vitin 2022 në lekë	Realizimi për vitin 2022 në %
18AD801	Blerje pajisje zyre	29,500	23,140	23,068	100%
21AC501	Blerje softëare	231,600	240,051	203,185	85%
21AC401	Blerje pajisje elektronike	39,200	26,445	19,247	73%
M290075	Blerje mjete motorrike	15,000	12,204	12,204	100%
M290068	Ndërtim i ri dhe rikonstruksion i plotë	71,700	68,660	63,592	93%
M290066	Studime dhe projektme	10,000	2,000	1,599	80%
	Totali	397,000	372,500	322,894	87%

Realizimi në shpenzime kapitale për programin 03310 është në masën 90%, si rezultat i kursimit kundrejt fondit limit të përlogaritur nga procedurat e prokurimit online.

Për sa më sipër, sikurse vihet re edhe nga analiza raportuese e detajuar, realizimi i buxhetit për vitin 2022, në sistemin gjyqësor, rezulton në masën 93 %, nga të cilat:

- ✚ shpenzime paga, në masën 93 %,
- ✚ shpenzime sigurime shoqërore, në masën 97 %,
- ✚ shpenzime operative, në masën 94 %,
- ✚ shpenzime kapitale, në masën 87 %.



Si përfundim, në përputhje dhe me realizimet e sipërpërmendura, KLGJ-ja ka vijuar të dëshmojë një performancë të lartë duke reaguar me shpejtësi ndaj nevojave në sistemin gjyqësor dhe duke mundësuar një vendimmarrje të drejtë dhe ligjore në funksion të menaxhimit të fondeve buxhetore me efikasitet dhe efektivitet.

2.5. NEVOJAT BUXHETORE

Buxheti i miratuar për sistemin gjyqësor, me ligjin nr. 84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023”, është në vlerën **4,362,600 mijë lekë**. Nevojat e evidentuara nga KLGJ-ja e për rrjedhojë të paraqitura prej saj si kërkesa buxhetore për vitin pasardhës, pasqyruar në dokumentin e projektbuxhetit afatmesëm PBA-së 2023 – 2025, kanë qenë 31% më të larta se buxheti i miratuar dhe akorduar, si për shpenzimet korrente edhe për shpenzimet kapitale.

Ndërkohë që për sa i përket kërkesave për burime njerëzore shtesë nga Këshilli është kërkuar akordimi i 104 punonjësve shtesë nga të cilët janë miratuar **30 punonjës**. Vlen të theksohet se për disa vite buxhetore radhazi Kuvendi i RSH-së ka marrë në konsideratë nevojat në rritje të sistemit gjyqësor për burime njerëzore duke akorduar vazhdimisht numra punonjësish shtesë. Në vazhden e këtij bashkëpunimi edhe gjatë vitit 2022 Kuvendi ka plotësuar kërkesën e paraqitur nga KLGJ-ja për burime njerëzore shtesë në masën 30%.

Duke qenë se Harta e Re Gjyqësore është ende në fazat e para të implementimit, dhe gjatë vitit 2022 u punua për zbatimin e fazës së parë dhe bashkimit të gjykatave të apelit, kërkesat buxhetore për shpenzime kapitale të KLGJ-së pasqyrojnë vetëm nevojat për investime qartësisht të domosdoshme dhe që në vijimësi garantojnë mirëfunksionimin e gjykatave dhe ofrimin e shërbimeve gjyqësore për publikun. Në këtë kontekst, ngelet ende emergjent përmirësimi i infrastrukturës ndërtimore nëpërmjet ndërtimit të godinave të reja për Gjykatën e Lartë, Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Fier dhe Durrës, të cilat do të siguronin standarde bashkëkohore në përmbushjen e detyrave kushtetuese si edhe ofrimin dinjitoz të shërbimit për publikun. Fonde të tjera buxhetore të domosdoshme janë ato për shpenzime kapitale (investime) në sistemet e Teknologjisë së Informacionit – Programe të reja software, Sistemi i ri i menaxhimit të çështjeve gjyqësore, Sistemi i sigurisë në gjykata.

Të rëndësishme!

Mbi buxhetin e vitit 2022, për sistemin gjyqësor:

- ❖ Fondet buxhetore të miratuara janë në masën 76 %, e fondeve buxhetore të kërkuara. Masa e realizimit 93%.
- ❖ Fondet buxhetore të miratuara në vitin 2022 janë më të larta se fondet buxhetore miratuar për vitin 2021, me një rritje prej 9%
- ❖ Fondet buxhetore të miratuara për shpenzime personeli - 2,805,260 mijë lekë. Masa e realizimit 94%.
- ❖ Fondet buxhetore të miratuara për shpenzime operative - 542,548 mijë lekë. Masa e realizimi 94%.
- ❖ Fondet buxhetore të miratuara për shpenzime kapitale (investime) - 412,000 mijë lekë. Masa e realizimi 87%.

Mbi nevojat për fonde buxhetore:

- ❖ Fonde buxhetore për shpenzime kapitale (investime) në infrastrukturën ndërtimore – ndërtimi i godinave të reja për Gjykatën e Lartë, Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Tiranë, Durrës dhe Fier.
- ❖ Fonde buxhetore për shpenzime kapitale (investime) në sistemet e Teknologjisë së Informacionit – Programe të reja software, Sistemi i ri i menaxhimit të çështjeve gjyqësore, Sistemi i sigurisë në gjykata.

3. ZHVILLIMI I QENDRUESHEM I SISTEMIT GJYQËSOR

3.1. PLANIFIKIMI STRATEGJIK DHE TRANSPARENCA

Planifikimi strategjik ka qenë një risi e reformës në drejtësi e cila vuri përpara detyrimit moral

dhe përgjegjësisë institucionale Këshillin e Lartë Gjyqësor për hartimin, miratimin dhe zbatimin e një plani të parë strategjik (2019-2020) si për vetë institucionin ashtu edhe për gjithë sistemin gjyqësor. Plan i parë Strategjik u shoqërua dhe me një raport monitorimi të progresit i cili evidentoi nivelin e zbatueshmërisë së këtij të fundit, problematikat e hasura si dhe çfarë dhe pse nuk u realizua dot në kohën e përcaktuar.

Me përfundimin e këtij harku kohor dhe në vijim të një analize nga çdo komision i përhershëm i Këshillit, me vendimin nr. 184, datë 11.05.2022⁴², Këshilli miratoi Planin e dytë Strategjik për vitet 2022 – 2024. Ky plan strategjik për vetë Këshillin si dhe sistemin gjyqësor është udhërrëfyese i cili do të orientojë veprimtarinë e Këshillit në përmbushje të misionit të tij për ndërtimin, udhëheqjen dhe qeverisjen e një gjyqësori me performancë të lartë, që synon ekselencë dhe meriton besimin e publikut.

Duke qenë se peizazhi në të cilin gjykatat ushtrojnë veprimtarinë e tyre do të pësojë ndryshime të dukshme për shkak të zbatimit të Hartës së Re Gjyqësore, përpjekjet për të intensifikuar komunikimin me publikun së bashku me sfidat e pandemisë dhe ato të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve, që ende ndikojnë sistemin gjyqësor, janë në qendër të Planit të ri Strategjik. Ky dokument strategjik, shoqëruar me një Plan Veprimi të detajuar, është hartuar në bashkëpunim të ngushtë me Projektin Drejtësi për të Gjithë – USAID dhe Akademinë e Transparencës SHBA – Shqipëri (USATA) që ndihmojnë KLGJ-në në punën e saj. Gjithashtu, është e rëndësishme të theksohet se Plan i Strategjik, është konsultuar me të gjitha gjykatat e vendit, Ministrinë e Drejtësisë, organizatat e shoqërisë civile, partnerët ndërkombëtarë dhe, për herë të parë, edhe me sektorin privat.

Për sa i përket transparencës, që në krye të herës me krijimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor mision i punës së tij ka qenë ndërtimi, udhëheqja dhe qeverisja e një sistemi gjyqësor me performancë të lartë, që meriton besimin e publikut. Në funksion të këtij misioni, gjatë punës së këtij viti KLGJ-ja ka shprehur angazhimin maksimal për të komunikuar në mënyrë profesionale, të hapur dhe cilësore me publikun dhe median si dhe për të rritur transparencën në lidhje me veprimtarinë e saj.

Duke garantuar transparencë të plotë dhe informimin e publikut dhe medias, nëpërmjet programit të transparencës së publikuar në faqen zyrtare të internetit, KLGJ-ja ka përditësuar vazhdimisht informacionin në këtë program duke rritur transparencën rreth aktivitetit të saj institucional.

Gjithashtu në zbatim të Planit Strategjik të Komunikimit për Sistemin Gjyqësor, Këshilli, në nëntor të këtij viti, miratoi vendimin nr. 454, datë 02.11.2022 mbi “Planin e Komunikimit për Gjykatat”. Ky plan komunikimi shërben si një pikënisje për të strukturuar mënyrën se si gjykatat i përqasen publikut dhe grupeve të tjera të interesit gjatë një procesi komunikimi e ndërveprimi. Gjatë një harku kohor 2-vjeçar (2022 – 2024), plani i komunikimit synon të përcaktojë mënyrat dhe mjetet e nevojshme të komunikimit, objektivat, audiencat dhe mesazhet kryesore në mënyrë që të rritet niveli i aksesit në informacion që publiku dhe media duhet të kenë mbi gjykatat, në funksion të qëllimit kryesor, atij të rritjes së besimit të publikut dhe transparencës në sistemin

⁴² “Për miratimin e Planit Strategjik të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për sistemin gjyqësor në Republikën e Shqipërisë, viti 2022-2024”.

gjqësor. Plani i Komunikimit shoqërohet me një Plan Veprimi duke parashtruar aktivitete dhe mjete praktike për ta bërë komunikimin më të lehtë, më të kuptueshëm dhe me sa më shumë ndikim të publiku. Në këtë mënyrë KLGJ-ja, është një hap përpara në funksion të përmbushjes së një prej detyrimeve ligjore për të garantuar mbarëvajtjen e marrëdhënieve të gjyqësorit me publikun dhe median.

Ndër të tjera vlen të theksohet se gjatë vitit 2022, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka trajtuar 24 kërkesa të ardhura për informacion në respektim të ligjin “Për të drejtën e informimit” të cilat janë trajtuar në kohë dhe brenda afatit të arsyeshëm. Në asnjë nga rastet e trajtuara të kërkesave për informacion, nuk është konstatuar ankim tek Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjes së të Dhënave Personale lidhur me refuzimin e informacionit apo kalimin e afateve ligjore të parashikuara për dhënien e informacionit.

Gjithashtu vlen të theksohet se Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, ka publikuar në muajin dhjetor 2022 indeksin e Transparencës Proaktive të Institucioneve Qendrore dhe të Varësisë. Referuar këtij monitorimi rezulton se Këshilli i Lartë Gjyqësor, gjatë vitit 2022, ka përmirësuar performancën e tij në kuadër të rritjes së transparencës proaktive duke u vlerësuar me 6 nga 8 pikë maksimale. Përmbushja e këtij kriteri, nëpërmjet publikimit të informacioneve në Programin e Transparencës, e klasifikon KLGJ-në si një ndër institucionet me transparencë proaktive mesatare, e identifikuar në semafor me dritë të bardhë.

3.2. HARTA E RE GJYQËSORE

Fundi i vitit 2021, shënoi arritjen e marrëveshjes së përbashkët midis Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Ministrisë së Drejtësisë për sa i përket hartës së re gjyqësore. Ajo u lançua në aktivitetin e parë prezantues dhe konsultativ ku morën pjesë grupet përkatëse të interesit të parashikuara në ligj, përfshirë Prokurorinë e Përgjithshme, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, si dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë (për më shumë informacion referojuni kapitullit: Bashkëpunimi i brendshëm dhe i jashtëm).

Në këtë kontekst, viti 2022 e gjeti KLGJ-në me një projekt të hartës së re gjyqësore të dakordësuar me të gjithë aktorët institucional të drejtësisë dhe të publikuar në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor me qëllim që publiku i gjerë apo grupet e interesit të kishin mundësi të njiheshin dhe të shprehnin opinionet e tyre.

Muajt janar-shkurt 2022, shënuan 2 muaj intensive takimesh konsultative me grupet e interesit përfshirë gjyqtarë, prokurorë, avokatë në qytetet e Vlorës, Gjirokastrës, Durrësit, Shkodrës, Korçës dhe Tiranës, përfaqësues të shoqërisë civile dhe komunitetit të biznesit, si dhe përdorues të gjykatave. Ajo që u theksua në këto takime ishte fakti që kjo hartë do të krijojë një sistem të pavarur dhe do të promovojë vlerat, duke ngritur një sistem karriere për magistratët dhe duke iu dhënë mundësinë qytetarëve, por dhe avokatëve të jenë dinjitoz përpara një gjykate.

Projektpropozimi u rishikua nga Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Ministria e Drejtësisë të cilët në marrëveshje vendosën t’i propozojnë Këshillit të Ministrave, që nga 22 gjykatat e rretheve gjyqësore me juridiksion të përgjithshëm, 6 gjykatat administrative të shkallës së parë dhe 6

gjykatat e apelit me juridiksion të përgjithshëm të riorganizohen në 13 gjykata me juridiksion të përgjithshëm dhe 2 gjykata administrative në shkallë të parë, dhe 1 gjykatë apeli. Sa më sipër, Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimin nr. 211, datë 10.06.2022 “Për miratimin e raportit vlerësues dhe propozimit të grupit ndërinstitucional të punës mbi riorganizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave” vendosi përcjelljen e tij dhe propozimit të miratuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor tek Ministri i Drejtësisë, për të vijuar me marrjen e mendimit nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Prokurori i Përgjithshëm dhe Ministri i Financave.

Në vijim, Këshilli i Ministrave me vendimin Nr. 495, datë 21.7.2022 “Për riorganizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave” në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 13, të ligjit nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, vendosi⁴³:

1. Gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm të riorganizohen në 13 (trembëdhjetë) gjykata të rretheve gjyqësore, të tilla si: gjykata e Beratit, Dibrës, Durrësit, Elbasanit, Fierit, Gjirokastrës, Lezhës, Korçës, Kukësit, Sarandës, Shkodrës, Tiranës, dhe Vlorës.

2. 6 Gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm riorganizohen në një Gjykatë Apeli të Juridiksionit të Përgjithshëm, që organizohet dhe funksionon në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, me seli në qytetin e Tiranës.

3. 6 Gjykatat administrative të shkallës së parë riorganizohen në 2 (dy) gjykata administrative të shkallës së parë të tilla si ajo e Tiranës dhe Lushnjës.

4. Ngarkohen Këshilli i Lartë Gjyqësor, Prokurori i Përgjithshëm dhe Ministria e Drejtësisë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

5. Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi sipas përcaktimeve të mëposhtme:

a) Riorganizimi i gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, sipas pikës 1, të këtij vendimi, më 1.5.2023;

b) Riorganizimi i gjykatave të apelit të juridiksionit të përgjithshëm, sipas pikës 2, të këtij vendimi, më 1.2.2023;

c) Riorganizimi i gjykatave administrative të shkallës së parë, sipas pikës 3, të këtij vendimi, më 1.7.2023.

Ky vendim ka hyrë në fuqi pasi është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 107, datë 21 korrik 2022, dhe në zbatim të tij, Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimin nr. 505, datë 21.11.2022 “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm” ka vendosur:

1. Gjykata e Apelit Tiranë emërtohet Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

2. Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm fillon funksionimin më datë 01.02.2023.

3. Selia e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm është në Tiranë, në adresën Bulevardi “Zhan D’Ark”.

4. Gjykatat e Apelit Durrës, Gjirokastrë, Korçë, Shkodër dhe Vlorë, ndërpresin veprimtarinë më datë 31.01.2023

⁴³<https://qbz.gov.al/eli/vendim/2022/07/21/495/47876633-7e33-4294-9c85-00fc1be32e90?q=VKM%20%20495,%20dat%C3%AB%2021.7.2022,%20E%80%9CP%C3%ABr%20riorganizimin%20e%20Rretheve%20Gjyq%C3%ABsore%20dhe%20kompetencave%20tok%C3%ABsore%20t%C3%AB%20Gjykatave>

Në mbështetje të vendimit të mësipërm, Këshilli ka ndërmarrë hartimin dhe miratimin e një pakete të plotë aktesh, të cilat mundësojnë zbatimin në praktikë të hartës së re gjyqësore përmes miradministrimit të aspekteve të ndryshme teknike që lidhen qoftë me procedurat e shortimit të çështjeve ashtu dhe me burimet njerëzore nëpër gjykata. Kjo paketë aktesh përbëhet nga:

- Vendimi nr. 553, datë 29.12.2022 “Për caktimin e numrit të gjyqtarëve në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm”, i cili ka vendosur që numri i gjyqtarëve në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm do të jetë 78 (shtatëdhjetë e tetë) gjyqtarë.
- Vendimi nr. 554, datë 29.12.2022 përcaktoi kritere dhe rregulla të hollësishme për ndarjen e çështjeve gjyqësore me short, në të gjitha nivelet e gjykatave në Republikën e Shqipërisë. Ndarja e çështjeve gjyqësore me short realizohet mbi bazën e parimit të transparencës, informimit, kontrollit, mbikëqyrjes, gjurmimit, barazisë së shpërndarjes dhe objektivitetit.
- Me vendimin nr. 555, datë 29.12.2022 Këshilli ka miratuar rishpërndarjen e numrit të pozicioneve të punës në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe në gjykatat e rretheve gjyqësore, duke vendosur dhe pezullimin e të gjitha procedurave të rekrutimit, për plotësimin e vendeve vakante për të gjithë kategoritë e nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë gjyqësorë, deri në përfundimin e procesit të ristrukturimit.
- Në vijim, me vendimin nr. 556, datë 29.12.2022, Këshilli ka vendosur miratimin e “Rregullave standarde për organigramën dhe përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësive të pozicioneve të nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm”.
- Me vendimin nr. 557, datë 29.12.2022 “Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e komisioneve të ristrukturimit”, Këshilli përcaktoi rregulla të detajuara të krijimit dhe funksionimit të Komisioneve të Ristrukturimit që ngrihen në kuadër të riorganizimit të kompetencave tokësore të gjykatave, si dhe procedura të verifikimit të kushteve dhe kritereve që duhet të plotësojnë nëpunësit civilë gjyqësorë të konfirmuar në detyrë apo në periudhë prove, si dhe punonjësit e tjerë gjyqësorë, që i nënshtrohen ristrukturimit për shkak riorganizimi, me qëllim transferimin e tyre të përhershëm, në kohën e duhur dhe me efektivitet, në strukturën e gjykatës pritëse.

Në zbatim të këtyre vendimeve, Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm filloi funksionimin e saj më datë 1.2.2023. Ndërkohë Grupi Ndërinstitucional i Punës, miratuar me urdhrin nr. 80, datë 28.07.2022, të Kryetares së Këshillit të Lartë Gjyqësor, vijon procedurat për ndjekjen dhe zbatimin e VKM-së nr. 495, datë 21.7.2022 “Për riorganizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave” ku po zhvillon takime dhe mbledhje për të konkluduar mbi hartimin e akteve nënligjore për të cilat Këshilli do të dalë me vendim lidhur me fillimin e funksionimit të gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, më 1.5.2023 dhe të gjykatave administrative të shkallës së parë, më 1.7.2023.

Zbatimi i këtij projekti, i cili pritet t’i japë rezultatet e tij gjatë vitit 2023, ka për qëllim final të garantojë aksesin në drejtësi, marrjen e shpejtë të shërbimeve gjyqësore për publikun, shpërndarjen e ekuilibruar të ngarkesës mes gjykatave dhe gjyqtarëve, përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarëve dhe specializimin e profilizimin e gjyqtarëve.

3.3. INFRASTRUKTURA E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT

3.3.1. QENDRA E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT

Gjatë vitit 2022, përpjekjet për fuqizimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit (TIK), janë përqendruar në funksionalizimin e plotë të Qendrës së Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë (këtu e në vijim “QTI”), krijuar me VKM-në nr. 972, datë 02.12.2020 “Për organizimin, funksionimin e përcaktimin e kompetencave të Qendrës së Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë”.

Qendra, si institucion rregullator dhe koordinues i teknologjisë së informacionit për sistemin e drejtësisë, ushtron funksionet nëpërmjet dy organeve kryesore, Bordi Drejtues (organ kolegjal vendimmarrës) dhe Drejtori Ekzekutiv (organ administrativ). QTI-ja është mbështetur në funksionet horizontale administrative e financiare nga Këshilli i Lartë Gjyqësor. Për çështje specifike në lidhje me problematika të fushës TIK dhe sigurisë kibernetike Bordi ndihmohet nga Ekipi Këshillimor i Ekspertëve, i cili përbëhet nga nëpunësit më të lartë për çështjet e teknologjisë së informacionit në institucionet e drejtësisë.

Bazuar në nenin 92, pika 2, shkronja ‘a’, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Qendra e Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë, në bashkëpunim me Këshillin e Lartë Gjyqësor, është përgjegjëse për zhvillimin ose pjesëmarrjen në zhvillimin e sistemit elektronik të teknologjisë së informacionit për përdorim në gjykata.

Në zbatim të pikës 10, shkronjat ‘h’, ‘i’ dhe ‘m’, të Vendimit nr. 972, datë 2.12.2020, “Për organizimin, funksionimin e përcaktimin e kompetencave të Qendrës së Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë”, të Këshillit të Ministrave, ndër kompetencat e Bordit Drejtues është miratimi i planeve strategjike afatgjata për teknologjinë, miratimi i arkitekturës së strukturës së sistemeve të teknologjisë së informacionit të institucioneve të sistemit të drejtësisë si dhe miratimi i nismave që lidhen me teknologjinë e informacionit, së bashku me buxhetet përkatëse.

Me vendim nr.5, datë 09.06.2022, Qendra e Teknologjisë së Informacionit, ka miratuar kërkesat teknike për “Zhvillimin e sistemit të ri të menaxhimit të çështjeve”, i cili përbën njëkohësisht dokumentin mbi nismën që do të ndërmerret nga Këshilli i Lartë Gjyqësor për zhvillimin e sistemit të ri të menaxhimit të çështjeve duke përfshirë buxhetin e nevojshëm; përcaktimin e arkitekturës së sistemit të ri të menaxhimit të çështjeve si dhe detajimin e mëtejshëm të planit strategjik për zhvillimin e këtij sistemi.

Pas miratimit të kërkesave për zhvillimin e sistemit të ri të menaxhimit të çështjeve, nga grupi i punës i ngritur për këtë qëllim dhe Departamenti i Administrimit të Gjykatave dhe Teknologjisë së Informacionit, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, ka vijuar punën për zbatimin e projektit sipas hapave të parashikuara.

Qendra e Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë, ka miratuar kërkesat teknike për “Krijimin e infrastrukturës mbështetëse për instalimin (hostimin) e sistemit të ri të menaxhimit të çështjeve (ICMIS)” si dhe dokumentin teknik për standardet e dizenjimit dhe standardet për specifikimet teknike të sistemit të ri informatik të menaxhimit të çështjeve gjyqësore (ICMIS i ri) i cili ofron një përshkrim të standardeve të nivelit të lartë të zgjidhjes së kërkuar, të përgatitur me asistencën/konsulencën e ekspertit të jashtëm.

KLJGJ-ja, nëpërmjet këtyre vendimeve, synon të zbatojë një sistem të ri informatik të menaxhimit të çështjeve gjyqësore që do të ofrojë automatizim më të lartë dhe do të mbështesë rrjedhën e punës brenda gjykatave duke synuar rritjen e efikasitetit, aksesit në drejtësi, respektimit të afateve kohore, transparencës, raportimit statistikor dhe llogaridhënies.


Bazuar në përvojën 15-vjeçare të sektorit të drejtësisë me sistemet ekzistuese, KLJGJ-ja, në bashkëpunim me partnerët, kërkon të ngrejë një sistem të ri, modern dhe funksional të menaxhimit të çështjeve, i cili do të kapërcejë pengesat e sistemeve ekzistuese dhe do jetë një hap i madh drejt transformimit digjital në shërbimet e sektorit të drejtësisë.

Me qëllim standardizimit e pajisjeve dhe sistemeve, për të pasur një qasje të njëjtë në teknologji, procesi i standardizimit është shumë i rëndësishëm. Për këtë arsye Bordi Drejtues i Qendrës së Teknologjisë së Informacionit, me vendimin nr. 12, datë 31.10.2022, ka ngritur Grupin Ndërinstitucional të Punës “Për hartimin e standardeve për sistemet e teknologjisë së informacionit, në institucionet e sistemit të drejtësisë”.

Në vijim të procesit të standardizimit, me vendimin nr. 14, datë 19.12.2022, janë miratuar standardet për ndërtimin dhe administrimin e dhomës së serverëve për sistemin e drejtësisë. Dhomat e serverit janë pika më e ndjeshme/kritike e një infrastrukture informatike, pasi përqendrimi i pajisjeve kompjuterike, mekanike, elektronike dhe elektrike është i lartë. Për këtë arsye, të gjithë instalimet duhet të kryhen sipas standardeve të paracaktuara për të siguruar mbarëvajtjen dhe sigurinë e këtyre sistemeve.

3.3.2. ZHVILLIMET NË INFRASTRUKTURËN EKZISTUESE TË SISTEMEVE TEKNOLOGJIKE

Pas zhvillimit dhe zbatimit të ndryshimeve në sistemet e menaxhimit të çështjeve në gjykata, të kryera gjatë vitit 2020-2022, ka vazhduar monitorimi i zbatimit të tyre në praktikë dhe është dhënë mbështetja e nevojshme nëpërmjet sistemit të ngritur “ticketing desk”. Për vitin 2022, është ofruar mbështetje teknike për të gjithë gjykatat, lidhur me 686 kërkesa të administruara.



Këshilli i Lartë Gjyqësor, për të katërtin vit radhazi ka përcaktuar dhe implementuar zhvillimet në sistemet e menaxhimit të çështjeve gjyqësore bazuar në problematikat e raportuara përmes sistemit “ticketing service” dhe kërkesave të specifikuara nga vetë përdoruesit e sistemit në gjykatë.

Të gjitha ndërhyrjet dhe zhvillimet plotësojnë njëkohësisht dy kushte kryesore, të rezultojnë të nevojshme nga përdorimi i përditshëm në gjykata dhe të plotësojnë të paktën njërin prej qëllimeve të parashikuara në nenin 92, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, i cili parashikon objektivat dhe synimet që duhet të ketë KLGJ-ja dhe QTI-ja në ndërhyrjet mbi teknologjinë e informacionit nëpër gjykata.

Gjatë gjithë vitit 2022, është garantuar mbajtja në funksion të plotë dhe të pandërprerë e të gjithë sistemeve software dhe disponueshmëri e lartë e infrastrukturës fizike hardware. Ndër ndërhyrjet kryesore mund të përmendim.

A) Ndërhyrje që synojnë rritjen e efikasitetit dhe funksionalitetit për përdoruesit e gjykatës.

- **Migrimi dhe riplatformimi me sukses i të dhënave të sistemit të menaxhimit të çështjeve ARKIT të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.**

Pas 20 vitesh përdorimi, sistemi i menaxhimit të çështjeve (ARKIT) u rikonceptua duke sjellë ndryshime si në aspektin vizual ashtu edhe aspektin teknik.

Versioni i mëparshëm i sistemit ARKIT ishte ndërtuar mbi një teknologji të vjetër e cila nuk mbështetet më nga kompania mëmë, pasi e ka deklaruar jashtë “fokusit”. Për arsyet e mësipërme, duke qenë se sistemet ishin vulnerabël në aspektin e sigurisë dhe nuk garantonin besueshmëri në saktësinë dhe mirëfunksionimin e tyre, janë kryer ndërhyrje thelbësore, të cilat garantojnë

sigurinë e të dhënave dhe kryerjen e (backup) ruajtjes automatike të databazës në serverin qendror.

- **Përmirësimi i raporteve statistikore**

Gjatë vitit 2022, janë bërë përmirësime në raportet e gjeneruara nga sistemi i menaxhimit të çështjeve mbi gjenerimin automatik të seancave të filluara me vonesë, si dhe pasqyrimi i arsyes së fillimit të seancës përtej afatit të planifikuar.

Raporti nxirret si për periudha të caktuara dhe sipas gjyqtarëve të caktuar. Raporti i shortit elektronik të çështjes shfaq të dhëna më të detajuara lidhur me çështjet gjyqësore që lidhen me objektin dhe akuzën.

- **Përpunimi i të dhënave statistikore**

Me qëllim përpunimin e të dhënave statistikore është bërë e mundur gjenerimi në format EXEL i rezultatit të kërkimit në sistemin ICMIS, në mënyrë që të gjithë rezultatet që gjeneron kërkimi në faqe të ndryshme, të shfaqen në një tabelë Excel-i, me qëllim filtrimin me datë fillimi, datë mbarimi, etj.

- **Zhvillime në kuadër të ndryshimeve ligjore**

Si pasojë e ndryshimeve ligjore, në sistemin e menaxhimit të çështjeve është i mundur identifikimi i çështjeve, për të cilat gjyqtari i seancës paraprake ka pranuar kërkesën për gjykim të shkurtuar dhe ka vendosur vazhdimin e çështjes në gjykim themeli. Në raportin e regjistrit të veprimeve RIV, shfaqet informacion mbi datën dhe orën e veprimit.

- **Rritje e efijencës së punës**

Regjistrimi i kërkesave me objekt “Lëshim i urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes”, të cilat paraqiten gjatë fundjavës, mund të regjistrohen në sistem sipas konfigurimeve të kryera bazuar në urdhrin e titullarit. Në këtë mënyrë nuk është e nevojshme prezenca e IT-së në gjykatë gjatë fundjavës, i cili është administratori i sistemit për të kryer ndryshimet përkatëse.

- **Transparenca dhe verifikimet në sistem**

Në sistem është krijuar një funksion i ri me të drejta vetëm leximi (READ) për Specialistin e Marrëdhënieve me Publikun dhe Median, në mënyrë që të aksesojë informacion nga sistemi, në mënyrë të pavarur nga përdorues të tjerë.

B) Ndërhyrje që synojnë rritjen e efijencës apo cilësisë në ofrimin e shërbimeve për të gjithë aktorët përdorues të sistemit duke pasur në fokus automatizimin dhe ofrimin e tyre në mënyrë elektronike (online).

- **Është ngritur dhe vendosur në funksion rrjeti intranet WAN ndërmjet KLGJ-së dhe 38 Gjykatave.**

Për realizimin e lidhjes së të gjitha gjykatave në një rrjet kombëtar online, krahas ndërtimit të rrjeteve lokale të brendshme, të sigurohet një rrjet i qëndrueshëm dhe me kapacitet të mjaftueshëm midis KLGJ-së dhe gjykatave të të gjitha niveleve. Ky është një rrjet i sigurt, i mbrojtur dhe me parametra teknike që të sigurojë shërbime për transmetime multimediale, data, voice, video.

- **Është ngritur infrastruktura mbështetëse (server, storage PC, etj.) për rrjetin e klasifikuar me qëllim shkëmbimin e materialeve konfidenciale nga Anëtarët e KLGJ-së.**

Në dhomën e serverit në një sirtar (Rack) të veçantë është implementuar serveri dhe storage për menaxhimi e dokumenteve të klasifikuara si sekret nëpërmjet anëtarëve të Këshilli të Lartë Gjyqësor, si dhe janë blerë kompjuterët që do të përdoren për këtë qëllim.

- **Është ngritur infrastruktura mbështetëse (server, storage, firewall, etj.) për programin e digjitalizimit të arkivit gjyqësor.**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në kuadër të digjitalizimit ka ndërmarrë një reformë në mënyrën e ofrimit të shërbimeve për publikun dhe vetë administratën. Gjithmonë e më shumë, në ndihmë të ofrimit të shërbimeve, po aplikohet teknologjia e informacionit dhe komunikimit. Shumë nga proceset që deri dje bëheshin në mënyrë manuale, sot janë automatizuar. Përqindja e realizimit të digjitalizimit të regjistrave dhe i vendimeve gjyqësore deri në fillim të vitit 2022 për gjykatat ishte 0%.

Në infrastrukturën fizike të implementuar për këtë qëllim është instaluar programi software për menaxhimin e dokumenteve të skanuara, i cili do të shërbejë për administrimin e arkivit digjital dhe aplikimi i proceseve të punës që lidhen me aktivitetet kryesore të arkivit, si dhe me qëllim lehtësimin në procedurat e administrimit të dosjeve, në kërkimin e përpunimin e dokumenteve arkivore. Sistemi i implementuar është i bazuar në standardet e përgjithshme ndërkombëtare për arkivimin.

Me qëllim garantimin e sigurisë së materialeve të skanuara është implementuar dhe programi i menaxhimit të backup-eve, i cili është një element shtesë që na siguron vërtetësinë e dokumenteve.

Gjatë 3-mujorit të parë të fillimit të projektit janë digjitalizuar gjithsej 400 mijë fletë nga volumet e vendimeve gjyqësore, të cilat administrohen nga gjykatat.

- **Ngritja e infrastrukturës për planin e Disaster Recovery, sipas standardeve më të mira të aplikuara.**

KLJG-ja ka përmbytur me sukses transferimin e sistemeve të instaluar në Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) dhe ka kryer konfigurimet e nevojshme të këtyre sistemeve dhe bazave të të dhënave në infrastrukturën e ruajtjes nga shkatërrimet/fatkeqësitë (Disaster Recovery). Ky proces është kryer pa ndërprerë aksesin në portalet dhe sistemet online me të cilat operojnë gjykatat. Konkretisht, janë transferuar sistemet dhe portalet si më poshtë:

- portali gjykata.gov.al;
- databaza e portalit gjykata.gov.al;
- portali klgj.al;
- portal arkiva.klgj.al;

Për të gjitha portalet është aplikuar dhe certifikata SSL e nivelit të lartë me qëllim garantimin e sigurisë së domaineve (platformave mbështetëse).

- **Ka përfunduar dhe është konfiguruar faza e parë e infrastrukturës mbështetëse për hostimin e sistemit të ri të menaxhimit të çështjeve.**

Duke marrë parasysh situatën aktuale, si dhe sfidat me të cilat përballen përdoruesit dhe administratorët e sistemit, Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLJG-ja) ka parashikuar dhe do ndërmarrë masat e nevojshme për modernizimin e infrastrukturës për të akomoduar sistemin e ri të qendëruar ICMIS.

Një hap i parë drejt këtij qëllimi është dhe krijimi i infrastrukturës mbështetëse për hostimin e sistemit të ri të menaxhimit të çështjeve (ICMIS) të KLGJ-së. Kjo infrastrukturë do duhet të sigurojë disponueshmëri të lartë në të gjitha komponentët e saj në mënyrë të tillë që të sigurojë dhe ofrojë vazhdimësi të proceseve pa ndërprerje, mbështetur në arkitekturë BCC (Business Continuity Clustering).

- **Ka filluar implementimi i Regjistrimit Elektronik të OJF-ve, i cili bazohet në udhëzimet e ligjit 80/2021, “Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse”.**

Konkretisht, në detyrim të pikës 2 të nenit 4 të ligjit nr. 80, datë 24.06.2021 “Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse”, gjatë vitit 2022 është ngritur infrastruktura ku do të hostohet/vendoset sistemi elektronik dhe po vijohet me dizejnimin e sistemit sipas formularëve të miratuar, si dhe po mundësohet ndërveprimi automatik me të gjithë institucionet që përfshihen. Në muajin dhjetor 2022, është ndërtuar dhe marrë në dorëzim, platforma web e brendshme e regjistrimit elektronik kombëtar të OJF-ve, që do të përdoret në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Këshilli i Lartë Gjyqësor, ka kryer aplikimin për regjistrimin e bazës së të dhënave për regjistrin e OJF-ve, në portalin e-Albania, duke plotësuar formularin e detajuar, si dhe ka hartuar rregulloret që lidhen me sigurinë e bazës së të dhënave të Regjistrimit Elektronik Kombëtar për OJF-t.

C) Ndryshimet në sistemet e teknologjisë së informacionit në kuadër të hartës së re gjyqësore, në zbatim të VKM-së Nr. 495, datë 21.07.2022, “Për riorganizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave”.

- **Harta e re gjyqësore**

Riorganizimi i gjykatave të apelit të juridiksionit të përgjithshëm, solli nevojën për ndryshime edhe në aspektin teknologjik. Për rrjedhojë, janë kryer zhvillimet e nevojshme në sistemin e menaxhimit të çështjeve ICMIS dhe ka përfunduar migrimi ose transferimi i të gjithë bazës së të dhënave të 5 gjykatave të tjera në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm. Është ngritur infrastruktura e re fizike (implementimi i serverit dhe storage), e cila do të përpunojë të gjithë çështjet e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm. Janë kryer konfigurimet në portalin www.gjykata.gov.al, me qëllim pasqyrimin e informacioneve që lidhen me veprimtarinë e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, të cilat janë online nga data 01.02.2023. Procesi i zhvillimeve dhe i migrimit të të dhënave do të vijojë dhe gjatë vitit 2023, me gjykata e tjera të cilat do të riorganizohen sipas VKM-së Nr. 495, datë 21.7.2022, “Për riorganizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave”

Procesi i zhvillimeve dhe i migrimit të të dhënave do të vijojë dhe gjatë vitit 2023, me gjykatat e tjera të cilat do të riorganizohen sipas VKM-së Nr. 495, datë 21.7.2022 “Për riorganizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave”

D) Marrja në administrim e sistemeve të zhvilluara nga EURALIUS.

Këshilli i Lartë Gjyqësor ka fituar pronësinë e sistemeve elektronike të zhvilluara nga EURALIUS, në kuadër të rritjes së efikasitetit në gjykata. Këto programe janë si vijon:

- Platforma “M-File”, e cila shërben për menaxhimin e dokumenteve për magjistratët.
- Platforma “ProMagistrate”, e cila shërben për menaxhimin e dokumenteve për njësinë e vlerësimit të gjyqtarëve, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.
- “SMD LOT”, program software i krijuar për shpërndarjen e çështjeve, bazuar në kërkesat për delegim që vijnë nga gjykatat.

Gjatë gjithë vitit 2022, është garantuar nga KLGJ-ja funksionimi i pandërprerë i platformës “M-Files” dhe çdo gjyqtar është mbështetur për procedurat e vlerësimit, nëpërmjet platformës së krijuar për këtë qëllim.

Projekte të mundësuar nga asistenca e Këshillit të Evropës janë:

Pilotimi i pyetësorit online për kënaqësinë e përdoruesve të gjykatës, i cili filloi zbatimin në vitin 2022, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë për përdoruesit e saj. Ky pyetësor është jo vetëm detyrim ligjor, parashikuar në nenin 94, pika 5, shkronja ‘a’, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, por një nevojë e sistemit gjyqësor për të kuptuar cilësinë e shërbimeve të ofruara ndaj qytetarit dhe profesionistëve të drejtësisë.

Pyetësori synon të nxjerrë në pah cilësinë aktuale të shërbimit gjyqësor si dhe t’i ofrojë informacion gjykatave dhe aktorëve të tjerë institucionalë për nivelin e përmirësimit të efikasitetit të shërbimeve dhe reputacionin e gjykatës në këtë drejtim përpara qytetarëve.

Pyetësori nëpërmjet një ndërfaqeje mundëson gjenerimin e raporteve statistikore në mënyrë automatike. Platforma kryen përmbledhje sipas përcaktimeve të administratorit të platformës, të cilat më pas analizohet nga gjykata dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor.

Gjatë vitit 2022, janë plotësuar online në adresën <https://pyetsor.com/klgj/> gjithsej 264 pyetësorë, kryesisht nga palë ndërgjyqëse, ekspertë, avokatë, asistentë avokatë, etj.

Rezultatet kryesore të pyetësorit tregojnë vlerësim pozitiv në lidhje me aksesin në ambientet e gjykatës, kushte të mira të pritjes së palëve, akses të lehtë, të shpejtë, dhe më cilësi të lartë të informacionit nga ana e qytetarëve, etj.

Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka përpunuar të dhënat personale, në përputhje të plotë me parashikimet e ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”. Që prej lançimit të projektit më 22 prill, kanë dhënë opinionet e tyre 264 persona nga të cilët:

- 25% janë palë në proces,
- 24% subjekte të tjera të përfshira në proces si ekspertë, dëshmitarë, etj.,
- 24% përdorues të jashtëm të gjykatës.
- 27% e të anketuarve nuk kanë preferuar të cilësohen.

Në lidhje me pyetjet mbi mundësinë e aksesit dhe ambientet në gjykatë, të anketuarit janë përgjigjur se:

- 46.5% e të anketuarve mendojnë se gjykatat dhe ambientet e tyre janë lehtësisht të aksesueshme përkundrajt 9.4% të cilët vlerësojnë se gjykatat janë vështirësisht të aksesueshme, ndërsa 36.3 % nuk kanë preferuar të përgjigjen.
- 34.4% e përdoruesve të pyetur mendojnë se në gjykata ka vështirësi për aksesin e personave me aftësi të kufizuar, ndërsa 24.2% gjykojnë se aksesin është i lehtë për këtë grup përdoruesish. Për këtë pyetje 37.9% e të anketuarve nuk kanë dhënë opinion.
- Orientimi brenda gjykatës është cilësuar i lehtë nga 39.1% e të anketuarve ndërsa 16.4% e cilësojnë relativisht të vështirë. Sërish 37.9% kanë preferuar të mos përgjigjen.

Të pyetur mbi kushtet e gjykatave, përdoruesit janë përgjigjur se:


- Kushtet e pritjes në gjykatë janë cilësuar kushte të mira nga 21.9% e përdoruesve dhe shumë të mira nga 10.9% prej tyre. Vlerësim negativ kanë dhënë 21.9% e të anketuarve, duke i cilësuar të këqija. 36.7% e të anketuarve nuk janë përgjigjur.
- Në lidhje me pajisjet e sallave të gjyqit, 42% janë përgjigjur se pajisjet janë të gjitha funksionale, ndërsa vetëm 14% i kanë cilësuar jo funksionale. 36.7% e të anketuarve nuk janë përgjigjur.

Vlerësimi mbi transparencën dhe aksesin e informacionit ka rezultuar pozitiv, pasi:

- 25% e vlerësojnë të vështirë gjetjen e informacionit në lidhje me të drejtat e tyre, dhe vetëm 18.4% i gjejnë lehtësisht ato. 51.2% e të anketuarve nuk janë përgjigjur.
- Të pyetur nëse informacioni i dhënë nga gjykata është i qartë apo jo, të anketuarit janë përgjigjur pothuaj në mënyrë të barabartë me një ndarje prej 23% me opinionin se informacionet janë të paqarta dhe 23.4% e vlerësojnë informacionin të qartë. Sërish 50.4% e të anketuarve nuk kanë dhënë përgjigje.

Nga informacioni i deritanishëm rezulton se përdoruesit preferojnë t'i drejtohen dyerve të gjykatës pasi 36.3% e të anketuarve janë paraqitur personalisht dhe vetëm 6.25% e kanë kërkuar informacionin në faqen e internetit dhe 5.86% kanë përdorur postën elektronike. Arsyet kryesore për të kërkuar shërbimet në sekretarinë e gjykatës janë: informimi në lidhje me vendimet gjyqësore e cila ka qenë përgjigjja e 17.2% e të anketuarve dhe aksesin në dokumentacion (p.sh. kopje të akteve, provave) për 16.4% e të anketuarve.

Të pyetur mbi cilësinë e informacionit të dhënë nga sekretaria gjyqësore 23.8% e kanë vlerësuar të madh, ndërsa vetëm 10.2% e kanë cilësuar të vogël.



Realizimi i trajnimeve rajonale për gjenerimin dhe raportimin e të dhënave statistikore nga gjykatat *(Për më shumë informacion, lexoni kapitullin e Bashkëpunimit të brendshëm).*

Realizimi i projektit pilot për komunikimin online mes Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Avokatëve, projekt i cili ka mundësuar propozimin e zgjidhjeve teknike për zhvillimin dhe ofrimin e shërbimeve të njoftimeve, të cilat lehtësojnë komunikimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me aktorët e jashtëm të përfshirë në procesin e menaxhimit të çështjeve të gjykatës.

Me mbështetjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor është mundësuar implementimi i platformës për njoftimin e avokatët në qendrën e të dhënave të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me qëllim ndërveprimin në kohë reale të informacioneve që lidhen me veprimtarinë gjyqësore. Në bazë të formularëve të dërguar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, kanë shprehur interesin për t'u bërë pjesë e platformës rreth 300 avokatë të Dhomës Kombëtare të Avokatisë Tiranë.

Ky projekt do të ndikojë në përmirësimin dhe rritjen e efektivitetit në njoftimin në kohë të palëve, që do të sjellë komunikim më të mirë midis gjykatës dhe përfaqësuesve të palëve pjesëmarrëse për çështjet që trajton kjo gjykatë.

Sistemi mundëson përmirësimin e organizimit dhe delegimit të çështjeve tek avokatët e regjistruar, ku një objektiv tjetër është dhe rritja e efijencës së përdoruesve në punët e tyre të përditshme.

Ndër të tjera Këshilli i Evropës, ka përfunduar dizejnimin e platformës së re WEB për menaxhimin e akteve të prodhuara nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.

Kjo platformë ka për qëllim të informojë publikun rreth institucionit, të publikojë botime, dokumente të ndryshme, aktivitete dhe informacione të tjera të nevojshme për informimin e publikut, nga departamentet përkatëse. Platforma është e konceptuar dhe është lehtësisht e aksesueshme.

Moduli i kërkimit të akteve është dhe pika e fortë e platformës. Nëpërmjet këtij motori kërkimi përdoruesve i garantohet mënyra më e thjeshtë e mundshme për të aksesuar aktet dhe për t'i filtruar ato.

Në këtë platformë është konceptuar dhe ambienti i administrimit qendror, i cili i mundëson administratorit të sistemit që në nivelin më të lartë hierarkik të vlerësojë performancën e sistemit, të gjenerojë statistika mbi aksesimin e rekordeve të caktuara, efijencën e kërkimit, të ndryshojë politikat e aksesit etj. Nëpërmjet kësaj ndërfaqeje, administratori i sistemit mund të aktivizojë dhe konsultojë të dhëna për auditimin e veprimeve në sistem.

Sistemi elektronik i burimeve njerëzore

Në fund të vitit 2022 ka përfunduar zhvillimi i sistemit elektronik të burimeve njerëzore për KLGJ-në dhe administratën gjyqësore, ofruar në kuadër të projektit "Forcimi i Efikasitetit dhe

Cilësisë së Drejtësisë në Shqipëri”, i cili do të fillojë zbatimin në vitin 2023. Këshilli i Lartë Gjyqësor ka konfiguruar infrastrukturën e nevojshme IT me qëllim instalimin e sistemit dhe ka mundësuar aksesimin e tij nëpërmjet një rrjeti të siguritë VPN.

Përmes këtij bashkëpunimi është ofruar ekspertizë për analizimin e proceseve të punës në KLGJ dhe mbi këtë analizë është projektuar zgjidhja teknike, me qëllim automatizimin e sistemeve të punës për menaxhimin e burimeve njerëzore.

Të rëndësishme:

- ❖ Miratimi i Planit të dytë Strategjik për vitet 2022 – 2024 shoqëruar me një Plan Veprimi të detajuar, i cili është konsultuar me të gjitha grupet e interesit dhe për herë të parë, edhe me komunitetin e biznesit.
- ❖ Miratimi i “Planit dyvjeçar të Komunikimit për Gjykatat” si një pikënisje për të strukturuar mënyrën se si gjykatat i përfaqes publikut dhe grupeve të tjera të interesit gjatë një procesi komunikimi e ndërveprimi.
- ❖ Këshilli ka kryer 7 (shtatë) deklarata në mbështetje dhe mbrojtje të figurës së gjyqtarëve si dhe 3 (tre) deklarata për shtyp me objekt “Reagim dhe informim mbi veprimtarinë e Këshillit”
- ❖ 24 kërkesa të ardhura për informacion në respektim të ligjit “Për të drejtën e informimit” të cilat janë trajtuar në kohë dhe brenda afatit të arsyeshëm.
- ❖ Përmirësimi i performancës së Këshillit në kuadër të rritjes së transparencës proaktive duke u vlerësuar me 6 nga 8 pikë maksimale në indeksin e Transparencës Proaktive të Institucioneve Qendrore dhe të Varësisë zhvilluar nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
- ❖ Miratimi me VKM Nr. 495, datë 21.7.2022 të hartës së re gjyqësore, e cila solli ri-konfigurimin e shpërndarjes gjeografike të gjykatave në territorin e Republikës së Shqipërisë, duke vendosur riorganizimin e gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm në 13 nga 22 të tilla, riorganizimin e gjykatave të apelit të juridiksionit të përgjithshëm në 1 nga 6 të tilla, si dhe riorganizimin e gjykatave administrative të shkallës së parë në 2 nga 6 të tilla. Ka ndërmarrë hartimin dhe miratimin e një pakete të plotë aktesh nënligjore.
- ❖ Hartimi dhe miratimi i një pakete të plotë aktesh që mundësojnë zbatimin në praktikë të hartës së re gjyqësore faza e parë për gjykatat e apelit përmes miradministrimit të aspekteve të ndryshme teknike që lidhen qoftë me procedurat e shortimit të çështjeve ashtu dhe me burimet njerëzore nëpër gjykata.
- ❖ Sigurimi i mirëfunktionimit të Qendrës së Teknologjisë së Informacionit dhe miratimi i të gjitha akteve të nevojshme në këtë drejtim, përfshirë miratimin e strukturës dhe organikën e saj.
- ❖ Intensifikimi i punës së QTI për zhvillimin e një sistemi të ri të menaxhimit të çështjeve përmes miratimit të disa vendimeve me qëllim automatizimin e proceseve të punës nëpër gjykata duke synuar rritjen e efikasitetit, aksesit në drejtësi, respektimit të afateve kohore, transparencës, raportimit statistikor dhe llogaridhënies.
- ❖ Përmirësimi sistemeve aktuale gjyqësore (ICMIS dhe ARKIT) përmes zhvillimit si dhe trajtimit të 686 kërkesave për mbështetje teknike për sistemin gjyqësor, me fokus rritjen e efikasitetit apo cilësisë në ofrimin e shërbimeve për të gjithë aktorët përdorues të sistemit përmes automatizimit dhe ofrimin e tyre në mënyrë elektronike.

4. ANALIZA MBI SITUATËN E GJYKATAVE

METODOLOGJIA

Analiza statistikore e sistemit gjyqësor e realizuar në mënyrë vjetore nga KLGJ, bazuar mbi metodologjinë e CEPEJ-it, përpunon dhe analizon 5 indikatorë apo tregues të funksionimit të gjykatës, të tillë si:

- (i) ngarkesa mesatare për gjyqtar (treguesi WR)
- (ii) rendimenti mesatar për gjyqtar (treguesi ER)
- (iii) norma e zgjidhjes së çështjeve (treguesi CR)
- (iv) raporti i qarkullimit të çështjeve (treguesi RQC)
- (v) dhe koha e nevojshme për evadimin e çështjeve (treguesi DT)

Treguesit përpunohen për secilën gjykatë dhe kur është e nevojshme për analizën statistikore trajtohen indikatorët mesatar brenda grupit të gjykatave.

KATEGORIA	TREGUESI	ÇFARË TREGON
BURIMET NJERËZORE	Burimet njerëzore <i>efektive</i>	Llogaritur mbi bazën e kontributit real dhe konkret të çdo gjyqtari.
MENAXHIMI I ÇËSHTJEVE	<i>Backlog</i> -u i mbartur nga një vit më parë	Përcaktohet nga numri i çështjeve në pritje të gjykimit në fillim të periudhës së raportimit. Sa më i madh të jetë <i>backlog</i> -u aq me pak eficient ka qenë sistemi gjyqësor/ gjykata në menaxhimin e fluksit të çështjeve në vite dhe aq më shumë kohë do t'i duhet për të gjykuar çështjet.
	Çështjet e reja të regjistruara	Numri i çështjeve që regjistrohen në gjykatë gjatë periudhës së raportimit. Tregon trendin e çështjeve që pritet të regjistrohen në gjykatë përcaktuar nga ndryshime ligjore, demografike, ekonomike, sociale, etj.
	Ngarkesa e punës në gjykatë	Shuma e <i>backlog</i> -ut dhe çështjet e reja të regjistruara
	Ngarkesën mesatare e punës për gjyqtar (treguesi WR)	Ngarkesa e punës në gjykatë në raport me numrin efektiv të gjyqtarëve. Shërben si element krahasues mes të njëjtit juridiksion dhe nivel gjykimi për të përcaktuar ngarkesën e gjyqtarëve në kushte të ngjashme.
	<i>Backlog</i> -u i mbartur në fund të periudhës së raportimit	Numri i çështjeve në pritje të gjykimit në fund të periudhës së raportimit. Krahasuar me atë të llogaritur në fillim të periudhës së raportimit tregon ecurinë gjatë vitit të gjykatës/ juridiksionit.
EFIÇENCA	Rendimenti mesatar i punës për gjyqtar (Treguesi ER)	Raporti ndërmjet numrit të çështjeve të zgjidhura dhe numrit të gjyqtarëve efektivë gjatë periudhës së raportimit. Shërben si element krahasues mes të njëjtit juridiksion dhe nivel gjykimi për të vlerësuar rendimentin e gjyqtarëve në kushte të ngjashme.
	Koha e nevojshme për evadimin e çështjes (treguesi DT) shprehur në ditë	Raporti i numrit të çështjeve të pazgjidhura me numrin e çështjeve të zgjidhura gjatë periudhës së monitoruar shumëzuar me 365. Raporti mat se sa shpejt sistemi gjyqësor punon mbi çështjet e marra, që do të thotë sa kohë duhet për një lloj të caktuar çështjeje për t'u zgjidhur. Ky tregues jep një perceptim se si sistemi gjyqësor menaxhon sasinë apo fluksin e çështjeve të ardhura.
	Norma e likuidimit të çështjeve (treguesi CR)	Përcaktohet nga raporti ndërmjet çështjeve të përfunduara brenda një periudhe dhe çështjeve të reja, dhënë në përqindje.

4.1. GJYKATA E LARTË

Prej më se 3 vitesh, Këshilli pati prioritet përmbylljen sa më shpejt të procedurave për ngritjen në detyrë të gjyqtarëve në Gjykatën e Lartë, për pozicionet e lira në të tre fushat e së drejtës: penale, administrative dhe civile.

➤ *Procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur.*

Pas realizimit të emërimit të tre anëtarëve në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, me anë të Dekreteve nr. 11452, 11453 dhe 11454, datë 11.03.2020 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Këshilli, përgjatë vitit 2022, vijoi me procedurën për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 172, datë 11.09.2019, në fushë e së drejtës civile.

Procedura e përzgjedhjes së gjyqtarit për në Gjykatën e Lartë nga radhët e juristëve të spikatur, u finalizua me miratimin nga Këshilli të Vendimit nr. 133, datë 06.04.2022, me anë të të cilit u propozua emërimi në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, për kandidatin Darjel Sina. Në përfundim, Presidenti i Republikës së Shqipërisë, me anë të Dekretit nr. 13573, datë 26.04.2022, emëroi kandidatin e propozuar nga Këshilli, si gjyqtar të Gjykatës së Lartë.

➤ *Procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve.*

Këshilli, pas plotësimit të kuadrit ligjor nëpërmjet miratimit të akteve nënligjore të autorizuara nga ligji, në ushtrim të përgjegjësisë për mbarëvajtjen e sistemit gjyqësor dhe në veçanti të funksionit të ngritjes në detyrë të gjyqtarëve të të gjitha niveleve, ka hapur procedurat për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, për katërmbëdhjetë pozicione të lira (nga të cilat 11 pozicioni janë hapur gjatë vitit 2020 dhe tre pozicioni gjatë vitit 2021), nga të cilat:

- 4 (katër) pozicione në fushën e të drejtës penale;
- 5 (pesë) pozicione në fushën e të drejtës administrative;
- 5 (pesë) pozicione në fushën e të drejtës civile.

Në vijim Komisioni ka hapur një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale, për shkak të përfundimit të mandatit të njërit prej gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, të shpallur me vendimin nr. 178, datë 11.05.2022.

Gjykata e Lartë aktualisht ka 15 gjyqtarë dhe po vijon puna intensive për përfundimin edhe të 4 procedurave të mbetura. Këto procese janë të ndërvarura nga vlerësimi etik dhe profesional që kërkon kohën e nevojshme.

ANALIZA STATISTIKORE E GJYKATËS SË LARTË

Burimet njerëzore: Masat e marra për plotësimin e organikës së Gjykatës së Lartë gjatë vitit 2021 kanë sjellë frytet në vitin 2022 duke plotësuar vakancat në Gjykatën e Lartë. Gjatë vitit 2022 kanë ushtruar efektivisht detyrën 13.25⁴⁴ gjyqtarë. Në krahasim me një vit më parë kur

⁴⁴ Shifra, në të gjithë pjesën e analizës statistikore, janë paraqitur me presje dhjetore për shkak të përlogaritjeve aritmetikë për secilin indikator.

gjkata funksiononte me vetëm 7.33 gjyqtarë, shënohet një rritje me 80% duke arritur në organikë të plotësuar në masën 70% për gjyqtarët. Rritje shënohet edhe në rangun e administratës gjyqësore ku organika është plotësuar në masën 74%.


Plotësimi në masën 70% i vakancave të gjyqtarëve në Gjykatën e Lartë, ka sjellë një reduktim të raportit të administratës mbështetëse për gjyqtar në krahasim me një vit më parë. Tashmë një gjyqtar përfiton mbështetjen administrative nga 7.1 nëpunës, sikurse parashikohet në organikë. Mendohet se kjo ndihmë administrative që i jepet gjyqtarëve sjell uljen e kohës së administrimit të dosjes nga vetë gjyqtari, duke ulur kështu kohën efektive që një gjyqtar shpenzon në shqyrtimin e dosjeve. Delegimi i disa veprime administrative të menaxhimit të dosjes tek stafi administrativ, bën të mundur që gjyqtari t'i kushtohet tërësisht analizës ligjore duke rritur si nga pikëpamja sasiore ashtu edhe cilësore vendimmarrjet e tij.

Në detaje, shifrat e burimeve njerëzore të Gjykatës së Lartë për vitin 2022, paraqiten në tabelë më poshtë:

Nr. i gjyqtarëve sipas dekretit	Nr. i gjyqtarëve efektivisht në detyrë	Efektiv vs dekreti në %	Nr. i stafit mbështetës sipas organikës	Nr. i stafit mbështetës efektivisht në detyrë	Efektiv vs organika në %	Staf mbështetës për gjyqtar sipas organikës	Staf mbështetës për gjyqtar në fakt
19	13.25	70%	126	93.5	74%	6.6	7.1

Menaxhimi i çështjeve

Backlog-u i Gjykatës së Lartë : Gjykata e Lartë e ka filluar vitin 2022 me një total prej 36.066 çështjesh në pritje të gjykimit⁴⁵. Ky volum mbetet i trashëguar nga vitet e mëparshme dhe përbën interesin kryesor të vetë gjykatës, si dhe Këshillit të Lartë Gjyqësor. Krahasuar me një vit më




parë çështjet në pritje të gjykimit, shënojnë një ulje prej 222 çështjesh ose 1 %. Grafikisht stoku i çështjeve në pritje të gjykimit për 3 vitet e fundit shfaqet si vijon:

Sikurse vërehet në grafik, ulja e stokut me 222 çështje ose 1% shënon uljen e parë që prej vitit 2019 dhe vjen si rezultat i shtimit të numrit të gjyqtarëve



efektivisht në detyrë. Kjo e dhënë tregon në mënyrë matematikore zgjidhjen e ngërçit sa i takon funksionalizimit të Gjykatës së Lartë.

⁴⁵ Zhvillimet e reja në sistemin elektronik të menaxhimit të çështjeve, kanë mundur rritjen e cilësisë së të dhënave statistikore të raportuara nga gjykatat. Për këtë arsye rezulton se numri i çështjeve në pritje të gjykimit, në janar 2022 është 36.066 çështje, ndryshe nga raportimi i një viti më parë ku raportohej se në janar 2022 mbeteshin pa gjykuar 35.822 çështje.

Përbërja e backlog-ut: Sa i përket natyrës së çështjeve në pritje të gjykimit, vërehet se trendi vijon i njëjtë, pasi të dhënat tregojnë se 52% e stokut të Gjykatës së Lartë përbëhet nga çështje të natyrës civile. Rezultoni se numrin më të vogël të çështjeve e zënë çështjet penale (15%). Kjo e dhënë shpjegohet me faktin se në çështjet penale, për shkak të natyrës së tyre dhe kufizimit të lirisë së personave në pritje të gjykimit, parashikohen afate shqyrtimi, kalimi i të cilave mund të sjell shkelje të procesit të rregullt ligjor.



Çështje të reja të regjistruara: Gjatë vitit 2022 janë regjistruar në Gjykatën e Lartë 2096 çështje të reja për t'u shqyrtuar. Në krahasim me një vit më parë, shënohet një ulje prej 27% të regjistrimeve të reja, e cila shkaktohet nga rënia e regjistrimeve në të tre fushat e së drejtës. Vërehet se ndikim të ndjeshëm ka pasur rënia e regjistrimeve të reja në çështjet civile me 41%, ndërsa janë regjistruar 33% më pak çështje administrative.



Sa i përket **natyrës së çështjeve të reja të paraqitura** në gjykatë gjatë vitit 2022, në vend të parë janë çështje penale (934 çështje), të cilat përbëjnë 45%. Vëndin e dytë e zënë çështjet civile (785 çështje) ose 37% dhe në fund çështjet administrative (337 çështje) me vetëm 18% të çështjeve të regjistruara në Gjykatën e Lartë gjatë vitit të raportimit.

Ngarkesa e Gjykatës së Lartë: Ngarkesa e një gjykatë përbëhet nga tërësia e çështjeve në administrim të saj gjatë afatit kohor të përcaktuar. Ajo është shuma e *backlog*-ut të çështjeve nga vitet e mëparshme dhe çështjeve të reja të regjistruara në gjykatë.

Në mënyrë grafike paraqitet ngarkesa e Gjykatës së Lartë në 4 vitet e fundit, nga ku vërehet se ulja e regjistrimeve të reja që prej vitit 2019, pas 3 vitesh ka arritur të ndikojë në ngarkesën totale të Gjykatës së Lartë, duke shënuar për herë të parë ndryshimin e trendit përmes uljes me 985 çështje.



Treguesi WR: Ngarkesa totale e gjykatës ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në treguesin WR, i cili shpreh ngarkesën mesatare të punës për gjyqtar, çka do të thotë tërësinë e çështjeve të mbartura (*backlog*) dhe të regjistruara rishtazi, të cilat janë për shqyrtim nga një gjyqtar. Në vitin 2022, gjyqtarët e Gjykatës së Lartë kanë pasur mesatarisht 2880 çështje për të shqyrtuar secili.

Nga tabela e mëposhtme vërehet se emërimet e reja në këtë gjykatë kanë sjellë ulje prej 46% të ngarkesës mesatare për gjyqtar. Kjo diferencë përkthehet në rreth 2461 çështje më pak për secilin gjyqtar.

Numri efektiv i gjyqtarëve 2021	Numri efektiv i gjyqtarëve 2022	# në %	WR 2021	WR 2022	# në %
7.33	13.25	81%	5340.7	2880.2	-46%

Treguesit e efincencës:

Rendimenti mesatar i punës për gjyqtar: Treguesi ER shpreh numrin mesatar të çështjeve të përfunduara nga një gjyqtar, gjatë vitit të raportuar. Ai është një nga 3 treguesit e efincencës së gjykatës.

Ndryshe nga një vit më parë, ku rendimenti ishte në ulje, gjatë vitit 2022 vërehet se rendimenti i gjyqtarëve në këtë gjykatë ka shënuar rritjen e tij historike me 90%. Gjatë vitit 2022, 13 gjyqtarët efektiv të Gjykatës së Lartë kanë gjykuar mesatarisht 864 çështje secili, pra 410 çështje më shumë krahasuar me vitin paraardhës.

Gjykata	çështje të gjykuara 2021	çështje të gjykuara 2022	# në %	Gjyqtarë 2021	Gjyqtarë 2022	# në %	ER 2021	ER 2022	# në % i ER
Gj. e Lartë	3325	6335	91%	7.33	13.25	81%	454	478	5%

Nga të dhënat statistikore të paraqitura në tabelë vërehet se 13 gjyqtarë kanë gjykuar bashkërisht 91% më shumë se 7 gjyqtarët e vitit 2021. Këto të dhëna rezultojnë në një rendiment mesatar për gjyqtar prej 478 çështjesh të gjykuara në vit. Duhet vënë në dukje se rendimenti për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, ku gjykohet në kolegje të përbërë nga 3 dhe 5 gjyqtarë, është i vështirë për t'u analizuar, pasi rezultati për gjithsecilin ndërvaret me punën e kolegëve brenda kolegjit.

Norma e likuidimit të çështjeve: Treguesi CR është treguesi i dytë i efincencës në gjykata. Ai përcakton aftësinë e gjykatës për të ruajtur ritmin mes çështjeve të përfunduara dhe çështjeve të reja të regjistruara. Ky indikator përcaktohet për secilën kategori çështjesh civile, penale dhe


administrative. Nëpërmjet treguesit CR dallohet lehtësisht aftësia e gjykatës për të ruajtur, rritur apo ulur nivelet e saj të *backlog*-ut.

Për vitin 2022, normat e likuidimit të çështjeve në Gjykatën e Lartë kanë vijuar me trendin rritës të shënuar një vit më parë. Për herë të parë në 3 vitet e fundit, norma e likuidimit të çështjeve ka kaluar pragun e 100% duke shënuar kështu edhe ulje në çështjet e mbartura për të tre kategoritë. Rritje drastike shënohet në normën e likuidimit të çështjeve administrative (CR administrativ) i cili është trefishuar krahasuar me normën e vitit 2021. Vërehet se treguesi CR administrativ në vitin 2021 shënonte vlerën 193%, ndërsa gjatë vitit 2022 rezulton në vlerën 613% duke treguar kështu kapacitetin e gjykatës të ruaj ritmet e prurjeve të reja dhe njëkohësisht të evadojë çështje të trashëguara nga vitet e mëparshme.

I njëjti trend pozitiv paraqitet dhe për çështjet civile, norma e likuidimit për të cilat është trefishuar krahasuar me një vit më parë. Gjatë vitit 2022, Gjykata e Lartë ka mundur të ruajë ritme të larta likuidimi duke shqyrtuar 2.8 herë më shumë çështje sesa regjistrimet e reja.

Sa i përket likuidimit të çështjeve penale ato shënojnë një rritje të normës me 65% duke arritur nivelin 193%, normë e cila rezulton e pëlqyeshme.

Treguesi	Viti 2021	Viti 2022	# në % e CR.
CR civile	84%	283%	237%
CR administrative	193%	613%	218%
CR penale	117%	193%	65%




Në vitin 2022 rezulton se janë evaduar 6335 çështje. Krahasuar me vitin 2021, Gjykata e Larta ka përfunduar 3010 çështje më tepër duke rritur nivelin e çështjeve të gjykuar me 91%. Ndërsa rezulton se në 2 vjet, kjo gjykatë ka 4-fishuar çështjet e gjykuara duke kaluar nga 1478 çështje të evaduara në 2020 në 6335 çështje të evaduara në vitin 2022. Këto vlera tregojnë efektin e drejtpërdrejtë të rritjes së numrit të gjyqtarëve në funksionimin e gjykatës.

Lidhur me natyrën e çështjeve të evaduara gjatë vitit raportues, e shprehur grafikisht situata paraqitet si vijon: Nga të dhënat statistikore rezulton se Gjykata e Lartë ka balancuar punën midis tre kategorive të çështjeve, duke treguar trajtim thuajse të barabartë të tyre. Rezulton se gjatë vitit 2022, 36% e çështjeve të shqyrtuara janë të natyrës administrative (2311 çështje), 35% të çështjeve janë çështje civile (2219 çështje), dhe 29% janë çështje penale (1805 çështje).



Backlog-u në fund të periudhës: tregon çështjet të cilat nuk u gjykuan gjatë vitit 2022 dhe presin për t'u gjykuar në vitin pasardhës.



Pas uljes së stokut me 1% gjatë vitit 2021, vërehet se vijimi i masave për rritjen e efijçencës dhe emërimet e reja në rangun e gjyqtarëve kanë dhënë frytet. Gjatë 12 muajve të vitit 2022 është shënuar një ulje prej 12%, ulja më domethënëse në 4 vitet e fundit, pavarësisht ndryshimit të *backlog*-ut në fillim të periudhës raportuese, shkaktuar nga ndryshimet e reja të sistemit elektronik.

Në 31 dhjetor 2022, *backlog*-u i Gjykatës së Lartë ka shënuar vlerën 31,827 çështje, 12% më i ulët se në fillim të vitit dhe vetëm 11% më i lartë krahasuar me *backlog*-un e vitit 2019 duke ulur ndjeshëm, rritjen e pësuar gjatë vitit 2019 dhe 2020.

Ndonëse treguesit e efijçencës vijnë të përmirësohen nga viti në vit, *backlog*-u i trashëguar mbetet problematik dhe kërkon marrjen e masave strukturore për zgjidhjen e situatës.

Nga projeksioni i vitit 2021, rezultonte se stoku kërkonte 4.2 vjet punë me 19 gjyqtarë të dedikuar vetëm për stokun e trashëguar të Gjykatës së Lartë dhe akoma një numër prej 6.73 gjyqtarësh për të përballuar çështjet e reja që paraqiteshin në gjykatë.

Projeksioni i bazuar mbi treguesit e efijçencës për vitin 2022 rezulton pozitiv.

Në pritje të gjykimit në fund të vitit raportues mbeten ende 31,826 çështje. Nga raportimet statistikore të mbledhura rezulton se, që prej vitit 2019 pranë Gjykatës së Lartë regjistrohen mesatarisht 3587.5 çështje të reja në vit. Nëse do të merreshin këto ndryshore, së bashku me hipotezën se 19 gjyqtarët e Gjykatës së Lartë do të ruanin rendimentin e gjyqtarëve gjatë vitit 2022 me 864.3 çështje të gjykuara në vit për gjyqtar, stoku total i Gjykatës së Lartë do të ezaurohej plotësisht gjatë vitit 2026.

Gjetjet kryesore!

- Gjykata e Lartë e ka filluar vitin 2022 me një total prej 36 066 çështjesh në pritje të gjykimit.
- Ajo ka funksionuar me 70% të gjyqtarëve dhe 74% të administratës gjyqësore të parashikuar në organikë
- Gjatë vitit 2022 në Gjykatën e Lartë janë regjistruar 2 096 çështje të reja.
- Çdo gjyqtar ka mesatarisht 2 880 çështje në ngarkim, 478 nga të cilat i ka përfunduar në vitin 2022.
- Gjatë vitit raportues Gjykata e Lartë ka arritur të:
 - evadojë 6 335 çështje civile, administrative dhe penale;
 - dyfishojë normën e likuidimit të çështjeve civile dhe administrative dhe të rrisë me 65% normën e likuidimit të çështjeve penale.
- Të mbyll vitin 2022 me një stok të reduktuar me 12%. Në 1 janar 2023, në Gjykatën e Lartë presin të shqyrtohen 31 827 çështje (*backlog*-u i vitit 2022).
- Nëse do të ruheshin të njëjtat ritme likuidimi, 19 gjyqtarët e Gjykatës së Lartë do të likuidonin të gjithë *backlog*-un e Gjykatës së Lartë brenda dhjetorit të 2026.

4.2. GJYKATAT E POSAÇME PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

Një tjetër përparësi, referuar edhe rekomandimit nr.2 të Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë, për vitin 2022, ishte plotësimi i vendeve vakante në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe në Gjykatën e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Duhet evidentuar fakti se, Këshilli, ka operuar në vijimësi me rihapjen e disa pozicioneve të lira në gjykatat e posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar, në kushtet e shfaqjes së një interesi të vogël nga ana e gjyqtarëve për ngritjen në detyrë në këto gjykata, si dhe numrit të kufizuar të kandidatëve potencial referuar numrit të gjyqtarëve të konfirmuar në detyrë në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar.

4.2.1. GJYKATA E POSAÇME E APELIT PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

Gjatë vitit 2022, Këshilli ka vijuar procedurat e ngritjes në detyrë për kandidatët që kandiduan për 4 pozicionet e lira të shpallura në vitin 2021⁴⁶. Për këto 4 pozicione kandiduan 3 gjyqtarë (një prej të cilëve ka kandiduar për tre pozicione dhe dy të tjerë për një pozicion), në përfundim të të cilave u ngritën në detyrë 3 gjyqtarë⁴⁷.

Burimet njerëzore: Vëmendja e veçantë që i është kushtuar kësaj gjykate nga Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe përdorimi i mekanizmave alternative ndaj ngritjes në detyrë, për caktimin e gjyqtarëve në një gjykatë, kanë sjellë rritjen në numrin e gjyqtarëve që gjykojnë çështje në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, në krahasim me vitin 2021. Sa i përket situatës tërësore të burimeve njerëzore, ajo paraqitet si vijon:


Nr. i gjyqtarëve sipas organikës	Nr. i gjyqtarëve efektivisht në detyrë	Efektivi vs Organika në %	Nr. i stafit mbështetës sipas organikës	Nr. i stafit mbështetës efektivisht në detyrë	Efektiv vs organika në %	Staf mbështetës për gjyqtar sipas organikës	Staf mbështetës për gjyqtar në fakt.
11	7.91	72%	31	22.92	74%	2.8	2.9

Gjatë vitit 2022, Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ka punuar me 72% të organikës së gjyqtarëve, thënë ndryshe me 7.91 gjyqtar, 3.3 gjyqtarë më shumë, krahasuar me vitin 2021 kur gjykonin vetëm 4.58 gjyqtar. Këta gjyqtarë janë asistuar nga 74% e stafit administrativ të planifikuar, që rezulton në një raport 2.9 nëpunës për çdo gjyqtar efektivisht në detyrë. Krahasuar me një vit më parë, ndonëse është shtuar organika dhe numri i nëpunësve efektivisht në detyrë, stafi mbështetës për gjyqtar është ulur me 0.6 nëpunës më pak për secilin gjyqtar në detyrë.

⁴⁶ Me vendimet nr. 30 datë 25.01.2021 dhe nr. 117-119 datë 01.04.2021 të KLGJ-së.


⁴⁷ Vendimi nr.153 datë 20.04.2022 “Për ngritjen në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar të z. Engert Pëllumbi”; Vendimi nr.443 datë 01.11.2022 “Për ngritjen në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar të znj. Tereza Merkaj”; Vendimi nr.4451 datë 01.11.2022 “Për ngritjen në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar të z. Florjan Kalaja”.

Menaxhimi i çështjeve: Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar e ka filluar punën në 1 janar 2022 me një ngarkesë (*backlog*) prej 24 çështjesh në pritje për t'u gjykuar, pra një çështje më shumë se viti paraardhës.



Backlog-u: grafikisht është paraqitur situata e *backlog*-ut në këtë gjykatë në 3 vite. Vërehet se çështjet e mbartura për vitin pasardhës mbeten në vlera pothuaj të njëjta në 23 apo 24 çështje për t'u shqyrtuar, çka justifikohet me karakteristikën e çështjeve për gjykim. Këto vlera tregojnë menaxhim shumë të mirë të ngarkesës gjyqësore dhe një mungesë stoku real, pasi çështjet e mbartura mund të jenë çështje në shqyrtim në kohën e raportimit.

Çështje të reja të regjistruara: Gjatë vitit 2022 në këtë gjykatë janë regjistruar një total prej 314 çështjesh të reja. Në krahasim me vitin 2021 vlera e regjistrimeve të reja është 14% më e ulët. Në detaje çështjet e paraqitura në gjykatë rezultojnë sipas grafikut në vijim.



Sikurse vërehet në grafik, peshën kryesore të çështjeve të paraqitura në gjykatë e zënë çështjet penale administrative, një trend që vërehet në të tre vitet e studiuar. Ndërsa vlen të përmendet, sikurse në vitin 2021, dyfishimi i numrit të krimeve të regjistruara një dukuri e përsëritur edhe në vitin 2022. Çështjet e ligjit antimafia⁴⁸ mbeten në vlera minimale duke u luhatur mes 2 apo 3 çështje në vit në të 3 vitet e njëpasnjëshme.



Në total, **ngarkesa e punës në gjykatë** (e cila përbëhet nga *backlog*-u i vitit pararendës dhe çështjet e regjistruara gjatë vitit të referencës) paraqitet si në grafikun në krahtë:

Nga të dhënat statistikore të paraqitura në grafik rezultojnë se ngarkesa totale e gjykatës në vitin 2022 është ulur me 11%. Pavarësisht



luhatjeve duhet thënë se Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar rezultojnë gjykata e apelit me ngarkesën më të ulët në rang republike.

⁴⁸ Në kategorinë "Çështje të ligjit antimafia" përfshihen çështjet me objekt konfiskimin e pasurisë sipas parashikimeve të Ligjit nr. 10 192, datë 3.12.2009 "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë", i ndryshuar (Ligji antimafia)

Treguesi WR: Treguesi WR për gjyqtarët që ushtrojnë detyrën në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për vitin 2022 është 42.7 çështje mesatarisht për gjyqtar. Krahasuar me një vit më parë, si pasojë e rritjes së numrit të gjyqtarëve që ushtrojnë detyrën në këtë gjykatë, ngarkesa mesatare për gjyqtar është përgjysmuar. Bazuar në të dhënat statistikore të vitit 2021, secili gjyqtar kishte në ngarkim mesatarisht 85.2 çështje për të gjykuar.

Gjatë vitit 2022, gjykata ka evaduar (thënë ndryshe ka gjykuar) gjithsej 304 çështje, përkundrejt 365 çështjeve të gjykuara një vit më parë. Kryesisht çështjet e gjykuara janë të natyrës penale administrative, të cilat zënë 79% të çështjeve të gjykuara në tërësi. Ndërsa janë gjykuar vetëm 3 çështje të ligjit antimafia që përbëjnë 1%.

Të detajuara sipas llojit, çështjet e përfunduara paraqiten në grafik.




Sa i përket mënyrës së disponimit, apo zgjidhjes së çështjes, vërehet se 214 (ose 71%) e vendimeve të shkallës së parë, janë lënë në fuqi nga gjykata e apelit. Ndërsa në 10% të rasteve të shqyrtuara është cenuar vendimi i shkallës së parë duke u disponuar me kthimin e akteve për rigjykim apo ndryshim të vendimit. Krahasuar me vitin 2021 vërehet një ulje e nivelit të vendimeve të lëna në fuqi, të cilat në vitin paraardhës përbënin 90% të çështjeve të gjykuara.

Treguesit e efincencës

Treguesi ER: Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ka pësuar një ulje të rendimentit mesatar për gjyqtar me 52%. Gjatë vitit 2022 një gjyqtar ka gjykuar mesatarisht vetëm 38 çështje, në krahasim me 80 çështje që gjykonte mesatarisht në vitin 2021. Praktikisht një gjyqtar gjatë vitit 2022 ka një rendiment mesatar 2 herë më pak se një vit më parë, rendiment ky që ka pësuar ulje për shkak të rritjes së numrit të gjyqtarëve në këtë gjykatë. Kështu, 8 gjyqtarët efektiv të kësaj gjykate kanë përfunduar bashkërisht një total prej 304 çështjesh, pra 17% më pak se një vit më parë.


Gjykata	Çështje të gjykuara 2021	Çështje të gjykuara 2022	# në %	Gjyqtarë 2021	Gjyqtarë 2022	ER 2021	ER 2022	# i ER në %
Gj. e Posaçme e Apelit KKO	365	304	-17%	4.58	7.91	79.7	38.4	-52%

Treguesi CR: Norma e likuidimit të çështjeve për vitin 2022 është 98%. Krahasuar me vitin paraardhës, ajo rezulton 3% më e vogël, çka do të thotë se gjatë vitit 2022, gjykata nuk ka mundur të përfundojë gjatë vitit të raportimit tërësinë e çështjeve të reja të regjistruara, duke rritur kështu nivelin e stokut për vitin pasardhës, i përlogaritur për çdo kategori çështjesh, treguesi CR varion. Norma minimale e likuidimit shënohet në kategorinë e krimeve me 88% (4% më pak sesa në vitin 2021, kur likuidoheshin 92% e krimeve).



Kjo normë, e reflektuar në totalin e 69 çështjeve të kategorisë, përkthehet me 8 çështje të mbartura, e dhënë e cila nuk vlerësohet problematike.

Treguesi DT (Treguesi i kohës së nevojshme për evadimin e çështjeve) është një prej indikatorëve cilësorë të sistemit gjyqësor. Ai është indikatori i vetëm që lidhet drejtpërdrejt me parimin e drejtësisë pa vonesa, duke shprehur në ditë kohëzgjatjen mesatare të nevojshme për përfundimin e një çështjeje gjyqësore.




Bazuar në të dhënat statistikore, rezulton se gjatë vitit 2022, përdoruesve të gjykatës iu është dashur të presin mesatarisht 40.8 ditë për përfundimin e një çështjeje. Ky indikator rezulton të jetë rritur në krahasim me vitin 2021, ku koha e nevojshme për evadimin e çështjeve ishte 25 ditë.

Kjo zgjatje e afateve, ndonëse aspak problematike vjen si pasojë e zgjatjes me 8 ditë të shqyrtimit të çështjeve penale me natyrë administrative të cilat janë gjithashtu çështjet më të shpeshta që ka kjo

gjykatë dhe përbëjnë 80% të çështjeve të gjykuara. Krahasuar me vitin paraardhës shënohet një ndryshim pozitiv me një ulje të kohës së nevojshme për 3 kategori kryesore, si shqyrtimi i çështjeve të themelit për krimet, masat e sigurimit dhe çështje të ligjit antimafia. Pavarësisht ndryshimit të mesatares, gjykimi në këtë gjykatë mbetet më i shpejti në të gjithë sistemin gjyqësor.

Backlog-u në fund të vitit: Pavarësisht uljes së ngarkesës dhe rritjes së numrit të gjyqtarëve efektivisht në detyrë, backlog-u i krijuar në fund të vitit 2022 rezulton më i lartë se në fillim të periudhës. Në pritje të gjykimit për vitin 2023 janë 34 çështje në total. Rritja e backlog-ut në fund të periudhës shpjegohet me uljen e rendimentit mesatar për gjyqtar, por edhe për shkak të natyrës së çështjeve në gjykatat e posaçme, të cilat mund të sjellin zgjatje të shqyrtimit gjyqësor, duke i kategorizuar 34 çështje në pritje, si çështje të cilat janë duke u shqyrtuar nga gjykata.



Gjetjet kryesore!

- Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (GJPAKKO) e ka filluar vitin 2022 me një backlog prej 24 çështjesh në pritje të gjykimit.
- Gjatë vitit 2022 janë regjistruar 314 çështje të reja, (53 çështje më pak, krahasuar me vitin 2021)
- Megjithëse ka funksionuar me 72% të gjyqtarëve dhe me ngarkesë të ulët të çështjeve, Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (GJPAKKO) nuk ka arritur të përmirësojë performancën e saj, krahasuar me vitin paraardhës.
- GJPAKKO gjatë vitit 2022 ka:
 - Realizuar një nivel stoku të ulët të çështjeve të mbartura (10 % e ngarkesës totale);
 - ulur me 52% rendimentin mesatar për gjyqtar;
 - realizuar një normë pozitive të likuidimit të çështjeve në masën 97%;
 - mbajtur një kohëzgjatje mesatare për likuidimin e çështjeve në masën 40.8 ditë.
- GJPAKKO do të fillojë vitin 2023 me 34 çështje të mbartura nga vitit paraardhës.

4.2.2. GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

Në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar u hapën gjatë vitit 2022, 3 pozicione të reja të lira ku kanë kandiduar 17 (shtatëmbëdhjetë) kandidatë. Në këto kushte, Këshilli ka vijuar punën për përfundimin e procedurave të renditjes së kandidatëve për secilin nga pozicionet e lira të shpallura në këtë gjykatë.



Për sa i përket emërimeve, gjatë vitit 2022, në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar është emëruar një gjyqtar⁴⁹ i cili kishte kandiduar për një pozicion të lirë të shpallur gjatë vitit 2021.

Burimet njerëzore: Situata e burimeve njerëzore gjatë vitit 2022 paraqitet në tabelë, ku vihet re se Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ka funksionuar me 47% të organikës së gjyqtarëve (2% më tepër se viti paraardhës) dhe me 93% të organikës së stafit mbështetës. Raporti staf mbështetës për çdo gjyqtar efektivisht në detyrë është 6.1. Ky raport është ulur krahasuar me një vit më parë, por mbetet sërish me 3 nëpunës më tepër krahasuar me raportin e planifikuar në organikë, ku një gjyqtar asistohet mesatarisht nga 3 nëpunës.

Nr. i gjyqtarëve e sipas dekretit	Nr. i gjyqtarëve efektivisht në detyrë	Efektiv vs dekreti në %	Nr. i stafit mbështetës sipas organikës	Nr. i stafit mbështetës efektivisht në detyrë	Efektiv vs organik a në %	Staf mbështetës për gjyqtar sipas organikës	Staf mbështetës për gjyqtar në fakt.
16	7.5	47%	49	45.5	93%	3.1	6.1


⁴⁹ Vendim nr.434 datë 21.10.2022 “Për ngritjen në detyrën e gjyqtarës së Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar të znj. Flojera Davidhi”

Menaxhimi i çështjeve: Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar e ka nisur punën në janar 2022 me 181 çështje në pritje të gjykimit, përkundrejt 158 çështjeve stok në fillim të vitit 2021. Kjo rritje prej 15% vjen si pasojë e rritjes së numrit të çështjeve në pritje të gjykimit të kategorizuara si çështje penale administrative, ndërsa vërehet një ulje e numrit të stokut për 2 kategoritë e tjera. *Backlog*-ut vlerësohet në vlera të pranueshme dhe të justifikueshme si çështje të cilat janë efektivisht në gjykim.





Natyrë e Backlog-ut: Në lidhje me natyrën e çështjeve në pritje të gjykimit rezultojnë se 68% e tyre i përkasin kategorisë së çështjeve penale administrative duke thelluar tendencën e një viti më parë, ku stoku përbëhej nga 60% çështje penale administrative. Vërehet se çështjet e ligjit antimafia vazhdojnë të zënë një përqindje të vogël të stokut, i cili rezultojnë në masën 4%. Volumi i kategorisë së krimeve është ulur nga 35% në vitin 2021 në 28% në vitin 2022.

Krahasuar me vitin 2021, vërehet se gjatë vitit referues në gjykatë është shënuar rënie e numrit të çështjeve të regjistruara me 7%. Gjatë vitit 2022 janë regjistruar në total 144 çështje më pak. Niveli i ulët i çështjeve të reja reflektohet në të 3 kategoritë.



Sa i përket llojit të çështjeve të paraqitura në gjykatë, situata paraqitet grafikisht në të djathtë. Rezulton se 94% e çështjeve të regjistruara i përkasin kategorisë së çështjeve penale administrative, ndërsa vetëm 4% janë krime për t'u gjykuar në gjykatë dhe 2% çështje për zbatim të ligjit antimafia. Vërehet se raporti mes kategorive është i njëjtë me vitin 2021.



Ngarkesa totale e gjykatës: për periudhën e raportimit është 2240 çështje, shumë që përbën totalin e çështjeve të mbartura nga viti 2021 dhe çështjet e reja të paraqitura në këtë gjykatë gjatë vitit 2022. Në mënyrë të detajuar sipas kategorisë së çështjeve, ngarkesa paraqitet grafikisht, ku tregohet edhe një herë se ngarkesa kryesore përbëhet nga çështjet penale administrative.

Ngarkesa mesatare e punës (Treguesi WR), shpreh ngarkesën mesatare për gjyqtar duke përlogaritur tërësinë e çështjeve të përbëra nga stoku dhe çështjet e reja të regjistruara, për çdo gjyqtar efektivisht në detyrë gjatë periudhës së raportimit. Sikurse paraqitet në tabelën e mëposhtme ngarkesa për gjyqtar në vitin 2022 është ulur me 9%. Ulja e ngarkesës ndikohet njëkohësisht nga tre faktorë: ndryshimi i lehtë i *backlog*-ut, ulja e numrit të çështjeve të reja dhe rritja e numrit të gjyqtarëve efektiv.

Numri gjyqtarëve efektiv 2021	Numri i gjyqtarëve efektiv 2022	WR 2021	WR 2022	# në %
7.16	7.5	329.7	298.7	66%

Vjetërsia e çështjeve në pritje: Edhe pse e plotësuar vetëm në 47% të organikës së gjyqtarëve, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ka arritur të ruaj një nivel *backlog*-u të përballueshëm për vitin 2023. Në fund të periudhës raportuese gjykata ka evaduar një total prej 2088 çështjesh ose 93% të ngarkesës totale të gjykatës duke mbartur për shqyrtim në 2023 një stok prej 152 çështjesh. Rezulton se 67% e stokut përbëhet nga çështjet e reja të regjistruara gjatë 2022 nga të cilat, 31% janë çështje të regjistruara në 6 mujorin e dytë të vitit; 51 çështje ose 34% e stokut janë në pritje të gjykimit prej më shumë se një vit, dhe vetëm 1 çështje pret prej më shumë se 3 vitesh.

VJETËRSIA E ÇËSHTJEVE NË PRITJE TË GJYKIMIT							
Lloji i çështjes	NUMRI I ÇËSHTJEVE NË PRITJE TË GJYKIMIT						
	Në pritje të	< 6 muaj	6-12 muaj	1-2 vjet	2-3 vjet	3-5 vjet	> 5 vjet
A. Krime	61	32	12	12	4	1	0
B. Kundërvajtje penale	0	0	0	0	0	0	0
C. Çështje penale administrative	77	17	30	28	2	0	0
D. Çështje të ligjit antimafia	14	5	5	4	0	0	0
E. ÇËSHTJE PENALE GJITHSEJ (A+B+C+D)	152	54	47	44	6	1	0

Në vështrim të vjetërsisë së çështjeve në pritje të gjyqimit, mund të deduktojmë se shqyrtimi në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar realizohet brenda afateve kohore të arsyeshme.


Treguesit e efikasitetit

Treguesi ER ose rendimenti mesatar i punës për gjyqtar: shpreh numrin mesatar të çështjeve të gjykuara nga çdo gjyqtar efektivisht në detyrë, gjatë periudhës raportuese. Për vitin 2022, treguesi ER për Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar është 278.4 çështje për gjyqtar. Vërehet se rritja e organikës me 0.34 gjyqtar, ka sjellë një ulje të lehtë të treguesit ER me 8.6%.

Gjyqtarë 2021	Gjyqtarë 2022	ER 2021	ER 2022	# në % i ER
7.16	7.5	304.5	278.4	- 8.6 %


Treguesi CR ose norma e zgjidhjes së çështjeve: shpreh aftësinë e një gjykate për të likuiduar çështjet e reja të regjistruara pranë saj. Ky tregues është i rëndësishëm për të parë nëse gjykata është në kushtet e krijimit të stokut apo uljes së tij.

Për Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, viti 2022 ka shënuar një rritje në normën e likuidimit të çështjeve duke arritur vlerën 101% në krahasim me CR e vitit 2021 që ishte 99%. Kjo normë likuidimi mbi pragun e 100% tregon se gjykata, pavarësisht mangësive në organikë, ka arritur të evadojë një numër maksimal çështjesh, duke ruajtur ritmin dhe duke evaduar 1% stok. I shprehur sipas kategorive me sensibilitet të lartë treguesi CR paraqitet grafikisht në vijim:



Treguesi DT: Bazuar në të dhënat statistikore të raportuara nga vetë gjykata, rezultojnë se treguesi DT ka ndjekur trendin përmirësues sikurse një vit më parë. Në vitin 2021, në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar zgjidhja e një çështjeje zgjaste mesatarisht 30.3 ditë, ndërsa gjatë vitit 2022 rezultojnë se mesatarisht për zgjidhjen e një çështjeje palët duhet të presin 26.6 ditë.

Koha e nevojshme per evadimin e çështjes



242% ose 172 ditë më shumë.

Për çështjet ndaj të cilave opinioni publik ka treguar interes të veçantë, treguesi DT, paraqitet me afate kohore më të gjata, dhe ka shënuar një rritje të treguesit për të gjitha kategoritë sensitive, sikurse paraqitet në formë grafike në vijim:

Vërehet se koha e nevojshme për përfundimin e çështjeve të korrupsionit është dyfishuar, nga 104 ditë në 2021, në 316 ditë në 2022. Koha e zgjidhjes së çështjeve të krimit të organizuar, është zgjatur me 26% ose me 104 ditë, ndërsa çështjet e ligjit antimafia shënojnë një rritje me

Gjetjet kryesore!

- Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar e ka nisur punën në janar 2022 me 181 çështje në pritje të gjykimit (backlog), 23 çështje më shumë krahasuar me backlog-un në fillim të vitit 2021.
- Në gjykatë janë regjistruar 2059 çështje të reja, 7% ose 144 çështje më pak krahasuar me vitin paraardhës.
- Rritja e numrit efektiv të gjyqtarëve në vitin 2022, në krahasim me vitin paraardhës ka sjellë rritjen e tërësisë së treguesve të efikasitetit në gjykatë:
 - ngarkesa mesatare për gjyqtar (WR) është ulur me 31 çështje;
 - rendimenti mesatar për gjyqtar (ER) është 278.4 çështje;
 - norma e likuidimit të çështjeve (CR) është 101%;
 - koha mesatare e nevojshme deri në zgjidhjen e një çështjeje (DT) e përgjithshme është 26.6 ditë.
- Në fund të vitit raportues, në këtë gjykatë mbeten në pritje për t'u shqyrtuar 152 çështje nga 181 në vitin 2021.

4.3. GJYKATAT E APELIT TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM

Këshilli i Lartë Gjyqësor, gjatë vitit 2022 ka hapur procedurat e ngritjes në detyrë pranë gjykatave të apelit të juridiksionit të përgjithshëm, për 3 (*tre*) pozicione të lira. Konkretisht:

- a) një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale”, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë;
- b) një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale”, pranë Gjykatës së Apelit Durrës;
- c) një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale”, pranë Gjykatës së Apelit Korçë.

Brenda afatit të kandidimit për këto pozicione të lira, kandiduan 25 (*njëzet e pesë*) kandidatë, për 3 (*tre*) nga pozicionet e lira.

Për sa i përket, ngritjeve në detyrë në gjykatat e apeleve të juridiksionit të përgjithshëm, gjatë vitit 2022, Këshilli realizoi 7 ngritje në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, Durrës dhe Korçë⁵⁰. Konkretisht, në Gjykatën e Apelit Tiranë u ngritën në detyrë 5 gjyqtarë për 5 pozicione të shpallura në vitin 2020; në Gjykatën e Apelit Durrës 1 gjyqtar për një pozicion të shpallur në vitin 2020, dhe në Gjykatën e Apelit Korçë 1 gjyqtar për një pozicion të shpallur në vitin 2022.

Përmendim faktin se, edhe gjatë vitit 2022 Këshilli me përgjegjësinë e mbarëvajtjes së pushtetit gjyqësor ka ndërmarrë masa imediate për zgjidhjen e situatave të krijuara në disa gjykata të apeleve me qëllim mos bllokimin e tyre, por ecurinë e punës dhe shqyrtimin e çështjeve gjyqësore, nëpërmjet mekanizimit të caktimit të gjyqtarëve në “skemë delegimi” dhe “caktimit të gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve të veçanta në gjykata të tjera të ndryshme nga ku ushtrojnë detyrën”.

Burimet njerëzore: për vitin 2022, në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm kanë vijuar të jenë në vlera problematike. Në total organika është e plotësuar me 44% gjyqtarë dhe 81% të administratës së nevojshme.

Situata paraqitet veçanërisht problematike në Gjykatën e Apelit të Tiranës dhe Durrësit ku kanë gjykuar vetëm 35% e gjyqtarëve të parashikuar si të nevojshëm, ndërsa në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë dhe Vlorë shënohet vlera më pozitive me një organikë gjyqtarësh të plotësuar në masën 64%.

Sa i përket administratës gjyqësore, situata paraqitet thajse uniforme. Të gjitha gjykatat funksionojnë me 74-84% të organikës së parashikuar. Krahasuar me vitin 2021 vërehet se përqindja e organikës së stafit mbështetës të gjykatave është ulur megjithëse numri i punonjësve efektiv është rritur. Kjo dukuri ndodh si rezultat i alokimit të organikës shtesë në gjykata,


⁵⁰ Vendim nr.154 datë 20.04.2022 “Për ngritjen në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit Tiranë znj. Lutfije Celami”; Vendim nr.165 datë 05.05.2022 “Për ngritjen në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit Tiranë të znj. Marsela Dervishi”; Vendim nr.166 datë 05.05.2022 “Për ngritjen në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit Tiranë të znj. Elona Mihali; Vendim nr.167 datë 05.05.2022 “Për ngritjen në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit Tiranë të znj. Ornela Naqellari; Vendim nr.169 datë 05.05.2022 “Për ngritjen në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit Tiranë të znj. Irida Kacerja; Vendim nr.187 datë 17.05.2022 “Për ngritjen në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit Durrës të z. Sokol Pina; Vendim nr.414 datë 10.10.2022 “Për ngritjen në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit Korçë z. Dritan Hasani.

vendimmarrje e Këshillit për të lehtësuar punën dhe ngarkesën e gjyqtarëve në këto gjykata, e cila bën që pavarësisht punësimeve të reja, organika të vijoj të mbetet e pa plotësuar.

Kështu, nëse vërejmë shtyllën e fundit të tabelës do të shohim se një gjyqtar ndihmohet nga një stafi më i madh sesa raporti i parashikuar në organikën bazë duke variuar nga një nëpunës më shumë e deri në dyfishin e raportit të parashikuar, sikurse vërehet në Tiranë.


Në mënyrë të detajuar për secilën gjykatë, burimet njerëzore paraqiten në formë tabelare si vijon:

Gjykata e Apelit	Nr. i gjyqtarëve sipas dekretit	Nr. i gjyqtarëve ve efektivisht në detyrë	Efektivi vs dekreti në %	Nr. i stafit mbështetës sipas organikës	Nr. i stafit mbështetës efektivisht në detyrë	Efektiv vs organika në %	Staf mbështetës për gjyqtar sipas organikës	Staf mbështetës për gjyqtar në fakt.
Durrës	13	4.5	35%	26	20.33	78%	2	4.5
Gjirokastrë	6	3.83	64%	15	11.75	78%	2.5	3.1
Korçë	6	2.75	46%	15	12.33	82%	2.5	4.5
Shkodër	10	5	50%	26	21.83	84%	2.6	4.4
Tiranë	31	10.91	35%	81	67.67	84%	2.6	6.2
Vlorë	12	7.66	64%	33	24.42	74%	2.8	3.2
Total	78	34.65	44%	196	158.33	81%	2.5	4.6




Menaxhimi i çështjeve: Nga të dhënat statistikore, raportuar nga gjykatat për vitin 2022 rezulton se sasia e *backlog*-ut (stokut) varion në mënyrë të dukshme mes gjykatave të së njëjtit nivel. Numri më i lart i çështjeve në pritje të gjykimit rezulton në Gjykatën e Apelit të Tiranës, e cila mbart 63% të stokut total të apeleve. Vendin e dytë e mban Gjykata e Apelit Vlorë me 4234 çështje në pritje të gjykimit. Gjykata me stokun më të vogël është Gjykata e Apelit Gjirokastrë me vetëm 339 çështje në pritje të gjykimit në fillim të periudhës.

Cështje të reja të regjistruara: regjistrimet e reja, janë elementi i dytë që përcakton ngarkesën totale të gjykatës. Gjatë vitit 2022, në gjykatat e apelit janë regjistruar gjithsej 14,176 çështje të reja nga të cilat 6362 ose 45% janë çështje civile dhe 7814 ose 55% çështje penale. Në krahasim me një vit më parë, shënohet një ulje prej 2986 çështjesh, ose 17%.



Ngarkesa e punës: Është totali i çështjeve, të cilat janë për shqyrtim në një gjykatë. Këtu përfshihen bashkërisht numri i çështjeve në pritje të gjykimit nga viti i mëparshëm (*backlog-u*), si dhe totali i çështjeve të reja të regjistruara në gjykatë gjatë vitit referues. Krahasuar me një vit më parë, evidentohet një rritje e ngarkesës së punës me 25% ose 2452 çështje. Rritja e ngarkesës shkaktohet tërësisht nga rritja e *backlog*-ut me 24% ose 5438 çështje më shumë sesa në vitin 2021, pasi çështjet e reja të regjistruara kanë shënuar një ulje krahasuar me vitin 2021. Të dhënat përcaktojnë tërësinë e çështjeve për 6 gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm, të cilat që prej 1 shkurtit 2023 janë bashkuar në një gjykatë të vetme.




E shpërndarë sipas gjykatave, ngarkesa për secilën rezulton në disproporcion të madh me një ngarkesë që ndryshon me 1870% mes Gjykatës së Apelit Tiranë dhe Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, ose 20 herë më të lartë. Vërehet se në gjykata me ngarkesë të ulët, si ato të apelit Gjirokastrë dhe Korçë, diferenca me ngarkesën mesatare të grupit është 493% dhe 326% çka reflekton një shpërndarje jo të drejtë të ngarkesës dhe nevojën për riorganizim të gjykatave, me qëllim ekuilibrimin e volumit të punës.

Treguesi WR: është indikator që pasqyron ngarkesën mesatare të gjyqtarit efektivisht në detyrë. Volumi total i punës për secilin gjyqtar të apelit, sipas gjykatës përkatëse, për dy vitet e fundit, paraqitet në formë tabelare. Në tabelë përfshihet njëkohësisht edhe numri efektiv i gjyqtarëve për dy vitet e fundit.

Gjykata e Apelit	Numri efektiv i gjyqtarëve 2021	Numri efektiv i gjyqtarëve 2022	# në %	WR 2021	WR 2022	# në %
Durrës	5.3	4.5	-16%	999.6	1102.7	10%
Gjirokastrë	5	3.83	-23%	252.8	310.4	23%
Korçë	3	2.75	-8%	564.3	601.5	7%
Shkodër	4.8	5.0	4%	853.8	791.8	-7%
Tiranë	7.9	10.9	38%	2572.7	2142.5	-17%
Vlorë	6.8	7.7	12%	1040.3	936.9	-10%

Nga tabela dallohet qartë lidhja direkte mes numrit të gjyqtarëve që ushtrojnë funksionet gjatë vitit të dhënë dhe ngarkesës mesatare në gjykatë. Krahasuar me vitin paraardhës, vërehet se rritja e organikës efektive në Gjykatën e Apelit Tiranë dhe Gjykatën e Apelit Vlorë ka sjellë një rënie prej 10-20% të ngarkesës për gjyqtarët e këtyre gjykatave. Në Tiranë vërehet se ardhja e 3 gjyqtarëve të rinj, dhe rishpërndarja e dosjeve gjyqësore ka lehtësuar gjyqtarët e tjerë duke reduktuar ngarkesën mesatare me 430 çështje më pak.

Grafikisht vërehet diferenca e theksuar e ngarkesës për gjyqtarë, të cilët i përkasin të njëjtës shkallë gjykimi dhe juridiksioni. Më të ngarkuar mbeten gjyqtarët e Tiranës, të cilët kanë në ngarkim 7 herë më shumë çështje sesa gjyqtarët në Gjirokastrë. Ndërsa mesatarja e treguesit WR rezulton të jetë 981 çështje, sërish gjykata me ngarkesë të ulët për gjyqtarë, si Gjirokastrë dhe Korçë rezultojnë në shifra 1.5 ose 3 herë më të vogla se mesatarja.



Sikurse është reflektuar shpesh, diferenca të mëdha ngarkese mes gjyqtarësh sjellin trajtim të disfavorshëm për gjyqtarët, si dhe për qytetarin çështja e të cilit shqyrtohet nga gjyqtarë të mbingarkuar dhe për pasojë, për një kohë më të gjatë. Vlerësohet se problematikës së ekuilibrit të ngarkesës së gjykatës dhe gjyqtarëve i është dhënë zgjidhje përmes ristrukturimit dhe bashkimit të gjykatave të apelit në një gjykatë të vetme, efekt i hartës së re gjyqësore, duke realizuar kështu një rishpërndarje të drejtë të ngarkesës së gjyqtarëve në të gjitha nivelet dhe juridiksionet. Sipas hartës së re gjyqësore, gjyqtarët e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, gjatë vitit 2022 (nëse harta do të ishte aplikuar në vitin raportues) do të kishin mesatarisht 1221.2 çështje secili.

Treguesit e efikasitetit:



Rendimenti mesatar për gjyqtar (treguesi ER): tregon numrin e çështjeve që ka gjykuar mesatarisht një gjyqtar, gjatë vitit të raportuar. Krahasuar me një vit më parë, vërehet se në të gjitha gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm është ulur rendimenti i gjyqtarëve. Ulje minimale prej 1% është shënuar në Durrës dhe Gjirokastrë, ndërsa uljen më domethënëse e kanë shënuar gjyqtarët e Tiranës, të cilët kanë gjykuar 26% ose 110 çështje sesa në vitin 2021.

Gjykata e Apelit	ER 2021	ER 2022	# në % i ER
Durrës	455	448.4	-1%
Gjirokastrë	185.0	184.1	-1%
Korçë	287.0	260.7	-9%
Shkodër	401.2	365.2	-9%
Tiranë	341.2	302.9	-11%
Vlorë	420.4	310.1	-26%
Mesatare e treguesit ER	348	311.9	-10%

Nivelet e treguesit ER thellojnë mungesën e ekuilibrit në shpërndarjen e ngarkesës mes gjyqtarëve. Sikurse vërehet nga tabela, gjyqtarët me rendiment më të ulët rezultojnë në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë, të cilët kanë gjykuar mesatarisht 184 çështje secili. Ndërsa gjyqtarët me rendiment më të lartë janë gjyqtarët e Apelit Shkodër, të cilët kanë gjykuar 365 çështje secili, pothuaj 2 herë më shumë se Gjirokastra.

Këto të dhëna të treguesit të rendimentit figurojnë alarmante nëse do të analizoheshin jashtë kontekstit tërësor të gjendjes së gjykatës. Një e dhënë që vlerësohet domethënëse sa i përket rendimentit të gjyqtarëve është raporti mes treguesit ER dhe treguesit WR. Nëse do të vështroheshin në tërësi do të vihej re se në Gjykatën e Apelit Shkodër janë gjykuar një total prej 365.2 çështje mesatarisht nga secili gjyqtar, të cilat përbëjnë vetëm 46% të ngarkesës së punës së këtij gjyqtari. Nëse i rikthehemi shifrave të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë do të shohim se një gjyqtar i kësaj gjykate ka një ngarkesë totale pune prej 310.4 çështjesh secili, çka do të thotë se, edhe nëse gjyqtarët e Gjirokastrës do të përfundonin tërësinë e çështjeve në ngarkim të tyre, pra nëse treguesi ER dhe treguesi WR do të barazoheshin, sërish rendimenti i këtyre gjyqtarëve do të ishte më i ulët se rendimenti i gjyqtarëve të Shkodrës.

Treguesi CR: Norma e likuidimit të çështjeve për gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm nuk paraqitet e kënaqshme. Vërehet se mes normës së likuidimit të çështjeve civile dhe penale nuk kemi të njëjtin trend në gjykata.




Në fushën penale asnjë gjykatë nuk ka arritur normë likuidimi të çështjeve 100%, çka do të thotë se të 6 gjykatat e apelit kanë shtuar nivelin e stokut me çështje penale, por kanë ruajtur një normë

likuidimi të përafërt mes tyre me një variacion mes 77%-95%. Ndryshe paraqitet gjendja për likuidimin e çështjeve civile për të cilat norma varion në mënyrë të ndjeshme mes gjykatave, duke shënuar vlerën më të ulët dhe problematike në Gjykatën e Apelit Tiranë në 31%. Pavarësisht rritjes së normës së likuidimit nga 23% në vitin 2021, në 31% gjatë vitit 2022, sërish kjo normë nuk është aspak e pëlqyeshme, pasi 69% e çështjeve civile të regjistruara gjatë vitit 2022 kanë kaluar si backlog për vitin 2023. Ndërsa në gjykatat e tjera të këtij grupi, ndonëse pragu i 100% është kaluar vetëm nga Gjykata e Apelit Durrës dhe Shkodër, për 3 gjykatat e tjera norma e likuidimit është në vlera mbi 80%, të cilat ndonëse jo të pëlqyeshme, nuk paraqesin rrezik të lartë për sistemin.

Treguesi DT: Për vitin 2021 treguesi DT (koha e nevojshme për evadimin e çështjeve e shprehur në ditë) për çdo gjykatë rezulton sipas grafikëve të mëposhtëm:


Të renditur me rregull rritës, treguesit DT për çështjet civile dhe çështjet penale paraqiten në grafikën e mësipërm. Në kolonën jeshile paraqitet afati i arsyeshëm parashikuar nga legjislacioni në fuqi.



Sikurse vërehet vizualisht në çështjet civile, koha mesatare e nevojshme për shqyrtimin e çështjet ndryshon në varësi të gjykatës. Në dy gjykata të apelit, në Gjirokastrë dhe Shkodër çështjet civile gjykohen brenda afatit të arsyeshëm, ndërsa në 4 gjykatat e tjera shqyrtimi civil i kalon afatet e arsyeshme për dhënien e vendimit. Problematike paraqitet gjendja në Gjykatën e Apelit Tiranë ku treguesi DT shënon vlerën 5995.3 ditë ose 16.4 vjet.

Ritmet e gjykimit në çështjet penale figurojnë më pozitive. Në 4 gjykata çështjet shqyrtohen brenda afatit të arsyeshëm edhe pse ndryshe nga afati për çështjet civile që është 2 vjet, çështjet penale duhet të shqyrtohen brenda një afati 1-vjeçar. Gjykata e Apelit Vlorë ka shënuar një rritje të kohës së nevojshme për shqyrtimin e çështjeve penale me 170.6 ditë krahasuar me vitin 2021, duke tejkaluar kështu pragun e 365 ditëve të afatit të arsyeshëm. Gjykata e Apelit Tiranë, pavarësisht përmirësimit të shënuar, duke ulur kohët e gjykimit me 144.7 ditë, vijon të gjykojë përtej afateve të arsyeshme.


Në tërësi vërehet se gjykimi i çështjeve penale, vijon të karakterizohet nga kohë më të shpejta gjykimi në krahasim me çështjet civile.



Stoku i çështjeve të prapambetura (backlog-u) 2022: Në 31 dhjetor 2022, 31 370 çështje presin të shqyrtohen nga gjykatat e apelit. Gjatë vitit 2022, pavarësisht përpjekjeve backlog-u është rritur me 11% ose 3 230 çështje më shumë se në fillim të vitit kur raportoheshin 28 140 çështje stok. Ato janë kryesisht çështje civile dhe vetëm 32% çështje penale.

Pavarësisht volumit të vogël, duhet përmendur se numri i çështjeve penale stok ka shënuar rritje.

Të kategorizuara sipas natyrës dhe kohës së pritjes, çështjet rezultojnë sipas grafikut në të djathtë. Vërehet se 34% janë çështje të regjistruara gjatë vitit 2022. Vendin e dytë, me 32% e zënë çështjet e kategorisë 2-3 vjet. Ndërsa 3 497 çështje presin prej 3-5 vitesh për t'u shqyrtuar nga gjykatat e apelit. Me moshën më të vjetër, me një pritje prej më shumë se 5 vitesh, rezultojnë 120 çështje penale dhe 375 çështje civile, të cilat përbëjnë 1% të backlog-ut të vitit 2022. Këto çështje janë të regjistruara në Tiranë (463 çështje), në Shkodër (24 çështje) dhe të tjerat në Korçë e Gjirokastrë.



Gjetjet kryesore!

- Backlog-u total në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm ka arritur vlerën 28,140 çështje, 24% më tepër krahasuar me vitin 2021. Për shtimin e stokut kanë kontribuar të gjitha gjykatat e apelit;
- Gjatë vitit raportues, janë regjistruar 14,176 çështje të reja (2986 çështje më pak se në vitin 2021), të cilat janë kryesisht në Tiranë (40% e çështjeve) dhe në Vlorë (21%).
- Ngarkesa mesatare për gjyqtar (treguesi WR) është rritur në Gjykatat e Apelit Durrës, Gjirokastrë dhe Korçë. Ngarkesa mesatare është ulur në Shkodër, Tiranë dhe Vlorë. Pavarësisht mbetet problematike ngarkesa e gjyqtarëve në Tiranë me 2142.5 çështje për gjyqtar.
- Treguesit e efikasitetit gjatë vitit 2022 janë përkeqësuar:
 - Rendimenti i gjyqtarëve të apelit është ulur në të gjitha gjykatat e grupit.
 - Treguesi i kohës së nevojshme për zgjidhjen e çështjes (DT) ka shënuar rritje në të dyja fushat e së drejtës.
 - Në Gjykatën e Apelit Tiranë, tendenca për zgjidhjen e çështjes përpara zbatimit të hartës së re gjyqësore përllogaritet se do të shkonte deri në 5995.3 ditë (16,4 vjet). Me një gjykatë të vetme apeli, koha e nevojshme do të jetë 6 herë më pak, me një tregues DT prej 1046 ditësh (2.9 vjet)
 - Norma e likuidimit të çështjeve ka shënuar rritje në disa gjykata për çështjet civile dhe çështjet penale. Me përjashtim të treguesin CR civile të Apelit Shkodër dhe Durrës, gjykatat e këtij grupi nuk arrijnë pragun e 100%.
- Në vitin 2023 mbeten për t'u shqyrtuar 31,370 çështje në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

4.4. GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT


Sistemi gjyqësor në vendin tonë parashikon një gjykatë apeli të juridiksionit administrativ. Në këtë gjykatë gjatë vitit 2022 kanë ushtruar detyrën 6⁵¹ gjyqtarë, nga 13 të tillë që parashikohet në organikë. Për sa i përket emërimeve, gjatë vitit 2022 është emëruar një gjyqtar⁵² i cili kishte kandiduar për një pozicion të lirë të shpallur gjatë vitit 2020. Për të adresuar situatën e krijuar në kushtet e mungesës së burimeve njerëzore, të ilustruar më në detaje më poshtë. Këshilli ka ndërmarrë masa duke përdorur mekanizimin e caktimit të gjyqtarëve në “skemë delegimi” dhe “caktimit të gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve të veçanta në gjykata të tjera të ndryshme nga ku ushtrojnë detyrën”.

Burimet njerëzore: Sikurse një vit më parë, edhe gjatë vitit 2022 Gjykata Administrative e Apelit ka pësuar rënie të numrit të gjyqtarëve efektivisht në detyrë. Ajo ka funksionuar me 43% të numrit të gjyqtarëve të parashikuar dhe me 80% të organikës së administratës gjyqësore.

Në kushtet e mungesës së gjyqtarëve, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka marrë masa për përmirësimin e kushteve të punës së gjyqtarëve, duke rritur numrin e stafit mbështetës jo vetëm në organikë, por edhe në fakt. Si rezultat, raporti staf mbështetës për gjyqtar, sipas organikës ka arritur vlerën 4.4 ndaj raportit 3.92 në vitin 2021, ndërsa në fakt secili gjyqtar asistohet nga 8.2 nëpunës.

Nr. i gjyqtarëve sipas dekretit	Nr. i gjyqtarëve efektivisht në detyrë	Efektiv vs dekreti në %	Nr. i stafit mbështetës sipas organikës	Nr. i stafit mbështetës s efektivisht në detyrë	Efektiv vs organik a në %	Staf mbështetës s për gjyqtar sipas organikës	Staf mbështetës s për gjyqtar në fakt
13	5.58	43%	57	45.83	80%	4.4	8.2

Ngarkesa e gjykatës:



Backlog-u i gjykatës në fillim të vitit: Gjykata Administrative e Apelit e ka filluar vitin raportues me një stok të konsiderueshëm prej 18,415 çështjesh, të akumuluar gjatë viteve.



Një vështrim historik i stokut të Gjykatës Administrative të Apelit tregon një tendencë të hershme të rritjes së stokut. Ndërsa në vitin 2021 stoku ka shënuar një rritje prej 18%, në vitin raportues situata

⁵¹ Nga të cilët 1 gjyqtar është vendosur në skemë delegimi pranë Gjykatës Administrative të Apelit deri më datë 18.07.2023, me vendimin nr. 260, datë 15.07.2022 të KLGJ-së.

⁵² Vendim nr.168 datë 05.05.2022 “Për ngritjen në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës Administrative të Apelit të z. Eriol Roshi.


është përkeqësuar duke u rritur me 21%. Kjo shpjegohet me numrin gjithmonë në ulje të gjyqtarëve efektivisht në detyrë.

Sipas llojit të çështjeve *Backlog-u* në fillim të periudhës raportuese paraqitet në grafikun në krah. Sikurse vërehet grafikisht, rezulton se stoku i gjykatës përbëhet në masën 77% ose 14,114 çështje administrative të përgjithshme, 14% çështje administrative pa palë kundërshtare (2627 çështje gjithsej) dhe vetëm 9% ose 1674 çështje që i përkasin marrëdhënieve të punës.



Në lidhje me origjinën, ose prejardhjen e çështjeve në pritje të gjykimit, konstatohet se 9232 çështje ose 50% e stokut përbëhet nga çështje të ardhura nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë. 2624 çështje, që përkon me 14% nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë. Pjesa tjetër 10% ose 1759 çështje paraqiten direkt në gjykatë si juridiksion fillestar dhe vetëm 26% të ndara në gjykatat e tjera.



Çështje të reja të regjistruara: Pas rritjes së pësuar gjatë vitit 2021, nga të dhënat e raportuara rezulton se regjistrimet e çështjeve të reja në gjykatë për vitin 2022 janë ulur sërish duke arritur vlerat e regjistruara gjatë vitit 2020. Trendi i çështjeve të reja të regjistruara tregohet në formë grafike për periudhën 2019-2022 si vijon.



Nga të dhënat grafike vërehet se regjistrimet e reja në gjykatë karakterizohen nga luhatje të mëdha nga viti në vit. Kështu vërehet se në vitin 2019 në gjykatë janë regjistruar plot 4620 çështje të reja, ndërsa gjatë 2020 vlera është ulur me 1000 çështje e më pas është rritur sërish në vlera mbi 4000 çështje. Ndërsa gjatë vitit 2022, regjistrimet e çështjeve të reja në Gjykatën Administrative të Apelit kanë shënuar një ulje prej 12% ose 504 çështje më pak.

Referuar kategorisë së çështjeve të paraqitura në gjykatë gjatë vitit 2022 vërehet se ndiqet i njëjti trend sikurse në vitin 2021.

Gjatë vitit raportues janë regjistruar 2756 çështje administrative të përgjithshme, të cilat përbëjnë 76% të regjistrimeve totale. Kategoria e dytë e regjistruar janë çështjet administrative pa palë kundërshtare, një total prej 717 çështjesh ose 20% të regjistrimeve të reja, dhe vetëm 4% ose 168 çështje për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të punës.



Çështjet e reja të paraqitura në Gjykatën Administrative të Apelit janë kryesisht ankime ndaj vendimeve të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me 58%, Vlorë me 11%, Shkodër 10% dhe në fund nga Gjykatat Administrative të Shkallës së Parë Durrës, Gjirokastrë dhe Korçë, të cilat nuk kapin pragun e 10%. Vlen të përmendet se gjatë vitit 2022 janë regjistruar 115 çështje të reja me gjykim fillestar, të cilat përbëjnë 3% të çështjeve të reja të regjistruara.

Ngarkesa mesatare e punës (Treguesi WR): shpreh tërësinë e çështjeve në ngarkim të një gjyqtari. Treguesi rezulton nga totali i ngarkesës së gjykatës (stoku + çështjet e reja të regjistruara), në përpjesëtim me numrin efektiv të gjyqtarëve.

GJYKATA	Numri efektiv i gjyqtarëve 2021	Numri efektiv i gjyqtarëve 2022	# ne %	WR 2021	WR 2022	# në %
Gj. Administrative e Apelit	6.91	5.58	-19%	2793.3	3952.7	42%

Gjatë vitit 2022, në Gjykatën Administrative të Apelit, një gjyqtar ka pasur në ngarkim mesatarisht 3952.7 dosje gjyqësore për të shqyrtuar, pra 1159.4 çështje më tepër sesa në vitin 2021. Kjo rritje me 42% është shkaktuar nga ulja e numrit të gjyqtarëve efektiv me 19%, si dhe rritja e numrit të çështjeve të mbartura nga viti i mëparshëm (*backlog*).


Treguesit e efikasitetit:

Treguesit e efikasitetit në gjykatë janë 3 dhe shprehin (i) rendimentin e gjyqtarëve (treguesi ER); (ii) normën e zgjidhjes së çështjes (treguesi CR) dhe (iii) kohën e nevojshme për likuidimin e çështjeve nga gjykata i shprehur në ditë (treguesi DT). Këta tre indikatorë, të ndërlidhur mes tyre, japin panoramën e plotë të efikasitetit të gjykatës.

Norma e eficencës (Treguesi ER): Treguesi ER tregon numrin e çështjeve të zgjidhura mesatarisht nga një gjyqtar. Rendimenti i gjyqtarëve që ushtrojnë efektivisht funksionin në Gjykatën Administrative të Apelit në vitin 2022 është rritur me 25%. Gjatë vitit 2022, 5.58 gjyqtarët efektiv të Gjykatës së Apelit Administrativ, edhe pse kanë pësuar rritjen e ngarkesës dhe uljen e numrit të kolegëve, kanë arritur të ruajnë të njëjtat vlera të çështjeve të gjykuara me vetëm 0.3% diferencë. Gjatë vitit raportues një gjyqtar ka arritur të përfundojë mesatarisht 159.5 çështje, 31.5 çështje më tepër se në vitin paraardhës.

Gjykata	çështje të gjykuara 2021	çështje të gjykuara 2022	# në %	Gjyqtarë 2021	Gjyqtarë 2022	# në %	ER 2021	ER 2022	# në % i ER
Gj. Administrative e Apelit	887	890	0.3%	6.91	5.58	-19%	128	159.5	25%


Norma e zgjidhjes së çështjeve (treguesi CR): Gjatë vitit 2022 Gjykata Administrative e Apelit



nuk ka arritur të ruajë ritmin e likuidimit mes çështjeve të reja të regjistruara dhe atyre të përfunduara. Treguesi CR për këtë gjykatë është vetëm 24%. Kjo rënie tregon se, gjatë vitit 2022, gjykata ka shtuar në stokun e çështjeve të prapambetura, 76% të çështjeve të reja të regjistruara në gjykatë, të cilat në pamundësi për t'u likuiduar gjatë vitit të regjistrimit, do të mbarten në vitin pasardhës.


Koha e nevojshme deri në zgjidhjen e çështjes

(treguesi DT): Sikurse vërehet grafiki gjatë vitit 2022 ka vijuar të thellohet problematika e kohës së nevojshme për likuidimin e çështjeve. Në krahasim me një vit më parë, një çështje përfundon për një afat kohor mesatar prej 8680.4 ditësh, që do të thotë 14.6% më gjatë se në vitin paraardhës. Ky tregues shfaq qartë gjendjen problematike në të cilën ndodhet Gjykata Administrative e Apelit.




Për likuidimin total të *Backlog*-ut prej 18,415 çështjesh, me normën e eficencës së vitit 2022 (159.5 çështje për gjyqtar) do të nevojiteshin 8.9 vjet pune me organikë të plotë (13 gjyqtarë) të dedikuar vetëm në likuidimin e stokut, çka dikton nevojën për ndërhyrje në kuadrin ligjor apo ndërhyrje të tjera me karakter organizativ, me qëllim uljen e ngarkesës së kësaj gjykate.

Backlog-u në fund të vitit 2022: Në fund të periudhës raportuese Gjykata Administrative e Apelit, sikurse u analizua më lartë, për shkak të normës së ulët të likuidimit të çështjeve, ka shtuar stokun e saj me 15% duke arritur vlerën e 21,166 çështje në pritje për t'u shqyrtuar në vitin pasardhës. Mosha e çështjeve në pritje të gjykimit paraqitet grafikisht si më poshtë:



Në përfundim të periudhës raportuese, vërehet se 3 511 çështje presin të shqyrton prej një viti, çka do të thotë se 96% e çështjeve të regjistruara gjatë vitit 2022 mbeten për t'u shqyrtuar në vitet në vijim. Vërehet se 7499 çështje presin të shqyrtohen prej 3-5 vjetësh dhe përbëjnë 35% të stokut total të gjykatës. 13% e *backlog*-ut, ose 2801 çështje presin të gjykohen prej më shumë se 5 vjet. Ndërsa vërehet se 83% e çështjeve në pritje të gjykimit kanë vjetërsi mbi 12 muaj, për rrjedhojë kanë kaluar afatet e arsyeshme të gjykimit, parashikuar nga neni 399/2, të Kodit të Procedurës Civile.



Megjithëse, situata e çështjeve në pritje të gjykimit paraqitet problematike, vlen të analizohet edhe kohëzgjatja e çështjeve, të cilat janë likuiduar nga kjo gjykatë. Kështu gjatë vitit 2022 janë gjykuar një total prej 890 çështjesh nga të cilat, 671 çështje që përbëjnë 75% të çështjeve të gjykuara kanë zgjatur mbi 2 vjet. Ndërkohë janë shqyrtuar gjithashtu 89 çështje ose 10% të çështjeve nga 1-2 vjet. Rezulton se gjykata ka shqyrtuar në total 85% të çështjeve përtej afatit 1-vjeçar. Kjo tregon se gjykata, sikurse edhe në dy vitet paraardhëse, i ka dhënë prioritet shqyrtimit të çështjeve të vjetra, duke synuar uljen e numrit të çështjeve të shqyrtuara jashtë afatit.

Gjetjet kryesore!

- Gjykata Administrative e Apelit, vitin 2022 e ka filluar me 18,415 çështje në pritje për t'u gjykuar (*backlog*-u), 21% më shumë se në vitin 2021.
- Janë regjistruar edhe 3641 çështje të reja ose 504 çështje (12%) më pak se një vit më parë.
- 43% e gjyqtarëve të Gjykatës Administrative të Apelit janë përballur me një ngarkesë mesatare prej 3952.7 çështjesh për gjyqtar (42% më të lartë krahasuar me vitin 2021).
- Treguesit e efijencës kanë shënuar një përmirësim të lehtë, megjithëse nuk është evituar rritja e *backlog*-ut dhe zgjatja e afateve të gjykimit.
 - Norma mesatare e efijencës për gjyqtar (ER) është 159.5 çështje (25% më shumë, krahasuar me vitin 2021).
 - Norma e likuidimit të çështjeve (CR) është rritur nga 21% në vitin 2021, në 24% në vitin 2022.
 - Për zgjidhjen e një çështjeje tendenca është, që në kushtet aktuale, duhen mesatarisht 8680.4 ditë (23.8 vjet). Ky afat është rritur me 14.6% krahasuar me një vit më parë.
- Në fund të vitit 2022, mbeten ende në pritje të gjykimit 21 166 çështje (15% më shumë se në fillim të vitit).

4.5. GJYKATAT E RRETHEVE GJYQËSORE TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM

Gjykatat e rretheve gjyqësore me juridiksion të përgjithshëm funksionojnë të shtrira në shumicën e rretheve të vendit, me numër total 22 gjykata. Edhe këto gjykata janë prekur si pasojë e vendimmarrjeve të procesit të rivlerësimit kalimtar, daljes në pension dhe dorëheqjeve. Por nga ana tjetër, gjatë vitit 2022, Këshilli ka emëruar dhe caktuar në mënyrë të përhershme, pranë gjykatave të rretheve gjyqësore 19 magistratë që përfunduan Shkollën e Magjistraturës.


Burimet njerëzore: Organika e gjykatave të rretheve gjyqësore rezulton e plotësuar në masën 56% për gjyqtarët dhe 94% të stafit administratë gjyqësorë. Krahasuar me vitin 2021, kanë ushtruar funksionet 19.3 gjyqtar më pak. Sa i përket, administratës mbështetëse vërehet një rritje e numrit tërësor të administratës dhe raportit mes staf mbështetës për gjyqtar. Shpërndarja e gjyqtarëve nuk është homogjene dhe varion nga 44% e organikës në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, deri në organikë të plotë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër dhe Kurbin. Mbi administratën e gjykatës, e cila lehtëson aspektin administrativ të menaxhimit të çështjeve duke ndikuar në mënyrë të tërthortë në rendimentin e gjyqtarit, situata paraqitet pozitive. Gjatë vitit 2022, kanë ushtruar efektivisht detyrën 585.4 nëpunës gjyqësor, mesatarisht 4,4 punonjës për çdo gjyqtar, ndërsa gjatë vitit 2021 një gjyqtar asistohet nga 3.4 nëpunës.

Sa i përket shpërndarjes nëpër gjykata, plotësimi i organikës është mjaft pozitiv me një minimum prej 84% e organikës në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë.


Gjykata e Rrethit Gjyqësor	Nr. i gjyqtarëve sipas dekretit	Nr. i gjyqtarëve efektivisht në detyrë	Efektiv vs dekreti në %	Nr. i stafit mbështetës sipas organikës	Nr. i stafit mbështetës efektivisht në detyrë	Efektiv vs organika në %	Staf mbështetës për gjyqtar sipas organikës	Staf mbështetës për gjyqtar në fakt.
Berat	10	5	50%	24	22	92%	2.4	4.4
Dibër	4	4	100%	15	13	87%	3.8	3.25
Durrës	17	7.4	44%	43	38.3	89%	2.5	5.2
Elbasan	14	6.3	45%	36	33.4	93%	2.6	5.3
Fier	14	7.8	56%	37	33.8	91%	2.6	4.3
Gjirokastrë	6	3.1	51%	17	17	100%	2.8	5.5
Kavajë	4	3.6	90%	12	11.6	97%	3.0	3.2
Korçë	14	6.6	47%	32	27	84%	2.3	4.1
Krujë	4	3.3	83%	15	14.4	96%	3.8	4.3
Kukës	4	3.4	85%	13	11.8	91%	3.3	3.5
Kurbin	4	4	100%	16	14.6	91%	4.0	3.6
Lezhë	5	3.4	68%	20	19.7	98%	4.0	5.8
Lushnje	5	4	80%	16	14.8	93%	3.2	3.7
Mat	4	3	75%	12	11.8	98%	3.0	3.9
Përmet	4	1.8	46%	11	10.3	93%	2.8	5.6
Pogradec	4	2	50%	13	11.4	88%	3.3	5.7

Pukë	4	1.9	48%	12	11.8	98%	3.0	6.2
Sarandë	6	4.5	75%	17	15.9	94%	2.8	3.5
Shkodër	14	7.7	55%	34	31.8	94%	2.4	4.2
Tiranë	76	39.5	52%	178	174.9	98%	2.3	4.4
Tropojë	4	2.5	63%	12	12	100%	3.0	4.8
Vlorë	14	7.9	57%	37	34.2	92%	2.6	4.3
Totali	235	132.69	56%	622	585.4	94%	2.6	4.4

Në formë grafike plotësimi i organikës në gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm, shkalla e parë, paraqitet si vijon:




Backlog-u i vitit 2021: është ngarkesa e gjykatës në fillim të vitit të raportuar dhe përbëhet nga çështjet të cilat nuk janë përfunduar në vitet paraardhëse.




Për grupin e gjykatave të rrethit gjyqësor, ngarkesa totale e çështjeve të pashqyrtuara nga viti 2021 është 36,590 çështje nga të cilat 28,392 janë çështje civile dhe 8 198 çështje penale. Krahasuar me *backlog*-un e vitit 2020, vërehet se gjatë 2021 është krijuar një diferencë stoku 7936 çështje, ose 28% më shumë, ngarkesë kjo e cila do të ndikojë në vitin e raportuar. Stoku i shtuar konsiston në çështje civile, pasi vërehet se çështjet penale të mbartura kanë pësuar ulje me 28 çështje.

Në vijim paraqitet *backlogu* i shpërndarë sipas gjykatave përkatëse:



Numrin më të madh të çështjeve të mbartura e shënon Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me një stok prej 19,374 çështjesh, e cila përbën 53% të stokut total për këtë grup gjykatash. Raporti i shpërndarjes së stokut ndjek trendin e përcaktuar që prej vitit 2019 ku 4 gjykata, gjithmonë të njëjta, Tiranë (53%), Durrës (6%), Elbasan (7%) dhe Vlorë (5%), mbajnë 70% të stokut total. Pesë gjykatat me stokun mesatar, kanë në ngarkim nga 3% të *backlog*-ut total, këto gjykata janë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat, Fier, Korçë, Sarandë dhe Shkodër. Duhet vënë në dukje se stoku mes gjykatave krijon një variacion drastik me një diferencë të stokut të çështjeve nga Tirana në Pukë në masën nga 26 deri në 440%. Ndryshime të tilla në ngarkesë janë të dhëna faktike që vërtetojnë se ishte i nevojshëm riorganizimi i kompetencave tokësore të gjykatave, me qëllim rishpërndarjen e ekuilibruar të ngarkesës mes tyre.


Çështje të reja të regjistruara: Gjatë vitit 2022 janë regjistruar gjithsej 96,596 çështje të reja nga të cilat 54% ose 52,287 çështje civile dhe 44,309 çështje penale ose 46% e totalit. Krahasuar me vitin 2021 rezultojnë 14,225 çështje më pak (- 13%), të cilat reflektohen me një ulje të çështjeve civile në masën 23% dhe vetëm 3% më pak çështje penale.



Të shpërndara sipas gjykatës në të cilën janë regjistruar, çështjet e reja të regjistruara për vitin 2022 paraqiten në të majtë. Grafikisht vërehet se çështjet gjatë vitit raportues, janë shënuar kryesisht në Tiranë ku rezultojnë 34,382 çështje të reja (36% e totalit), në vend të dytë vjen Durrësi me 8097 çështje (8% e totalit) më pas Elbasani me 7359 çështje të reja të regjistruara (8% e totalit).

Ngarkesa totale e gjykatës:

është shumorja mes ngarkesës fillestare, stokut të mbartur nga viti i mëparshëm dhe regjistrimeve të reja gjatë vitit raportues. Për vitin 2022 ngarkesa totale në gjykatat e rretheve gjyqësore është ulur me 5%, e shkaktuar nga ulja e çështjeve të reja të regjistruara, ndërsa *backlog*-u ka shënuar zbritje.



Ngarkesa mesatare e gjyqtarëve (Treguesi WR): Ngarkesa totale ndikon drejtpërdrejt në ngarkesën mesatare për gjyqtar, pasi shpërndahet në mënyrë të barabartë mes gjyqtarëve efektivisht në detyrë, në secilën gjykatë. Në vitin 2022 ngarkesa mesatare e gjyqtarëve ka pasur një tendencë kryesisht në rritje. Mesatarja e treguesit WR për vitin 2022 është 776 çështje për gjyqtar, 81 çështje më shumë krahasuar me mesataren e vitit 2021.

Bëjnë përjashtim nga tendenca e përgjithshme 8 gjykata, të cilat kanë shënuar ulje të ngarkesës mesatare për gjyqtar. Ndryshimet më pozitive kanë qenë për gjyqtarët e Krujës, të cilët kanë pasur në shqyrtim 221 çështje më pak krahasuar me vitin 2021 dhe gjyqtarët në Tropojë, të cilët kanë pasur një ngarkesë me 112 çështje më pak gjatë vitit raportues.

Nga të dhënat, të paraqitura në formë tabelare më poshtë, vërehet se shpërndarja e ngarkesës nuk plotëson kriteret e ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, për politikat e administrimit të gjykatave, i cili parashikon një ndarje të ekuilibruar të ngarkesës mes gjykatave dhe gjyqtarëve.

Gjykata	Treguesi WR 2021	Treguesi WR 2022	# në %
Berat	738	864	17%
Dibër	448	451	1%
Durrës	993	1412	42%
Elbasan	1182	1592	35%
Fier	786	905	15%
Gjirokastrë	811	736	-9%
Kavajë	795	762	-4%
Korçë	703	885	26%
Krujë	861	640	-26%
Kukës	522	487	-7%
Kurbin	528	473	-10%
Lezhë	956	1066	12%
Lushnjë	719	753	5%
Mat	385	390	1%
Mesatar	695	776	1%
Përmet	195	330	69%
Pogradec	597	911	69%

Pukë	245	185	53%
Sarandë	823	745	-24%
Shkodër	635	932	-9%
Tiranë	1066	1361	47%
Tropojë	335	223	28%
Vlorë	961	968	-34%

Vërehet një disbalancë e theksuar mes ngarkesës së gjyqtarëve në gjykata si Puka (185 çështje për gjyqtar) apo Tropoja me ngarkesë 223 çështje për gjyqtar, të krahasuar me gjyqtarët me të ngarkuar të grupit. Në vitin 2022, një gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan ka pasur në ngarkim mesatarisht 1592 çështje, 8.6 herë më shumë sesa gjyqtari i Pukës dhe 4.5 herë më shumë sesa ngarkesa totale e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë.


Situata e çekuilibrit të shpërndarjes së ngarkesës mes gjykatave dhe gjyqtarëve të së njëjtit nivel dhe juridiksion gjykimi bëhet akoma më alarmante kur vërehet se: një gjyqtar në Elbasan ka një ngarkesë mesatare personale prej 1592 çështjesh, ndërsa ngarkesa totale e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë (total stok + regjistrime të reja) është 354 çështje, ngarkesa totale e Gjykatës së Tropojës është 557 çështje dhe ngarkesa totale e Gjykatës së Përmetit është 603 çështje. Të mbledhura së bashku, ngarkesa e 3 gjykatave më të vogla në vend është 1514 çështje, 78 çështje më pak sesa një gjyqtar i vetëm në Elbasan. Në këto 3 gjykata, gjatë vitit 2022 kanë ushtruar efektivisht detyrën 6.2 gjyqtar.

Kjo mungesë ekuilibri në ngarkesë dhe shfrytëzim jo efektiv i burimeve njerëzore, ndërmjet gjykatave ka qenë një ndër shkaqet kryesore për krijimin e një harte të re gjyqësore, të ri-konceptuar me qëllim për të ekuilibruar ngarkesat nëpër gjykata, jo vetëm për të trajtuar në mënyrë të barabartë gjyqtarët brenda sistemit, por mbi të gjitha për të unifikuar cilësinë e shërbimeve dhe drejtësisë së dhënë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.


Treguesit e efijencës

Treguesi ER: Rendimenti mesatar për gjyqtar në vitin 2022, për gjykatat e rretheve gjyqësore, është në masën 563, 116 çështje më tepër krahasuar me mesataren e vitit 2021 që ishte 547 çështje për gjyqtar.

Pavarësisht rritjes së mesatares së treguesit ER, rendimenti i gjyqtarëve të së njëjtit nivel varion ndjeshëm midis gjykatave. Gjykata si Elbasani dhe Durrësi kanë arritur rendiment mjaft të lartë, ku një gjyqtar ka gjykuar 1051 çështje në Elbasan, 967 në Durrës. Krahasuar me gjyqtarët në gjykata si Puka apo Tropoja, një gjyqtar i Elbasanit ka gjykuar mesatarisht 6 ose 7 herë më shumë.



Krahasuar me vitin 2021 vërehen dy trende të ndryshme. Në 12 nga 22 gjykatat e këtij grupi është shënuar një rritje e përgjithshme e rendimentit të gjyqtarëve. Ndërsa në 10 gjykata të tjera rendimenti për gjyqtar është ulur.




Grafikisht në të majtë shfaqet ndryshimi i rendimentit të gjyqtarëve, krahasuar me vitin 2021 i shprehur në përqindje. Sikurse vërehet, gjyqtarët e gjykatës Tropojë, Krujë, Pukë dhe Kukës kanë pasur një rënie të theksuar të rendimentit në masën mbi 24%. Rënie më të madhe e kanë shënuar gjyqtarët e Tropojës, të cilët kanë gjykuar 36% më pak çështje (-108 çështje). Në vlera absolute rënie më domethënëse të rendimentit e kanë shënuar gjyqtarët e Krujës, të cilët kanë

gjykuar 216 çështje më pak sesa në vitin 2021. Rritjen më të lartë në rendimet e kanë bërë gjyqtarët e Përmetit, të cilët kanë shtuar me 53% numrin e çështjeve të gjykuara (80 çështje më shumë) pavarësisht rritjes, me një normë efijence prej 231 çështjesh të gjykuara, gjyqtarët e kësaj gjykate, për shkak të ngarkesës së pakët ngelen në shkallë vendi ndër gjyqtarët me rendiment më të ulët.


Krahasuar me vlera absolute, sërish rezultojnë gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, ata që kanë rritur më tepër rendimentin duke shqyrtuar gjatë vitit 2021 plot 200 çështje më tepër sesa në vitin paraardhës.

Norma e likuidimit të çështjeve: Treguesi CR jep një qasje të përgjithshme mbi aftësinë e gjykatës, si strukturë organizative, për të përfunduar çështjet në raport me ritmin e çështjeve të reja të paraqitura në gjykatë. Në rastet kur gjykata arrin të ruajë të njëjtin ritëm, treguesi CR është 100% dhe nënkupton se gjykata përfundon po aq çështje sa paraqiten pranë saj në një vit, duke mos ndikuar në stokun e krijuar paraprakisht. Nëse ritmi i gjykatës është më i shpejtë, atëherë ajo arrin të përfundojë çështjet e paraqitura rishtazi dhe disa çështje nga stoku i saj i akumuluar. Përqindja e treguesit CR mbi pragun e 100% është përqindja e çështjeve të likuiduara nga *Backlog*-u. Në të kundërt nëse ritmi i likuidimit të çështjeve nuk arrin pragun e 100%, atëherë diferenca mes 100% dhe treguesit CR është përqindja e regjistrimeve të reja, të cilat stokohen për t' u gjykuar në vitin pasardhës.

Për shkak të natyrës dhe ritmeve të ndryshme të gjykimit, norma e likuidimit përlllogaritet në mënyrë të veçantë për çdo gjykatë, sipas ndarjes së çështjeve civile dhe penale.



Për vitin 2022 likuidimi i çështjeve civile paraqitet i ndryshëm nëpër gjykata. Në vështrim të përgjithshëm treguesi CR civil mesatar është ulur në 95% krahasuar me 99% në vitin 2021. Nga analiza e të dhënave statistikore, raportuar nga vetë gjykatat vërehet se në 64%⁵³ të gjykatave treguesi CR është nën pragun e 100%. Kjo do të thotë se këto gjykata nuk kanë arritur të ruajnë ritmin e gjykimit dhe për rrjedhojë kanë shtuar stokun e çështjeve civile për vitin e ardhshëm. Situata paraqitet pozitive për 8 gjykatat e tjera⁵⁴, të cilat kanë shënuar norma likuidimi 100% dhe deri në maksimum 116% për Gjykatën e Rrethi Gjyqësor Mat. Duke analizuar bashkërisht normën e likuidimit të çështjeve dhe stokun në fillim të periudhës së raportimit, deduktojmë nevojën e rritjes së treguesit CR përtej normave të shënuara gjatë vitit 2022, por në kushtet e funksionimit nën organikë, këto tregues janë të pritshëm dhe të kuptueshëm.



Sa i përket normës së likuidimit të çështjeve penale, ndryshe nga trendi i deritanishëm, gjatë vitit 2022 rezulton e ulët krahasuar me treguesit CR për çështjet civile.

Për vitin 2022 treguesi CR mesatar për gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm është 95%, 5% më i ulët se në vitin 2021 kur mesatarja e treguesit CR ishte në pragun 100%. Brenda grupit, norma e likuidimit varion në mënyrë të dukshme mes 77% në minimumin në gjykatën e Dibrës dhe 114% në maksimumin e saj në gjykatën e Gjirokastrës.



Si konkluzion, 15⁵⁵ nga 22 gjykata nuk kanë arritur të ruajnë ritmet e gjykimit dhe për rrjedhojë kanë krijuar stok të çështjeve penale. Vetëm 7 gjykata raportojnë një normë likuidimi mbi 100%, por nuk kanë arritur të ndikojnë mbi stokun e tyre me një normë likuidimi 100% ose vetëm 1% më të lartë se pragu. Gjykatat me normë likuidimi më të lart për çështjet penale janë gjykata e Gjirokastrës me 114% dhe e Vlorës me 106%.

Treguesi DT: është një prej indikatorëve të efikasitetit të gjykatës dhe shpreh kohën e nevojshme (në ditë) për përfundimin e një çështjeje, nga momenti i regjistrimit deri në përfundimin e saj. Treguesi DT është i rëndësishëm pasi jep mundësinë për të kontrolluar dhënien në kohë të drejtësisë. Ai krahasohet me afatin e arsyeshëm ligjor, parashikuar në nenin 399/2, të Kodit të Procedurës Civile. I paraqitur grafikisht në rend rritës, krahasuar me mesataren (shënuar në jeshile) dhe afatin e arsyeshëm ligjor (shënuar në të kuqe), treguesi DT për çështjet civile dhe penale paraqitet si vijon:

⁵³ Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë, Lushnje, Korçë, Fier, Elbasan, Sarandë, Kavajë, Durrës, Përmet, Shkodër, Kukës, Vlorë, Dibër, Pogradec.

⁵⁴ Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat, Kurbin, Pukë, Tropojë, Tiranë, Gjirokastrë, Lezhë, Mat

⁵⁵ Gjirokastrë, Vlorë, Korçë, Kukës, Elbasan, Pogradec, Durrës, Kurbin.




Nga analiza e të dy grafikëve konstatohet se në të gjitha gjykatat e rretheve gjyqësore, juridiksioni i përgjithshëm, çështjet civile dhe penale përfundojnë brenda afatit të arsyeshëm ligjor. Në krahasim mes dy grafikëve dallohet se koha e nevojshme për përfundimin e çështjeve civile është më e gjatë se për çështjet penale. Një çështje civile gjykohet në shkallë të parë mesatarisht për 168 ditë ndërsa një çështje penale për 98 ditë.

Krahasimi me të dhënat statistikore të vitit paraardhës, vërehet se koha e nevojshme për evadimin e çështjes është zgjatur për të dyja kategoritë.

Në vitin 2021, mesatarja e treguesit DT civil ishte 119.7, 48 ditë më pak sesa mesatarja e vitit të raportuar. Përkeqësim vërehet gjithashtu në mesataren e treguesit DT për çështjet penale, i cili në vitin 2021 ishte në vlerën 68 ditë, 38 ditë më pak sesa mesatare prej 98 ditësh e raportuar për vitin 2022.

Stoku (backlog-u) 2022: Sikurse mund të parashikohej nga përkeqësimi i parametrevë të efikasitetit, ulja e rendimentit mesatar për gjyqtar dhe niveli nën pragun 100% të normës së likuidimit të çështjeve kanë sjellë rritje të nivelit të stokut gjatë vitit 2022. Kështu stoku në fund të vitit 2022 është rritur me 12% në krahasim me 1 janarin 2022.



Kjo rritje do të ndikojë negativisht në rendimentin e vitit 2023, pasi krijon një ngarkesë fillestare të shtuar, e cila duhet të përballohet dhe evadohet gjatë këtij viti, së bashku me regjistrimet e reja, të cilat nuk mund të parashikohen paraprakisht.

Backlog-u apo stoku përbëhet kryesisht nga çështje civile dhe tregon një tendencë rritëse në 3 vitet e fundit, sikurse edhe të dominancës së çështjeve civile në përbërje të *backlog*-ut.

Gjetjet kryesore!

- Për grupin e gjykatave të rrethit gjyqësor, ngarkesa totale e çështjeve të pashqyrtuara nga viti 2021 (*backlog-u*) është 36 590 çështje (28 % më shumë krahasuar me vitin paraardhës), nga të cilat 53% (19,374 çështje) në Gjykatën e Tiranës.
- Gjykatat e shkallës së parë, juridiksioni i përgjithshëm, kanë funksionuar me 70% të gjyqtarëve të parashikuar.
- Gjatë vitit 2021 janë regjistruar 96,596 çështje të reja (13% më pak sesa në vitin 2021). Vendin e parë me 34,382 çështje (36% e totalit) e zë Tirana, ndërsa vendin e dytë me vetëm 8% të totalit e zë Durrësi dhe Elbasani.
- Treguesit e efikasitetit janë përkeqësuar duke shënuar:
- Rritje tepër të lehtë të rendimentit mesatar të gjyqtarëve në këtë grup. Mesatarja e këtij treguesi është 563 çështje të gjykuara për gjyqtar për shkak të uljes së rendimentit në 10 gjykata. (Tropojë, Krujë, Pukë, Kukës etj)...
- Norma e likuidimit të çështjeve ka shënuar ulje për të dyja kategoritë e çështjeve. Ajo është mesatarisht 95% për çështjet civile dhe po ashtu për çështjet penale.
- Rritje të treguesit DT (koha e nevojshme për përfundimin e një çështjeje në ditë) dhe zgjatje të afateve të nevojshme për shqyrtimin e çështjet. Një çështje civile gjykohet në shkallë të parë mesatarisht për 168 ditë ndërsa një çështje penale për 98 ditë.
- Gjykimi i çështjeve penale dhe civile në shkallë të parë realizohet brenda afateve të arsyeshme ligjore, në të gjitha gjykatat e vendit.
- Ngarkesa mesatare për gjyqtar (treguesi WR) dhe norma e efikasitetit për gjyqtar (treguesi ER) tregojnë disbalancë të theksuar mes gjyqtarëve të së njëjtit nivel, shkaktuar nga ngarkesa e ulët e këtyre gjykatave.
- Si pasojë e treguesve të efikasitetit, në fund të vitit 2022 stoku është rritur me 4276 çështje. Në 31 dhjetor 2022 mbeten në pritje të gjykimit 40,866 çështje, nga të cilat 47 % (19 275 çështje) i përkasin Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

4.6. GJYKATAT ADMINISTRATIVE TË SHKALLËS SË PARË

Në sistemin gjyqësor përfshihen 6 gjykata administrative të shkallës së parë të shpërndara në disa qarqe të vendit si Shkodër, Durrës, Tiranë, Vlorë, Korçë dhe Gjirokastrë. Procesi i rivlerësimit kalimtar, përmes shkarkimit të gjyqtarëve ka ndikuar në funksionimin optimal të tyre. Për të zgjidhur problematikën, Këshilli ka operuar me transferimin e gjyqtarëve pranë këtyre gjykatave, duke siguruar kështu funksionimin e tyre. Gjithashtu, gjatë vitit 2022 Këshilli ka emëruar dhe caktuar në mënyrë të përhershme, pranë gjykatave administrative të shkallës së parë 4 magjistratë që përfunduan Shkollën e Magjistraturës.


Burimet njerëzore: Në vitin 2022 gjykatat administrative të shkallës së parë kanë funksionuar përgjithësisht me numër gjyqtarësh të reduktuar në masën 73%. Gjendja paraqitet e ndryshme në varësi të gjykatave. Në Gjykatat Administrative të Shkallës së Parë në Durrës dhe Shkodër organika është plotësuar në një masë të pëlqyeshme pasi çështjet gjykohen nga 81% dhe 98% e numrit të gjyqtarëve të nevojshëm, ndërsa rezulton jo e pëlqyeshme situata në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrës ku gjykojnë vetëm 38% e gjyqtarëve të organikës.

Në lidhje me administratën gjyqësore, vetëm Gjykata Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrës operon me staf të plotë. Në përgjithësi punohet me 90% të stafit të parashikuar dhe në minimum me 81% në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër. Raporti administratë gjyqësore për gjyqtar rezulton i ndryshëm sipas gjykatave. Me përjashtim të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, një gjyqtar ndihmohet në fakt nga një numër stafi më i lartë se raporti i parashikuar. Në vijim paraqitet në formë tabelare gjendja e burimeve njerëzore gjyqtar dhe staf mbështetës për 6 gjykatat administrative të shkallës së parë.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë	Nr. I gjyqtarëve sipas organikës	Nr. I gjyqtarëve efektivisht në detyrë	Efektivi vs Organika	Nr. I stafit mbështetës sipas organikës	Nr. i stafit mbështetës efektivisht në detyrë	Efektiv vs organikë %	Staf mbështetës për gjyqtar sipas organikës	Staf mbështetës për gjyqtar në fakt.
Durrës	4	3.3	81%	15	12.7	84%	3.8	3.9
Gjirokastrë	4	1.5	38%	11	11	100%	2.8	7.3
Korçë	4	2.5	63%	11	10.4	95%	2.8	4.2
Shkodër	4	3.9	98%	13	10.6	81%	3.3	2.7
Tiranë	16	12.1	76%	41	38.4	94%	2.6	3.2
Vlorë	4	2.9	73%	15	13.5	90%	3.8	4.6
Total	36	26.2	73%	106	96.6	91%	2.9	3.7


Në të djathtë shfaqet grafikisht krahasimi mes plotësimit të organikës së vitit të raportuar, me vitin e mëparshëm. Numri i gjyqtarëve efektivisht në detyrë shprehet në përqindje mbi organikën e tyre.

Sikurse dallohet rezulton një ulje gjenerale e normës së plotësimit të organikës në 5 gjykata.



Ngarkesa e gjykatave: shfaq një pamje të përgjithshme të volumit të çështjeve që duhet të shqyrtohen në një gjykatë të dhënë. Ngarkesa është shumatorja e tërësisë së çështjeve të mbartura nga viti paraardhës dhe çështjeve të regjistruara në gjykatë në afatin kohor të raportuar.

Stoku (backlog-u) i gjykatave në fillim të vitit: është numri i çështjeve të pashqyrtuara nga viti paraardhës, ky numër çështjesh mbetet në pritje të gjykimit për vitin e raportuar dhe përbën një ngarkesë fillestare për gjyqtarët.





Në një vështrim të përgjithshëm stoku i gjykatave administrative të shkallës së parë në vend është rritur me 12%, ndërsa në vështrim të hollësishëm vërehet se situata nuk është e njëjtë për çdo gjykatë.

Vërehet se në dy gjykata ndryshimi i stokut paraqitet pozitiv duke qëndruar i njëjtë (Korçë) dhe ulje në masën 23% (Shkodër). Ndryshe paraqitet në Durrës, Gjirokastrë dhe Tiranë ku rritet me një raport nga 6% (Tiranë) më shumë deri në 26%

(Gjirokastrë). Problematike paraqitet Gjykata e Vlorës ku backlog-u është rritur me 87%.

Të kategorizuara sipas llojit të çështjeve, stoku total i gjykatave paraqitet i ngjashëm me 2 vitet e fundit. Vërehet se ngarkesën më të madhe të stokut me 87% ose 5 490 çështje e zënë çështjet administrative të përgjithshme. Vijnë 684 çështje administrative pa palë kundërshtarë të cilat përbëjnë 11% të backlog-ut. Ndërsa çështje që i përkasin marrëdhënieve të punës mbeten për t'u shqyrtuar vetëm 99 çështje ose 2% e stokut total të gjykatave.






Çështje të regjistruara të reja: Në 6 gjykatat administrative të shkallës së parë, janë regjistruar në total 16 095 çështje të reja, vetëm 2% më tepër se në vitin 2021. Çështjet e reja të paraqitura në gjykata janë në zbritje në 4 prej tyre (Vlorë, Shkodër, Korçë dhe Durrës) me diferencë mbi 10%. Në

Tiranë janë regjistruar 495 çështje (7%) më tepër sesa në vitin 2021. Gjatë vitit 2022 rritjen kryesore, të çështjeve të reja e ka shënuar Gjykata e Gjirokastrës e cila raporton 1580 çështje, 595 çështje (60%) më tepër se viti paraardhës.


Sa i përket natyrës së çështjeve të paraqitura në gjykatë, rezulton se nga 16 095 çështje të reja, 51%, ose 8 296 janë çështje administrative pa palë kundërshtare. Çështje të përgjithshme administrative janë 47% ose 7 492 dhe vetëm 307 çështje që trajtojnë mosmarrëveshjet në marrëdhëniet e punës, të cilat zënë 2% të regjistrimeve. Krahasuar me vitin 2021 raportet mes kategorive mbeten të ngjashme, me përjashtim të rritjes me 179% të çështjeve mbi marrëdhëniet e punës, të cilat në vitin 2021 zinin vetëm 1% të regjistrimeve totale.



Ngarkesa mesatare e punës (Treguesi WR): Ngarkesa mesatare e punës tregon numrin mesatar të çështjeve në ngarkim për çdo gjyqtar efektivisht në detyrë. Ky indikator përcaktohet nga raporti i ngarkesës totale në gjykatë (*backlog* dhe regjistrime të reja) me numrin e gjyqtarëve efektivisht në detyrë në gjykatën e dhënë. Krahasuar me vitin 2021, rezulton se mesatarja e ngarkesës në gjykatat e shkallëve të para të juridiksionit administrativ është 955 çështje, dhe është rritur me 22% ose 170 çështje më tepër. Ky indikator vlerësohet i lartë krahasuar me ngarkesën mesatare të parashikuar për këtë grup gjykatash sipas organikës së plotë. Në këto premisa ngarkesa mesatare për gjyqtar në gjykatat administrative të shkallës së parë duhet të ishte 621 çështje (334 çështje më pak). Një rritje drastike e ngarkesës për gjyqtar shënohet në Gjirokastrë ku çështjet janë trefishuar në krahasim me vitin paraardhës. Kjo ngarkesë e shtuar vjen si pasojë e rritjes së *backlog*-ut me 26%, rritjes me 60% të çështjeve të reja të regjistruara, si dhe uljes së numrit të gjyqtarëve efektivisht në detyrë. Rritje të ngarkesës kanë pasur edhe gjyqtarët administrativ të Tiranës me 210 çështje më tepër për të gjykuar në 2022 dhe Korça me një ngarkesë të shtuar prej 356 çështjesh. Nga tabela e mëposhtme mbi treguesin WR vërehet se brenda juridiksionit administrativ ngarkesa për gjyqtar nuk ndjek të njëjtit trend. Në Gjykatën e Durrësit dhe Shkodrës shënohet një rënie e treguesit me 20% (296.4 çështje) dhe 17% (98.5 çështje) më pak.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë	WR 2021	WR 2022	# në %
Durrës	1375.2	1105.8	-20%
Gjirokastrë	389.3	1176	202%

Korçë	843.7	1199.6	42%
Shkodër	567	468.5	-17%
Tiranë	552.9	763	38%
Vlorë	982.3	1018.9	4%
Ngarkesa mesatare në juridiksionin administrativ shkalla e parë.	785.1	955.3	22%



E paraqitur grafikisht ngarkesa mesatare për gjyqtar në gjykatat e juridiksionit administrativ tregon një disbalancë të theksuar të ngarkesës për gjyqtar të të njëjtit juridiksion dhe shkallë gjykimit. Kështu Gjykata e Korçës rezultoi se ka vetëm 2 gjyqtarë në organikë, të cilët gjatë vitit 2022 kanë pasur në ngarkim 1199.6 çështje secili. Gjyqtarët më pak të ngarkuar me vetëm 468.5 çështje janë gjyqtarët e Shkodrës, të ndjekur nga gjyqtarët e Tiranës, të cilët kanë

pasur në shqyrtim 763 çështje. Gjyqtarët e Korçës kanë një ngarkesë 3 herë më të madhe (731 çështje më tepër) krahasuar me gjyqtarët e Shkodrës.

Përmes riorganizimit dhe shpërndarjes së gjyqtarëve me hartën e re gjyqësore, nëse do të realizonim një transferim mekanik të ngarkesës dhe numrit të gjyqtarëve sipas hartës së re, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë do të kishte një tregues WR prej 813.7 çështjesh për gjyqtar, ndërsa Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Lushnje një ngarkesë mesatare prej 1074.8 çështjesh. Sikurse vërehet diferenca e ngarkesës do ishte vetëm 32% ose 261 çështje duke sjellë kështu një ekuilibrim të ngarkesës për gjyqtarët në këtë juridiksion.

Treguesit e efijencës:


Norma e efijencës (Treguesi ER): Mesatarisht një gjyqtar i gjykatës administrative ka gjykuar 659 çështje gjatë vitit 2022. Krahasuar me vitin paraardhës rezultoi një rritje e normës mesatare e efijencës me 32% ose 159 çështje më tepër për gjyqtar.

Nga juridiksioni administrativ, për të dytin vit radhazi Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçë ka treguar rendimentin më të lartë me 1150 çështje të gjykuara nga çdo gjyqtar. Rritje e efijencës për gjyqtar është shënuar gjithashtu nga gjyqtarët e Gjirokastrës ku treguesi ER është rritur me 220% duke gjykuar mesatarisht 716.9 çështje më tepër për gjyqtar. Ndryshe paraqitet situata për gjyqtarët e Durrësit dhe Shkodrës, të cilët kanë ulur rendimentin e tyre me 41% (ose 228 çështje më pak) në Durrës dhe 13% (45 çështje) më pak në Shkodër.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë	ER 2021	ER 2022	# në % i ER
Durrës	552.3	324	-41%
Gjirokastrë	326.1	1043	220%
Korçë	819.4	1150	40%
Shkodër	346.8	302	-13%

Tiranë	446.1	550	23%
Vlorë	507.5	583	15%
Mesatare e treguesit ER	499.7	659	32%

Në mënyrë grafike situata e rendimentit paraqitet në shkallë rritëse sipas grafikut në të djathtë, në të cilin tregohet qartazi variacioni i treguesit ER midis gjykatave të së njëjtit juridiksion. Një ndryshim i konsiderueshëm deri në 281% vërehet mes gjyqtarëve të Shkodrës dhe gjyqtarëve të gjykatës së Korçës, fenomen i shkaktuar nga ulja e ngarkesës për 12 gjyqtarët e Shkodrës të cilët të përballur me një numër më të vogël çështjesh për të shqyrtuar gjatë vitit 2022 rrjedhimish kanë ulur edhe rendimentin e tyre. Ndërsa në Korçë vërehet efekti i kundërt ku 2 gjyqtarët e vetëm, të përballur me një numër të lartë dosjesh kanë arritur një rendiment prej 1150 çështjesh të gjykuara secili. Këto të dhëna tregojnë edhe një herë nevojën për riorganizim të shpërndarjes së gjykatave dhe gjyqtarëve me qëllim jo vetëm trajtimin e barabartë të gjyqtarëve sa i përket ngarkesës që i jepet secilit por mbi të gjitha rritjen e efijencës së gjykatave.



Ky ndryshim i theksuar i rendimentit vjen për arsye të shumta e të ndryshme. Një prej tyre konsiderohet të jetë ngarkesa mesatare e punës së gjyqtarëve. Nga analiza statistikore ndër vite të treguesit WR (ngarkesa mesatare për gjyqtar) dhe treguesit ER (norma e efijencës për gjyqtar) vërehet se

në gjykatat administrative të shkallës së parë, gjyqtarët rrisin apo ulin rendimentin e tyre në raport të drejtë me ngarkesën.

Një përgjigje direkte ndaj këtij fenomeni vlerësohet se do të jetë riorganizimi gjykatave të juridiksionit administrativ në dy gjykata të vetme duke krijuar një shpërndarje të bazuar në të dhëna statistikore dhe ngarkesë të balancuar të gjyqtarëve në çdo gjykatë. Ky riorganizim ka për qëllim rritjen e normës së efijencës edhe për gjyqtarët me normë të ulët, normë kjo e shkaktuar nga ngarkesa e ulët në këto gjykata.

Norma e zgjidhjes së çështjeve (Treguesi CR): treguesi CR për vitin 2022, si dhe krahasimi me normën e vitit 2021 paraqitet në tabelë si më poshtë.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë	CR 2021	CR 2022	# në % i CR
Durrës	86	75	-13%
Gjirokastrë	96	99	3%
Korçë	100	99	-1%
Shkodër	123	124	1%
Tiranë	99	87	-12%
Vlorë	70	100	43%


Në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit administrativ vërehet se norma e likuidimit të çështjeve është mbi 75%. Nga të dhënat tabelare vihet re qartazi se është shënuar një përmirësim minimal në dy gjykata, Shkodër dhe Gjirokastrë. Përmirësim i ndjeshëm është regjistruar në Vlorë, në të cilën është arritur pragu prej 100% duke arritur kështu ruajtjen e ritmit për likuidimin e çështjeve të reja pa krijuar stok. Gjykatat Administrative të Shkallës së Parë Durrës, Korçë dhe Tiranë kanë pësuar një ulje të normës së likuidimit. Këto gjykata nuk kanë arritur të përballojnë fluksin e çështjeve të reja të regjistruara, duke thelluar gjendjen e stokut të trashëguar nga një vit më parë.

Treguesi DT (Treguesi i kohës së nevojshme për evadimin e çështjeve): Bazuar në të dhënat statistikore të raportuara nga gjykatat, rezulton se në 3 gjykata të juridiksionit administrativ, koha e nevojshme për shqyrtimin e çështjeve gjyqësore është ulur. Efekt pozitiv mbi treguesin DT ka pasur në gjykatën e Gjirokastrës ku koha e nevojshme për evadimin e një çështje është shkurtuar

me 24.4 ditë krahasuar me vitin 2021, thashme koha mesatare për zgjidhjen e çështjes është 46.4 ditë. Ulje të treguesit DT janë shënuar gjithashtu në gjykatën e Vlorës ku koha e nevojshme është ulur me 20% ose 68.4 ditë, ndërsa në Shkodër një çështje zgjidhjet për 201.7 ditë, 30.1 ditë më shpejt krahasuar me vitin 2021.


Problematike rezultojnë gjykatat e Durrësit ku koha është zgjatur me 338.1 ditë në krahasim me vitin 2021, Tirana e cila shënon një zgjatje të afateve me 68% ose 68.4 ditë më tepër. Përkeqësim të treguesit DT ka hasur edhe Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçë me një rritje prej 45%, që përkthehet në një kohë evadimi 59.1 ditë më të gjatë.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë	DT 2021	DT 2022	# në % i DT
Durrës	543.9	882	62%
Gjirokastrë	70.8	46.4	-34%
Korçë	10.8	15.7	45%
Shkodër	231.8	201.7	-13%
Tiranë	87.4	146.5	68%
Vlorë	341.5	273.1	-20%
Afati i arsyeshëm ligjor	365	365	




Në të djathtë paraqitet në formë grafike treguesi DT i vitit 2022 në gjykatat administrative të shkallës së parë sipas vlerës. Vërehet se gjatë vitit 2022, kohëzgjatja e përfundimit të një çështje administrative në shkallë të parë varion ndjeshëm midis gjykatave. Me përjashtim të Gjykatës së Durrësit, konstatohet se gjykimi administrativ realizohet brenda një afati të arsyeshëm ligjor pra më pak se 365 ose një vit.

Backlog-u në fund të periudhës: Numri i çështjeve të pashqyrtuara në gjykatat administrative të shkallës së parë në vitin 2022, është rritur me 17%. Në shkallët e para të juridiksionit administrativ mbeten në pritje të gjykimit, në formën e stokut për vitin 2023, një total prej 73,54 çështjesh, nga të cilat 36% ose 2568 çështje janë çështje të regjistruara në Tiranë dhe 34% ose 2542 çështje në Durrës.



Vjetërsia e çështjeve në pritje të gjykimit: Në krah paraqitet në formë grafike përbërja e *backlog*-ut në gjykatat administrative të shkallës së parë, kategorizuar sipas kohës së pritjes, thënë ndryshe sipas vjetërsisë së çështjes. Konstatohet se 73% e *backlog*-ut për vitin 2023 përbëhet nga çështje të regjistruara gjatë vitit 2022, nga të cilat 3457 çështje janë paraqitur në gjykatë 6-



mujorin e dytë të vitit. Po ashtu rezultojnë 1085 çështje, që përbëjnë 15% të stokut, të cilat janë në pritje prej më pak se dy vjet. Raportohen gjithashtu 669 çështje (9% e stokut) me një kohë pritje 2-3 vjeçare, 2% e stokut ose 159 çështje kanë një vjetërsi 3-5 vjeçare. Pjesë e stokut janë edhe 87 çështje administrative me palë kundërshtare, të cilat presin gjykimin prej më shumë se 5 vjet nga të cilat 34 çështje janë të regjistruara në Vlorë, 33 në Shkodër, 17 në Tiranë dhe 3 çështje në Korçë.

Gjetjet kryesore !

- Viti 2022 ka filluar me 6273 çështje (*backlog*), në pritje për t'u gjykuar nga gjykatat administrative të shkallës së parë, vlerë 12% më e lartë krahasuar me vitin paraardhës. *Backlog*-u gjendet kryesisht në Gjykatën e Durrësit 35% e totalit (2189 çështje) dhe 27% (1667 çështje) në Tiranë
- Gjatë vitit raportues janë regjistruar 16,095 çështje të reja nga të cilat 47% në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
- Gjykimi është kryer nga 73% e gjyqtarëve të parashikuar.
- Gjykatat administrative të shkallës së parë kanë shënuar:
 - Rritje të ngarkesës mesatare të gjyqtarëve në 955 çështje për gjyqtar, krahasuar me 785.07 çështje/gjyqtar në vitin 2021.
 - Rritje të rendimentit të gjyqtarëve në 659 çështje nga 499.7 çështje të gjykuara për gjyqtar në 2021. (me përjashtim të Shkodrës ku rendimenti i gjyqtarëve është ulur për shkak të numrit të reduktuar të çështjeve).
 - Normë likuidimi të çështjeve nën 100% në 4 gjykata (Durrës, Gjirokastrë, Korçë dhe Tiranë).
 - Përjashtuar Durrësin, gjykimi kryhet brenda afateve të arsyeshme ligjore me një tregues DT mesatar prej 260.9 ditësh.
- Numri i çështjeve të pashqyrtuara në gjykatat administrative të shkallës së parë (*backlog*-u) në fund të vitit 2022 u rrit me 17%, duke shënuar një total prej 7354 çështjesh në pritje për t'u gjykuar nga të cilat 2568 çështje (36%) në Tiranë dhe 2542 çështje (34%) në Durrës.

KONKLUZIONE DHE ANGAZHIME

Në kuadrin e kryerjes së bilancit të fundvitit 2022 dhe në njohje të plotë të rolit dhe funksioneve të tij, Këshilli Lartë Gjyqësor, do të vazhdojë punën e tij me përgjegjësi e përkushtim dhe përgjatë vitit 2023 duke marrë angazhimet si më poshtë vijon:

1. Vijimin e hartimit të kuadrit nënligjor të nevojshëm për të gjitha proceset dhe çështjet me fokus planifikimin strategjik, administrimin dhe buxhetin e sistemit gjyqësor, ato që lidhen me veprimtarinë dhe mirë-funksionimin e gjykatave dhe vlerësimin, promovimin dhe disiplinën e gjyqtarëve në të gjithë Republikën e Shqipërisë.
2. Vazhdimin e zbatimit të reformës për nëpunësin civil gjyqësor me qëllim krijimin e një administrate të qëndrueshme, profesioniste dhe me integritet, përmes zbatimit të procedurave transparente dhe meritokratike të rekrutimit dhe finalizimit të paketës së akteve të nevojshme për mirëfunksionimin e administratës civile gjyqësore.
3. Zbatimin në praktikë të Hartës së Re Gjyqësore, sipas fazave të përcaktuara në këtë projekt:
 - Riorganizimi i 6 Gjykatave të Apelit dhe krijimi i Gjykatës së Juridiksionit të Përgjithshëm me seli në Tiranë, e fillimi i veprimtarisë së saj më datë 1 shkurt 2023.
 - Riorganizimi i 22 gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm të shkallës së parë në 13 gjykata dhe fillimi veprimtarisë së tyre më datë 1 maj 2023.
 - Riorganizimi i 6 Gjykatave të Juridiksionit të posacëm Administrativ të shkallës së parë dhe krijimi i 2 gjykatave me seli në Tiranë dhe Lushnje, e fillimi i veprimtarisë së tyre më datë 1 korrik 2023.
4. Thellimin e bashkëpunimit me Shkollën e Magjistraturës si për përcaktimin e kuotave për magjistratët e rinj dhe për trajnimin fillestar të tyre dhe të vazhdueshëm të gjyqtarëve në detyrë, me qëllim plotësimin e vendeve vakante në sistem dhe uljen e çështjeve të prapambetura.
5. Vijimin e vlerësimeve etike dhe profesionale të gjyqtarëve në përputhje me programin e përcaktuar nga KLGJ-ja si dhe emërimin dhe promovimin e tyre si në bazë të nevojave të sistemit dhe në respektim të plotë të të drejtave të kandidatëve në këto procese.
6. Sigurimin e një komunikimi të vazhdueshëm me qëllim identifikimin e nevojave për burime njerëzore dhe financiare nëpër gjykata.
7. Forcimin e bashkëpunimit me donatorët dhe projektet e ndihmës së huaj me qëllim sigurimin e fondeve të nevojshme për zhvillimin e një sistemi të ri e bashkëkohor të teknologjisë së informacionit për sistemin e drejtësisë.

Për sa më sipër, Këshilli i Lartë Gjyqësor vijon të kërkojë mbështetjen e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë në lidhje me:

- Miratimin e ndryshimeve ligjore të propozuara dhe dërguara pranë tij gjatë muajit tetor të vitit 2022.

- Mbështetjen financiare në investime për rikonfigurimin dhe shpërndarjen gjeografike të gjykatave sipas Hartës së Re Gjyqësore si dhe për sisteme bashkëkohore të teknologjisë së informacionit.